

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT

Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 97, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin Penal, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur”, në “Kodin Penal ushtarak”, në “Kodin e Procedurës Penale”, Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dt.20.06.2019, VKM nr. 296 datë 10.05.2019 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2019” të Këshillit të Ministrave, Urdhërave dhe Udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur parasysh edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2019, është fokusuar në punën e saj duke i dhënë prioritet në punën e saj këtyre drejtimeve kryesore:

- **Lufta kundër korrupsionit**
- **Lufta kundër krimit të organizuar**
- **Respektimi i të drejtave të njeriut**
- **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Krahas këtyre prioritetëve ,gjatë vitit 2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është punuar, pa lënë mënjane, edhe në lidhje me ndjekjen penale dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve penale në lidhje me veprat penale kundër shëndetit dhe jetës, në fushën e krimit ekonomik, kundër autoritetit të shtetit të kryer nga shtetas, veprave penale që çenojnë lirinë e zgjedhjeve, mbrojtjen e regjimit juridik të tokës, vepra penale kundër mjedisit apo veprave të tjera penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal ushtarak.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie i është kushtuar rëndësi dhe përdorimit më efektiv të institutive procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, duke qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor përkatës.

Gjithashtu është punuar për hartimi dhe nxjerrjen e rregullave standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës ,si dhe rritjen e pavarësisë së prokurorëve dhe forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror.

1. Lufta kundër korrupsionit:

1/a. Lufta kundër korrupsionit:

Në punën e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, gjatë vitit 2019, në kuadër të luftës, ka qenë prioritet :

-Krijimi i një historiku solid me ndjekje penale dhe dënime për korrupsion, nëpërmjet rritjes së numrit të personave të dënuar me vendim të formës së prerë;

-Zbatimi efektiv i ligjit nëpërmjet rritjes së numrit të hetimeve proaktive (çështje të filluara kryesisht dhe shtim të numrit të rasteve të përmirësimit të cilësisë së hetimeve me qëllim

suksesin e kërkesave të prokurorit në gjykatë;

-Ashpërsimi i politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit, veçanërisht në rastet e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë;

-Shtimi i numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe veçanërisht rritje e numrit të aseteve të sekuestruara dhe atyre të konfiskuara;

-Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërorë;

-Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese vendase dhe ndërkombëtare sidomos për kryerjen e hetimeve pasurore financiare që lidhen me veprat penale të korrupsionit;

-Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, përfshirë edhe oficerët e policisë gjyqësore;

Lufta kundër korrupsionit përfaqëson një ndër sfidat kryesore për progresin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë,ndërkohë që është një ndër kushtet e vendosura nga Bashkimi Evropian për avancimin e Shqipërisë në rrugën e integritimit në Bashkimin Evropian.

Objektiv i punës së prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në përgjithësi,si dhe atyre të Seksionit të Posaçëm në veçanti ,gjatë vitit 2019 ka qenë përmirësimi i efektivitetit të hetimeve penale në drejtim të zbatimit efektiv të ligjit, rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë, rritjes së personave të dënuar me vendim të formës së prerë, hetime më të mira financiare dhe procedura të gjetjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve dhe pasurive që burojnë nga krimi dhe praktikat korruptive; shtimit të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, rritjes së aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërorë, si dhe bashkëpunimi dhe krijimi I skuadrave të përbashkëta hetimore janë drejtimet kryesore ku duhet të fokusohet lufta kundër korrupsionit nga organet ligjzbatuese.

Mbështetur në Udhëzimin nr. 1 datë 20.02.2018 *``Për krijimin e seksioneve të posaçme``* në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Shkodër, Lezhë, Korçë e Gjirokastrë për hetimin e veprave penale sipas kompetencave të përcaktuara në atë udhëzim, i nxjerrë në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes nr. 413 prot e nr. 937 prot. datë 02.02.2018 ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, në shkresën nr. 1001/6 Prot datë 20.04.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi emrat e prokurorëve prej të cilëve Drejtuesi i Prokurorisë do të përzgjedhte prokurorët që do të caktoheshin në Seksionin e Posaçëm,si dhe në Urdhërin nr. 30 Prot datë 30.04.2018 *``Për Krijimin e Seksionit të Posaçëm të përkohshëm për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, veprat penale në sferën ekonomike, veprat penale të kryera nga subjektet e posaçme``* të ish-Drejtuesit i Prokurorisë të ndryshuar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2019 ka vazhduar funksionimi i Seksionit të Posaçëm,në kuadër të planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar e sipërcituar.Në përbërje të këtij Seksioni kanë qenë tre prokurorë dhe dy oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë.

Nga Drejtuesi i Seksionit të Posaçëm është bërë raportimi i të dhënave statistikore tek prokurori/koordinator në Prokurorinë e Përgjithshme; është kryer bashkëpunimi me shërbimet e

policisë gjyqësore pranë Task Forcës Speciale Qendrore, Task Forcës Speciale Rajonale për shkëmbimin e informacionit, për kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta rreth grupeve kriminale si dhe realizimin e veprimtarisë hetimore në zbatim të detyrave specifike, të përcaktuara në Planin e Veprimit Kundër Krimin të Organizuar, Operacioni ``*Forca e Ligjit*``; është kontrolluar kompetenca lëndore e Seksionit të Posaçëm të Përkohshëm dhe mënyra e shpërndarjes së çështjeve në këtë seksion, mbështetur në ligjin nr. 97/2016 ``*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*`` dhe Udhëzimit nr. 03 datë 29.12.2016 ``*Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori*`` të Prokurorit të Përgjithshëm.

Me zbatim të Udhëzimit nr. 55 prot datë 10.09.2018 ``*Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*`` të Drejtuesit të kësaj prokurorie, gjatë vitit 2019 janë mbajtur të dhënat statistikore me tregues të veçantë, duke i bashkangjitur edhe një tabelë përkatëse.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale ,në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit N.244,245/1 dhe 259 të K.Penal,rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore për veprat penale në lidhje me korrupsionin është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Konkretish nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 10 materiale hetimore gjatë vitit 2019,nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme e Ankesat në Ministrinë Brendshme apo pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 2 materiale hetimore ,nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë është referuar 1 material hetimor ,mbi bazën e informacioneve të SHISH është referuar 1 material hetimor,nga shtetasit janë bërë 6 kallëzime penale në Prokurori ,si dhe nga prokurorët është regjistruar kryesisht në 1 rast vepra penale e parashikuar nga neni 259 i K.Penal.


Është për tu theksuar fakti se në pjesën më të madhe të referimeve të ardhura nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore dhe kryesisht nga ato të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan veprat penale në fushën e korrupsionit janë referuar të lidhura me njëra tjetrën ose me veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Problematikë e hasur në lidhje me referimet e kryera gjatë vitit 2019 rezulton se përgatitja e materialit të parë hetimor të referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore për vepra penale në fushën e korrupsionit lë shumë për të dëshiruar,pasi referimet janë kryer vetëm mbi bazën e dyshimeve dhe informacioneve operative që dispononte policia gjyqësore në kohë të mëparshme,pa u shoqëruar me prova , akte apo verifikime konkrete të dokumentuara.


Gjatë vitit 2019,në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit N.244,245/1 dhe 259 të K.Penal,nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur mosfillimi I procedimit penal për 5 materiale hetimore.

Gjatë vitit 2019 për veprat në fushën e korrupsionit janë regjistruar procedime penale të reja 16 procedime dhe ka vazhduar hetimi për 8 procedime të mbartura nga vitit 2018.

Referime gjatë vitit 2019 për N.244,245/1 e 259 të K.Penal-gjithsej 21



Mosfillime dhe çështje të regjistruara gjatë vitit 2019 për N.244,245/1 e 259 të K.Penal



Në lidhje me çështjet penale të regjistruara të reja për veprat penale në fushën e korrupsionit rezulton se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 3 procedime penale më shumë se në vitin 2018.

Sic e theksuam më lart,gjatë hetimeve paraprake për vepra të tjera penale, rezulton se në 1 procedim penal,kur nga rrethanat e çështjeve kanë dalë fakte që kanë të bëjnë me vepra penale në lidhje me korrupsionin,kryesisht nga prokurori në bazë të nenit 287/2 të K.Pr.Penale janë regjistruar këto vepra penale në lidhje me korrupsionin .

Në lidhje me veprat penale kundër korrupsionit nga policia gjyqësore është kryer arrest në flagranc vetëm për një person për N.244 të K.Penal,arrestim në flagrancë I cili është vleftësuar I ligjshëm nga gjykata.

Në lidhje me veprat penale kundër korrupsionit nga prokurorët e kësaj prokurorie janë nxjerrë 2 urdhëra ndalimi për dy persona për N.259 të K.Penal,ndalime këto të ekzekutuara nga policia gjyqësore dhe të vleftësuar të ligjshme nga gjykata.

Në krahasim me vitin 2018 ,gjatë vitit 2019 në lidhje me këto vepra penale nuk ka ndryshim shifrash përse I përket arresteve në flagrancë të kryera nga policia gjyqësore dhe ndalimeve të urdhëruara nga prokurorët,pasi në vitin 2018 është arrestuar në flagrancë vetëm 1 person,si dhe është urdhëruar ndalimi nga prokurori për 2 persona.

Nga prokurorët,gjatë vitit 2019 për veprat penale kundër korrupsionit, është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 10 persona dhe nga gjykata për 9 persona janë dhënë masa e

sigurimit “arrest në burg” ,ku përfshihen dhe ato me afat,si dhe në 1 rast është dhënë masa e sigurimit “arrest në shtëpi”,për të cilin është ushtruar ankim,por nga Gjykata e Apelit kjo masë ka ndryshuar në atë të “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”.

Gjithashtu vetëm për një person është kërkuar masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”,si dhe nga gjykata është dhënë po e njëjta masë sigurimi.

Ndërkohë gjatë vitit 2018 për veprat penale kundër korrupsionit, është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 15 persona dhe nga gjykata për 11 persona janë dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” ,ku përfshihen dhe ato me afat,si dhe në 4 raste është dhënë masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

Gjithsej gjatë vitit 2019 janë hetuar 25 procedime penale, me 37 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 8 persona me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në lidhje me personat e hetuar për veprat penale në fushën e korrupsionit rezulton se 35 personat kanë qenë mbi 18 vjeç,prej të cilëve 27 meshkuj dhe 8 femra.

Përsa I përket arsimimit rezulton se 7 persona kanë qenë me arsim deri në 9 klasë,18 me arsim të mesëm dhe 11 me arsim të lartë.

Përsa I përket punësimit dhe detyrave rezulton se 3 persona kanë qenë nëpunës të nivelit të mesëm dhe pjesa tjetër kanë qenë punonjës të nivelit të ulët ose të papunë apo të punësuar në subjekte private.

Përsa I përket vendbanimit pjesa më e madhe e personave nën hetim/pandehur janë banues në qytet,si dhe vetëm 2 persona/të pandehur kanë qenë të dënuar për vepra të tjera penale ,ndërsa pjesa tjetër kanë qenë të padënuar.

Për veprat penale kundër korrupsionit gjatë vitit 2019 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të mjeteve/technikave të posaçme/special të hetimit në pothuajse në pjesën më të madhe procedimeve penale dhe konkretisht janë kryer veprime përgjimi ambjentat apo telefonik në 76 raste,të miratuara nga gjykata,duke u përfshirë këtu dhe zgjatjet e afateve të përgjimit,si dhe janë lëshuar 12 autorizime për regjistrimi të fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike.

Ka patur vetëm 1 rast kryerje veprimesh stimuluese,ndërkohë që nuk ka patur raste vendime kontrolli vendesh,apo sekuestrosh preventive të caktuara nga gjykata.

Në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit,gjatë vitit 2019,nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur bashkimi I procedimit për 1 procedim penal.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar pushimi I çështjes/akuzës penale për 8 procedime penal,për 14 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 0 me masë sigurimi “arrest në burg”,ndërsa nga gjykata është

pranuar kërkesa për pushim për 6 procedime penale dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 2 kërkesa për pushim çështjeje.

Në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit nga prokurorët e kësaj prokurorie nuk është kërkuar në asnjë rast miratimi I marrëveshjes së fajësisë .

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I çështjes për gjykim për 4 procedime penale,për 9 të pandehur,prej të cilëve 3 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2018,gjatë vitit 2019 është dërguar për gjykim 1 procedim penal më pak, 1 I pandehur më shumë ,si dhe një 1 i pandehur i arrestuar më shumë.

Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim për 3 procedime me 4 të pandehur,si dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 2 kërkesa për dërgim çështje në gjyq.


Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit nga prokurorët e kësaj prokurorie është pezulluar hetimi për 2 procedime penal për n.245/1 të K.Pr.Penale.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit nga prokurorët e kësaj prokurorie është shpallur moskompetenca tokësore apo lëndore për 6 procedime penale me 10 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 1 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit kanë përfunduar hetimet paraprake për 20 procedime penale me 33 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 4 të arrestuar,si dhe kanë mbetur në hetim për vitin 2020 5 procedime penale me 4 të persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 4 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Theksojmë se në kuadër të krijimit të Prokurorisë së Posacme (SPAK) veprat penale në fushën e korrupsionit janë kompetencë lëndore hetimi të kësaj prokurorie,si dhe në këto kushte gjatë vitit 2020 të gjitha çështjet e mbetura në hetim nga viti 2019 do të kalojnë për kompetencë lëndore pranë kësaj prokurorie.

Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 dhe të mbetura në hetim për N.244,245/1 e 259 K.P



Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit ka përfunduar gjykimi për 8 procedime penale, me 13 të pandehur, prej të cilëve 5 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2018 gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për 2 procedime penale më shumë dhe për 4 të pandehur më shumë.

Në lidhje me masat e dënimit nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë vitit 2019 në gjykim për veprat penale në fushën e korrupsionit janë kërkuar dënime me burgim për 8 të pandehur, si dhe dënime alternative të “Pezullim ekzekutimi dënimi me burgim” dhe “Punë në interes public” të parashikuara nga nenet 59 e 63 të K.Penal për 5 të pandehur, si dhe për 2 të pandehur dënime plotësuese “Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike”.

Nga gjykata janë dhënë dënime me burgim për 3 të pandehur, si dhe dënime alternative të parashikuara nga nenet 59 e 63 të K.Penal për 10 të pandehur, ndërkohe që për 2 të pandehur, sipas kërkesës së prokurorit janë dhënë dënime plotësuese “Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike”.

Në rastet që nga prokurori është kërkuar dënim me burgim dhe nga gjykata është dhënë dënim alternative, të parashikuara nga nenet 59 e 63 të K.Penal është bërë ankim ndaj 2 vendimeve penale.

Është për tu theksuar fakti se gjatë vitit 2019 janë dënuar për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrjnë funksione publike” të parashikuar nga neni 259 I K.Penal, dy të pandehur, ndërkohe që në vitin 2018 nuk ka patur persona të dënuar për këtë veprë penale.


Gjithashtu gjatë vitit 2019 janë dënuar për veprën penale të “Korrupsionit aktiv të personave që ushtrjnë funksione publike” të parashikuar nga neni 244 I K.Penal, një i pandehur, ndërkohe që në vitin 2018 nuk ka patur persona të dënuar për këtë veprë penale.

Gjatë vitit 2019 janë dënuar 10 të pandehur për veprën penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike” të parashikuar nga neni 245/1 I K.Penal, ndërkohe që gjatë vitit 2018 janë dënuar për këtë veprë penale 10 të pandehur.


Përsa i përket personave të dënuar në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit rezultojnë se funksionarë publikë të nivelit të mesëm janë 2 persona të dënuar për N.259 të K.Penal, ku njëri ka qenë oficer policie gjyqësore, ndërsa tjetri ka qenë doktor, ndërsa të pandehurit e tjerë rezultojnë se kanë patur funksione publike të niveleve të ulta, ose nuk kanë patur funksione publike.

Nga të pandehurit e dënuar rezultojnë se 4 të pandehur kanë qenë femra dhe 9 të pandehur kanë qenë meshkuj, si dhe pjesa më e madhe e të pandehurve të dënuar kanë qenë me arsim të mesëm.


Kërkesat e prokurorit për të pandehurit e dënuar për N.244,245/1 e 259 të K.P



Dënimet gjykatës për të pandehurit e dënuar për N.244,245/1 e 259 të K.P



Të pandehurit e dënuar gjatë vitit 2019 për N.244,245/1 e 259 të K.Penal



1/b.Lufta kundër veprimeve të kundraligjshme ne lidhje me veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 I K.Penal.


Siç e theksuam edhe më lart lufta kundër korrupsionit është e lidhur ngushtë edhe me luftën kundër veprimeve të kundraligjshme të punonjësve që ushtrojnë funksione apo shërbime publike,që kanë të bëjnë me veprën penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 I K.Penal.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale ,në lidhje me veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”,të parashikuar nga neni 248 I K.Penal,rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore për veprat penale në lidhje me korrupsionin është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Konkretish,gjatë vitit 2019,nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 74 materiale hetimore,nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme e Ankesat në Ministrinë Brendshme apo pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 5 materiale,nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë janë referuar 3 materiale ,nga institucione të tjera publike janë referuar 14 materiale hetimore,nga shtetasit janë bërë 14 kallëzime penale në Prokurori ,si dhe nga prokurorët është regjistruar kryesisht në 1 material hetimor.

Është për tu theksuar fakti se në pjesën më të madhe të referimeve dhe kallëzime në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal,kjo veprë është referuar apo kallëzuar e lidhur vepra penale në fushën e korrupsionit,pabarizë në tendera apo fallsifikimit të dokumentave.

Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal,nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur mosfillimi I procedimit penal për 9 materiale hetimore,si dhe janë regjistruar procedime penale të reja 102 procedime dhe ka vazhduar hetimi për 76 procedime të mbartura nga vitit 2018.



Në lidhje me çështjet penale të regjistruara të reja për veprat penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal rezulton se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 46 procedime penale më shumë se në vitin 2018.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga policia gjyqësore është kryer arrest në flagrancë për 2 persona, arrestime në flagrancë të vleftësuar të ligjshëm nga

gjykata,ndërkohë që në vitin 2018 nuk ishte arrestuar asnjë person në flagrancë për këtë veprë penale.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie nuk ka patur ndonjë rast që të jenë nxjerrë urdhëra ndalimi.

Nga prokurorët,gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, është kërkuar masa e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 2 persona dhe nga gjykata për 2 personat është caktuar kjo masë sigurimi.

Gjithsej gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal janë hetuar 178 procedime penale, me 30 persona nën hetim/ pandehur,asnjë me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në lidhje me personat e hetuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal rezulton se të 30 personat kanë qenë mbi 18 vjeç,prej të cilëve 27 meshkuj dhe 3 femra.

Përsa I përket arsimimit rezulton se 3 persona kanë qenë me arsim deri në 9 klasë,12 me arsim të mesëm dhe 15 me arsim të lartë.

Përsa I përket punësimit dhe detyrave rezulton se 1 person kanë qenë nëpunës I nivelit të lartë,26 të nivelit të mesëm dhe të ulët.

Përsa I përket vendbanimit pjesa më e madhe e personave nën hetim/pandehur janë banues në qytet,si dhe nuk kanë qenë të dënuar për vepra të tjera penale.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale në fushën shpërdorimit të detyrës janë kryer veprime përgjimi ambjental në 2 raste.

Nuk ka patur asnjë rast kryerje veprimesh stimuluese,vendime kontrolli vendesh,apo sekuestrosh preventive të caktuara nga gjykata.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur bashkimi I procedimit për 6 procedime penal.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar pushimi I cështjes/akuzës penale për 38 procedime penal me 2 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 0 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Nga gjykata është pranuar kërkesa për pushim për 16 procedime penale,kthim aktesh për 2 procedime,si dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 20 kërkesa për pushim cështjeje.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar miratimi I marrëveshjes së fajësisë për 3 procedime penale me 3 të pandehur,të cilat kanë mbetur për tu gjykuar gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I çështjes për gjykim për 9 procedime penale me 11 të pandehur, prej të cilëve 0 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim apo miratim marreveshje 9 procedime penale më shumë.


Nga gjykata vetëm në 1 rast është vendosur plotësimi I akteve të hetimeve paraprake, si dhe pas plotësimit të këtyre akteve nga gjykata është vendosur më pas dërgimi I çështjes për gjykim.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është pezulluar hetimi për 1 procedim penal.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është shpallur moskompetenca tokësore apo lëndore për 7 procedime penale me 1 person nën hetim/pandehur, prej të cilëve 0 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal kanë përfunduar hetimet paraprake për 64 procedime penale me 17 persona nën hetim/pandehur, prej të cilëve 0 të arrestuar, si dhe kanë mbetur në hetim për vitin 2020, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal , 114 procedime penale me 13 të persona nën hetim/pandehur, prej të cilëve 0 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 dhe të mbetura në hetim për N.248 K.Penal



Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal nuk ka përfunduar gjykimi për asnjë çështje penale, si për ato të mbartura në gjykim nga viti 2018, ashtu dhe për ato të dërguara për gjykim gjatë vitit 2019, pasi në të gjitha rastet procesi I gjyqimit ka vazhduar me gjykim të zakonshëm.

1/c.Lufta kundër veprimeve të kundraligjshme ne lidhje me informalitetin , evazionin fiskal dhe veprat penale në fushën e doganave.

Gjatë vitit 2019 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është punuar edhe në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen e akuzave dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve penale që kanë lidhje me veprat penale në fushën e doganave dhe me veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, vepra penale këto që çënojnë grumbullimin e të ardhurave dhe sistemin financiar në Republikën e Shqipërisë.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale për këto vepra penale, rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.


1/c/1.Lufta kundër veprave penale në fushën e doganave të parashikuara nga nenet 171-179/c të K.Penal gjatë vitit 2019:

Nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 6 materiale hetimore ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Hetimi Doganor) janë referuar 2 materiale hetimore.


Konkretisht janë referuar 5 materiale për veprën penale të ``Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë`` të parashikuar nga neni 178 I K.Penal, si dhe 3 materiale për veprën penale të “Ruajtja dhe depozitimi I mallrave që janë kontrabandë”, të parashikuar nga neni 179 I K.Penal.

Në lidhje me këto materiale hetimore rezulton se është vendosur mosfillimi I procedimit penal për 1 material hetimor dhe janë regjistruar 7 procedime penale të reja gjatë vitit 2019.

Referime gjatë vitit 2019 për N.178 e 179 të K.Penal



Mosfillime dhe çështje të regjistruara gjatë vitit 2019 për N.178 e 179 të K.Penal



Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e doganave rezulton se është ushtruar ndjekja penale për 7 procedime penal të regjistruara të reja,si dhe ka vazhduar hetimi për 6 procedime penale të mbartura nga viti 2018.

Në lidhje me veprat penale në fushën e doganave rezulton se nga policia gjyqësore është kryer arrest në flagrancë për 2 persona, arrestime në flagrancë të vleftësuar të ligjshëm nga gjykata,si dhe është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 2 persona dhe nga gjykata për 1 person është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”,ndërsa për personin tjetër është caktuar masa e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”.Nga prokurorët është bërë një apel,por nga gjykata e Apelit është lënë në fuqi vendimi I gjykatës.


Gjithsej gjatë vitit 2019 për veprat penale në fushën e doganave janë hetuar 13 procedime penale, me 6 persona nën hetim/ pandehur me 1 të arrestuar.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e doganave rezulton se është kërkuar pushimi I cështjes/akuzës penale për 1 procedim penal me 1 persona nën hetim,kërkesë e cila është pranuar nga gjykata.


Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I cështjes për gjykim për 4 procedime penale me 4 të pandehur,prej të cilëve 1 me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”,si dhe nga gjykata janë pranuar kërkesat e prokurorit.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e doganave kanë përfunduar hetimet paraprake për 5 procedime penale me 5 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 1 të arrestuar,si dhe kanë mbetur në hetim për vitin 2020 gjithsej 8 procedime penale me 3 të persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve asnjë I arrestuar.

Çështje të hetuar gjatë vitit 2019 sipas veprave penale në fushën e doganave



Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 dhe të mbetura në hetim për veprat penale në fushën e doganave



Në lidhje me veprat penale në fushën e doganave gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për çështje të mbartura në gjykim që nga vitit 2018,si dhe atë të dërguara për gjykim gjatë vitit 2019,gjithsej për 4 procedime penale me 4 të pandehur.

Nga prokurorët në këto gjykime janë kërkuar për 2 të pandehur dënim me burgim dhe për 2 të pandehur aplikim I N.59 të K.Penal “Pezullim I ekzekutimit të dënimit me burgim”,si dhe nga gjykata janë dhënë për 1 të pandehur dënim me burgim,ndërsa për 3 të pandehur është aplikuar N.59 I K.Penal,si dhe nga prokurori është bërë ankim për 1 vendim të gjykatës.


1/c/2.Lufta kundër veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve të parashikuara nga nenet 180-182/a të K.Penal gjatë vitit 2019:

Nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 34 materiale hetimore,ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Hetimi Tatimor) janë referuar 3 materiale hetimore.


Konkretisht janë referuar 30 materiale për veprën penale të “Fshehje e të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i K.Penal,1 material për veprën penale “Moslëshim I kuponit tatimor” të parashikuar nga neni 180/a I K.Penal,3 materiale për veprën penale “Mospagim I taksave dhe tatimeve” të parashikuar nga neni 181 I K.Penal, 1 material për veprën penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore” të parashikuar nga neni 181/a I K.Penal,si dhe 2 materiale për veprën penale të “Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare”,të parashikuar nga neni 182/a të K.Penal.

Në lidhje me këto materiale hetimore rezulton se është vendosur mosfillimi I procedimit penal për 10 materiale hetimore dhe janë regjistruar 27 procedime penale të reja gjatë vitit 2019.

Referime gjatë vitit 2019



Mosfillime dhe çështje të regjistruara



Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve rezultojnë se është ushtruar ndjekja penale për 27 procedime penal të regjistruara të reja, si dhe ka vazhduar hetimi për 17 procedime penale të mbartura nga viti 2018.

Në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve rezultojnë se nuk ka patur raste arrestimesh në flagrancë, ndalimesh apo caktim masash sigurimi për personat nën hetim.

Në lidhje me këto vepra dhe konkretisht për N.180 të K.Penal nga prokurori në bazë të nenit 270 e vijues të K.Pr.Penale, është kërkuar në një rast vendosja e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro konservative" për 15 automjete të një shoqërie, kërkesë e cila është pranuar edhe nga gjykata.

Gjithsej gjatë vitit 2019 për veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve janë hetuar 44 procedime penale, me 10 persona nën hetim/ pandehur me 0 të arrestuar.

Janë kërkuar pushimi I çështjes/akuzës penale për 7 procedime penale me 1 person nën hetim, ku 6 kërkesa janë pranuar nga gjykata dhe për 1 kërkesë vazhdon gjykimi.


Është vendosur bashkimi për 1 procedim penal, është pezulluar 1 procedim penal, si dhe është shpallur moskompetenca për 1 procedim penal.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar miratimi I marrëveshjes së fajësisë për 2 procedime penale me 2 të pandehur, si dhe nga gjykata janë pranuar kërkesat e prokurorit.


Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I çështjes për gjykim për 1 procedime penale me 2 të pandehur, si dhe nga gjykata janë pranuar kërkesat e prokurorit.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve kanë përfunduar hetimet paraprake për 13 procedime penale me 5 persona nën hetim/pandehur, si dhe kanë mbetur në hetim për vitin 2020 gjithsej 31 procedime penale me 5 të persona nën hetim/pandehur.

Çështje të hetuar gjatë vitit 2019 sipas veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve



Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 dhe të mbetura në hetim për veprat penale në fushën taksave dhe tatimeve



Në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për çështje të mbartura në gjykim që nga vitit 2018, ato të dërguara për gjykim apo miratim marrëveshje fajësie gjatë vitit 2019, gjithsej për 3 procedime penale me 5 të pandehur.

Nga prokurorët në këto gjykime janë kërkuar për 2 të pandehur dënim me gjobë, për 2 të pandehur dënim me burgim dhe për 1 të pandehur aplikim I N.59 të K.Penal “Pezullim I ekzekutimit të dënimit me burgim”, si dhe nga gjykata janë dhënë për 2 të pandehur dënim me gjobë dhe për 3 të pandehur është aplikuar N.59 I K.Penal, si dhe nga prokurori nuk është bërë asnjë ankim për llojin e dënimit.

Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik “Cani 2005” shpk, të akuzuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Mospagim i taksave dhe tatimeve” të parashikuar nga nenet 180 e 181 të K.Penal dhe në përfundim të gjykimit është vendosur sipas kërkesës së prokurorit, dënimi i kësaj shoqërie me 400000 lekë gjobë. Çështja penale në ngarkim të këtij subjekti i përket vitit 2018 dhe është dërguar për gjykim në vitin 2019.

Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik “Cani 2005” shpk, të akuzuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Mospagim i taksave dhe tatimeve” të parashikuar nga nenet 180 e 181 të K.Penal dhe në përfundim të gjykimit është vendosur sipas kërkesës së prokurorit, dënimi i kësaj shoqërie me 400000 lekë gjobë. Çështja penale në ngarkim të këtij subjekti i përket vitit 2018 dhe është dërguar për gjykim në vitin 2019.

Gjatë vitit 2019 është dërguar për gjykim subjekti juridik “Orti” shpk i akuzuar për veprën penale të “Fshehje e të ardhurave” e parashikuar nga neni 180 i K.Penal.

2.Lufta kundër krimit të organizuar

2/a.Prioritetet në luftë kundër krimit të oraganizuar në punën e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan,gjatë vitit 2019:

-Përmirësimi i cilësisë së hetimeve nëpërmjet rritjes të numrit të procedimeve penale/të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe numrit të pandehurve të dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për veprat penale të *Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, trafikimi I narkotikëve, Kultivimi I bimëve narkotike, dhe Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*, parashikuar nga nenet, 283,283/a,284 e 287 të Kodit Penal.

-Rritja e numrit të hetimeve proaktive me qëllim identifikimin, dërgimin në gjykatë dhe dënimin e drejtuesve të organizatave kriminale që lidhen me veprat penale të krimit të organizuar;

-Forcimi i bashkëpunimit me organet dhe agjencitë ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare në rastet e pastrimit të produkteve që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale;

-Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, në funksion të shpejtësisë dhe efektivitetit të së hetimeve;

-Forcim të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të agjencive të zbatimit të ligjit me qëllim kuptimin dhe zbatimin e njëjtë të ligjit dhe evidentimin e praktikave të mira.

2/b.Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, prodhimit,shitjes,transportimit,mbajtjes apo trafikimit të lëndëve narkotike ka qenë një nga drejtimet ku është fokusuar lufta kundër krimit të organizuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me narkotikët (rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore për veprat penale në lidhje me korrupsionin është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Konkretish, gjatë vitit 2019, nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 84 materiale hetimore dhe nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë janë referuar 12 materiale hetimore.

Gjatë vitit 2019 ,në krahasim me vitin 2018 në prokurori për këto vepra penale janë referuar 9 materiale hetimore më shumë.


Përsa i përket veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” (N.284 i K.Penal) rezulton se kjo vepër është më e përhapur në bashkitë Librazhd, Gramsh e Peqin,ku karakteristikë është fakti se bimët narkotike janë mbjellur në sipërfaqe toke shtetërore pranë kufijve ndarëse te qarkut Elbasan me qarqet e tjera,vende këto ku është shumë e vështirë që të shkohet dhe kontrollohet dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore.

Gjatë vitit 2019,në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve N.283,283/a e 284 të K.Penal,nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur mosfillimi I procedimit penal në 2 raste.


Gjatë vitit 2019 për veprat në fushën e narkotikëve janë regjistruar procedime penale të reja 94 procedime,kanë ardhur me moskompetencë 4 çështje penale,si dhe ka vazhduar hetimi për 77 procedime të mbartura nga vitit 2018.

Në lidhje me çështjet penale të regjistruara të reja për veprat penale në fushën e narkotikëve rezulton se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 8 procedime penale më shumë se në vitin 2018.

**Referime gjatë vitit 2019
për N.283,283/a e 284 të K.P**



**Mosfillime dhe çështje të regjistruara
gjatë vitit 2019 për N.283,283/a e 284 të K.Penal**



Në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve vlen për tu theksuar se problematike për hetimin e tyre mbeten kryerja e ekspertimeve toksikologjike, tekniko-kompjuterike në lidhje me telefonat e sekuestruar, si dhe ato mjeko-ligjore në lidhje me faktin e përcaktimit të dozës së sekuestruar, nëse përbën dozë për përdorim vetjak apo jo.

Në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve nga policia gjyqësore është kryer arrest në flagrancë i 46 personave dhe janë ndaluar 2 persona, arrestime në flagrancë dhe ndalime që janë vleftësuar I ligjshëm nga gjykata.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie, në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve janë nxjerrë 6 urdhëra ndalimi, ndalime këto të ekzekutuara nga policia gjyqësore dhe të vleftësuar të ligjshme nga gjykata.

Në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2019 në lidhje me këto vepra penale janë arrestuar në flagrancë 9 persona më shumë dhe janë ndaluar 2 persona më shumë, si dhe është urdhëruar ndalimi nga prokurori për 6 persona më shumë.

Nga prokurorët, gjatë vitit 2019 për veprat penale në fushën e narkotikëve, është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 46 persona dhe nga gjykata për 41 persona janë dhënë masa e sigurimit “arrest në burg”, ku përfshihen dhe ato me afat, si dhe në 1 rast është dhënë masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, për të cilin është ushtruar ankimi, por nga Gjykata e Apelit kjo masë ka ndryshuar në atë të “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”.

Gjithashtu është kërkuar masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” për 9 persona, si dhe nga gjykata është dhënë kjo masë sigurimi 11 persona..

Ndërkohë gjatë vitit 2018 për veprat penale në fushën e narkotikëve, është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 28 persona dhe “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” për 8

persona,ndërsa nga gjykata për 28 persona janë dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” ,ku përfshihen dhe ato me afat,si dhe në 8 raste është dhënë masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

Gjithsej gjatë vitit 2019 janë hetuar 175 procedime penale, me 91 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 36 persona me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në lidhje me personat e hetuar për veprat penale në fushën e narkotikëve rezulton se nga 48 personat/pandehur të hetuar vetëm 1 person ka qenë I mitur 14-18 vjeç,si dhe vetëm 2 persona/pandehur kanë qenë femra..

Përsa I përket arsimimit rezulton se mbi 90% e personave janë me arësim deri në 9 klasë..

Përsa I përket punësimit dhe detyrave rezulton se pjesa më e madhe e personave janë të papunë ose të punësuar në sektorin privat.

Përsa I përket vendbanimit pjesa më e madhe e personave nën hetim/pandehur janë banues në qytet rreth 60% ,si dhe rreth 30% kanë qenë të dënuar për vepra të tjera penale ,ndërsa pjesa tjetër kanë qenë të padënuar.

Për veprat penale në fushën e narkotikëve gjatë vitit 2019 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të mjeteve/technikave të posaçme/special të hetimit ,si dhe konkretisht janë kryer veprime përgjimi ambjental apo telefonik në 75 raste,duke u përfshirë këtu dhe zgjatjet e afateve të përgjimit dhe autorizimet për regjistrimi të fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike.

Gjatë vitit 2019 janë sekuestruar sasia prej 620.6 gram lëndë narkotike e dyshuar si kokainë, 16 gramë lëndë narkotike e dyshuar si heroinë,si 142 kg e 616.5 gram bimë e dyshuar si cannabis sativa e cila korrespondon sasië prej 5319 bimëve.

Nuk ka patur asnjë rast kryerje veprimesh stimuluese,vendime kontrolli vendesh,apo sekuestrosh preventive të caktuara nga gjykata.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur bashkimi I procedimit për 1 procedim penal.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar pushimi I çështjes/akuzës penale për 21 procedime penal me 20 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 0 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Nga gjykata është pranuar kërkesa për pushim për 12 procedime penale,kthim aktesh për 2 procedime penale,si dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 7 kërkesa për pushim çështjeje.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I çështjes për gjykim për 22 procedime penale,për 29 të pandehur,prej të cilëve 18 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2018,gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim 2 procedime penale më pak,si dhe I njëjti numër të pandehurish.

Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim për 13 procedime ,kthim aktesh për 1 procedim,si dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 8 kërkesa për dërgim çështje në gjyq.



Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve nga prokurorët e kësaj prokurorie është pezulluar hetimi për 38 procedime penale, si dhe është shpallur moskompetenca tokësore apo lëndore për 9 procedime penale.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve kanë përfunduar hetimet paraprake për 91 procedime penale me 49 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 14 të arrestuar.

Nga viti 2019 kanë mbetur në hetim për vitin 2020, në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve , 85 procedime penale me 42 të persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 18 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Theksojmë se në kuadër të krijimit të Prokurorisë së Posacme (SPAK) vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”,të parashikuar nga neni 283/a i K.Penal ,që nga muaji dhjetor 2019 është kompetencë lëndore hetimi e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Çështje penale të hetuara për vitin 2019 për N.283,283/a e 284 të K.P **Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 e të mbetura në hetim për N.283,283/a,284 K.P**



Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve ka përfunduar gjykimi për 29 procedime penale, me 39 të pandehur, prej të cilëve 24 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg” dhe 2 të pandehur me masë sigurimi “arrest në shtëpi”.

Në krahasim me vitin 2018 gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për 4 procedime penale më shumë.


Në lidhje me masat e dënimit nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë vitit 2019 në gjykim për veprat penale në fushën e narkotikëve janë kërkuar dënime me burgim për 31 të pandehur, si dhe dënime alternative të “Pezullim ekzekutimi denimi me burgim” të parashikuara nga neni 59 i K.Penal për 7 të pandehur, si dhe për 1 të pandehur është kërkuar tërheqje aktesh.

Nga gjykata janë dhënë dënime me burgim për 25 të pandehur, dënime alternative të parashikuara nga neni 59 i K.Penal për 11 të pandehur, kthim aktesh për 1 të pandehur, si dhe pafajsi për 2 të pandehur, prej të cilëve njëri ka qenë me masë sigurimi “arrest në burg”.


Nga prokurorët janë bërë ankime për 7 vendime penale për të cilat janë dhënë vendime dënimi apo pafajsi, ndryshe nga sa është kërkuar nga prokurori.

Dy pafajsitë e dhëna nga gjykata janë dhënë për dy bashkë të pandehur në të njëjtin procedim penal E.R dhe M.K të akuzuar për nenin 283/2 të K.Penal dhe për këtë vendim marrje të gjykatës është bërë ankim nga prokurori.


Kërkesat e prokurorit për të pandehurit e dënuar për N.283 e 284 të K.P



Dënimet gjykatës për të pandehurit e dënuar për N.283 e 284 të K.P



Të pandehurit e dënuar gjatë vitit 2019 për N.283 e 284 të K.Penal



2/c.Hetimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit,të autorëve të vepra penale të rënda që gjenerojnë të ardhura dhe përfitime të paligjshme, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal si prioritet i luftës kundër krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kasaj prokurorie janë dërguar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë gjithsej 23 informacione për hetimin pasur.

Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) , në zbatim të ligjit nr. 10 192 datë 03.12.2009 ``Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë`` ,si dhe referuar Udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.9 dt.10.12.2019 ``Mbi masat administrative dhe proceduriale në Prokuroritë për Krime të Rënda dhe Prokuroritë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme`` në fund të muajit dhjetor 2019 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë ardhur nga ish-Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për kompetencë gjithsej 87 procedime të hetimit pasuror.

2/ç.Lufta në lidhje me veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Objektiv i punës së prokurorëve në përgjithësi,si dhe atyre të ``Seksionit të Posaçëm të përkohshëm për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, veprat penale në sferën ekonomike, veprat penale të kryera nga subjektet e posaçme`` në veçanti ,gjatë vitit 2019 ka qenë përmirësimi i efektivitetit të hetimeve penale në drejtim të zbatimit efektiv të ligjit, rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë, rritjes së personave të dënuar me vendim të formës së prerë, hetime më të mira financiare dhe procedura të gjetjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve dhe pasurive që burojnë nga krimi; shtimit të përdorimit

të teknikave speciale të hetimit, rritjes së aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, si dhe bashkëpunimi dhe krijimi I skuadrave të përbashkëta hetimore.


Me Urdhërin nr. 63 datë 30.10.2019 ``Për caktimin e pikës së kontaktit me Prokurorinë e Përgjithshme,mbajtjen e të dhënave statistikore dhe raportimet e tyre në lidhje me çështjet penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimin e terrorizmit``, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar caktimin e pikës së kontaktit me Prokurorinë e Përgjithshme,për mbajtjen e të dhënave statistikore dhe raportimet e tyre në lidhje me çështjet penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimin e terrorizmit.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale ,në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal,rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore për veprat penale në lidhje me korrupsionin është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Konkretish nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 17 materiale hetimore gjatë vitit 2019,ndërsa nga nga Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave është referuar vetëm 1 material hetimor.

Është për tu theksuar se për një pjesë të materialeve të referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan,indicije kanë patur informacionet e marra nga Drejtoria e parandalimit dhe pastrimit të parave në Ministrinë e Financave.

Referime gjatë vitit 2019 për N.287 të K.Penal



Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287,nga prokurorët e kësaj prokurorie nuk është vendosur mosfillimi I procedimit penal për ndonjë material hetimor,por janë regjistruar 18 procedime penale të reja,janë rifilluar 4 procedime të pezulluara,si dhe ka vazhduar hetimi për 33 procedime të mbartura nga vitit 2018.

Në lidhje me çështjet penale të regjistruara të reja për këtë veprë penale , rezulton se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 4 procedime penale më pak se në vitin 2018.

Në lidhje me veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 nuk ka patur raste arrestimesh në flagrancë apo ndalimesh personash.

Nga prokurorët,gjatë vitit 2019, në lidhje me veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 nuk ka patur raste që të jetë kërkuar nga prokurori caktim i ndonjë mase sigurimi për personat nën hetim.

Në lidhje me natyrën e veprave penale që kanë paraprirë pastrimin e parave kriteri bazë është fakti i gjenerimit të të ardhurave apo i të mirave materiale nga vepra penale që parashikohen kryesisht nga neni 283 i K.Penal “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike, “Kultivimi i lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 274 i K.Penal, Trafiqet e llojeve të ndryshme të lëndë narkotike, të armëve, të njerëzve, të femrave për prostitucion, si krime transnacionale, të parashikuara nga nenet 110/a, 114/b K.Penal, 278/a K.Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a K.Penal, “Prodhimi dhe mbajtja e armëve luftarake dhe municioneve”, Neni 259 K.Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, Neni 257/a K.Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, Neni 245/1 K.Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Gjithashtu, burim për nga natyra kanë qenë edhe vepra penale të parashikuara nga neni 180 i K.Penal “Fshehja e të ardhurave”, neni 180/a i K.Penal, neni 181 i K.Penal “Mospagimi i taksave dhe tatimeve” etj.

Në këndvështrim të elementeve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, parë në raport me Konventën Evropiane “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, 8 Nëntor 1990 (ratifikuar me ligjin Nr. 8646, datë 17/05/2000) dhe me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar, 12 dhjetor 2000 (ratifikuar me ligjin Nr. 8920, datë 11/07/2002) Konventën e Këshillit të Evropës “Për pastrimin e Parave”, Strasburg, 08/11/1990 (miratuar me ligjin Nr. 8646, datë 20/07/2000 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”) Konventën e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, Varshavë 16 Maj 2005 (ratifikuar me ligjin Nr. 9646, datë 27/11/2006), për të pasur këtë veprë penale duhet të provohen të gjithë elementët e saj mëposhtëm:

-ka pasur këmbim ose transferim pasurish;

-pasuritë ishin produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

-subjekti ishte në dijeni se pasuria ishte produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

-subjekti e ka kryer pastrimin e produkteve kriminale me dashje dhe këmbimi ose transferimi është bërë me qëllim që të fshihej ose mbulohej origjina kriminale e pasurisë ose për të ndihmuar që të shmangeshin pasojat juridike të lidhura me kryerjen e krimit.

Përsa më lart, problemet që lidhen me hetimin e këtyre vepre penale kryesisht kanë të bëjnë me:

- Informalitetin e lartë në shoqërinë shqiptare;
- Pamundësinë për të siguruar të dhëna të sakta e të plota, prova, të cilat tej çdo dyshimi të arsyeshëm justifikojnë ngritjen e akuzës sipas nenit 287 të K.Penal;
- Kryerjen e hetimeve vetëm nëpërmjet verifikimit pasuror, pra duke kërkuar të dhëna nga organe, subjekte ku regjistrohen pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të shtetasve dhe personave juridikë. Shpesh, kërkimi i të dhënave ekspozon hetimet dhe çënon sekretin e tyre. Përpjekjet janë në drejtim të përdorimit të metodave të tjera hetimore, përgjime ambientale e telefonike, nëpërmjet filmimit e regjistrimit, sigurimi i të dhënave për pasuri që mund të jenë regjistruar në emër të shtetasve të tjerë pa lidhje familjare me subjektin;
- Shpesh, në informacionet e sjella mungojnë të dhëna të bazuara mbi ekzistencën e një vepre penale që ka sjellë të ardhura të kundërligjshme ose mungojnë të dhëna për ekzistencën e një pasurie të rrjedhur nga aktiviteti kriminal. Përpjekjet me policinë gjyqësore janë që të kryhen verifikime më të sakta me qëllim shmangien e referimit të rasteve të pavlerë që nuk shpiten në një rezultat pozitiv të hetimeve në drejtim të ndëshkimit të fenomenit.

Për shkak të mossigurimit të provave që lidhen me ekzistencën e një aktiviteti kriminal apo të të ardhurave e pasurive që rrjedhin prej tyre, numri i procedimeve penale të dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal është i ulët.

Personat juridikë janë përfshirë në hetimin e çështjeve penale që lidhen me nenin 287 të Kodit Penal, në rastet kur, përveç krijimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, subjektet e dyshuar kanë krijuar dhe persona juridikë, nëpërmjet të cilëve kryejnë veprimtari tregtare, me qëllim fitimi në qarkullimin civil. Në këto kushte, gjatë hetimit është kryer dhe hetimi pasuror i personave juridikë, duke mos u kufizuar vetëm në hetimin e gjendjes pasurore të shtetasve. Gjithsesi, nënvizojmë se personat juridikë, në rastet e ndjekur nga Prokuroria Elbasan, nuk kanë qenë të dyshuarit kryesorë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjithsej gjatë vitit 2019 janë hetuar 55 procedime penale, me 3 persona nën hetim/ pandehur, prej të cilëve 1 person me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në lidhje me personat e hetuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 rezulton se 3 personat kanë qenë meshkuj mbi 18 vjeç, 1 me arsim deri 9 klasë dhe 2 me arsim të lartë, që të tre me banim në qytet, si dhe dy prej tyre kanë qenë të dënuar më parë për vepra të tjera penale, ndërsa njëri nuk ka qenë i dënuar më parë, si dhe përse i përket punësimit dhe detyrave rezulton se 3 personat e hetuar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, kanë qenë të punësuar në sektorin privat.

Gjatë vitit 2019, në lidhje me hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal nuk ka patur raste të kryerjes së hetimeve proaktive dhe me përdorim të mjeteve/teknikave të posaçme/speciale të hetimit.

Gjatë vitit 2019 është vendosur masa e sigurimit pasuror të sekuistros preventive me vendim gjykate, pas kërkesave të prokurorëve vetëm në 2 procedime penale, në lidhje me hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal dhe konkretisht janë vendosur :

-sekuestro preventive mbi 50% të kuotave të zotëruara nga personi nën hetim në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;

-sekuestro preventive mbi 6 pasuri të paluajtshme të regjistruara në regjistrat hipotekorë;

-sekuestro preventive mbi një autoveturë.

Gjatë vitit 2019 në lidhje veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur bashkimi I procedimit për 1 procedim penal.

Gjatë vitit 2019 në lidhje veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar pushimi I çështjes/akuzës penale për 8 procedime penal,pa persona nën hetim/pandehur,si dhe nga gjykata është pranuar kërkesa për pushim për 4 procedime penale dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 4 kërkesa për pushim çështjeje.

Gjatë vitit 2019,në lidhje me hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal, nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I çështjes për gjykim për 2 procedime penale,me 2 të pandehur,prej të cilëve 1 me masë sigurimi “Arrest në burg”.


Në krahasim me vitin 2018,gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim e njëjta sasi procedimesh penale, 4 të pandehur më pak,si dhe një 3 të pandehur të arrestuar më pak.

Nga gjykata nuk janë gjykuar ende në seancë paraprake këto procedime penale të dërguara për gjykim,të cilat për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim.

Gjatë vitit 2019 ,në lidhje me hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal nga prokurorët e kësaj prokurorie është pezulluar hetimi për 4 procedime penal,si dhe është shpallur moskompetenca tokësore për 2 procedime penale pa persona nën hetim.

Gjatë vitit 2019 ,në lidhje me hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal kanë përfunduar hetimet paraprake për 17 procedime penale me 2 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 1 i arrestuar,si dhe kanë mbetur në hetim për vitin 2020 gjithsej 38 procedime penale me 1 të persona nën hetim/pandehur,jo I arrestuar.

Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 e të mbetura në hetim për N.287 të K.Penal



Gjatë vitit 2019, në lidhje me hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal, nuk ka përfunduar gjykimi për ndonjë procedim penal.

Në gjykatë vazhdon gjykimi edhe I një subjekti juridik dhe konkretisht “Kurum International” sh.a, I akuzuar për veprat penale të “Mashttrim” dhe “Pastrim I produkteve të veprës penale ,të parashikuar nga nenet 143 dhe 287 I K.Penal, I cili është dërguar në gjykim para vitit 2019. Gjikimi nuk ka përfunduar as gjatë vitit 2019 dhe kjo çështje është mbartur në gjykim për vitin 2020.

Problematikë në lidhje me luftën kundër pastrimit të produkteve të veprës penale mbetet numri I paket I oficerëve të shërbimit të policisë gjyqësore që merren me hetimin e këtyre çështjeve penale, si dhe kryerja e ekspertimeve kontabël e vlerësues përkatëse për hetimin e këtyre çështjeve.

2/d. Lufta kundër veprave penale të rënda kundër jetës.

Në kuadër të luftës kundër krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në vecanti, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë janë kryer hetime paraprake në lidhje me vepra penale të rënda kundër jetës të kryera me dashje ku janë regjistruar në total 5 referime nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan dhe konkretisht 2 referime për veprën penale të “Vrasje me paramendim” të parashikuar nga neni 18 i K.Penal, si dhe 3 referime për veprën penale të “Vrasje në rrethana cilësuese” të parashikuar nga neni 79 i K.Penal. Në lidhje me këto vepra penale rezulton se gjatë vitit 2019 ka patur gjithsej 4 persona të vrarë (vdekur).

Në krahasim me vitin 2018 janë referuar 16 materiale hetimore më pak në lidhje me këto vepra penale.

Gjatë vitit 2019, në lidhje me këto vepra penale të rënda kundër jetës të kryera me dashje janë regjistruar 5 procedime penale të reja, ka ardhur për kompetencë 1 çështje penale, si dhe ka vazhduar hetimi për 24 procedime të mbartura nga vitit 2018.

Në lidhje me këto vepra penale janë arrestuar në flagrancë 1 person, si dhe është ndaluar me urdhër të prokurorit 1 person, arrestime dhe ndalime këto të vleftësuar të ligjshme nga gjykata. Nga prokurorët, gjatë vitit 2019 në lidhje me këto vepra të rënda penale kundër jetës nga prokurori janë kërkuar gjithsej për 5 persona caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, kërkesa të cilat janë pranuar edhe nga gjykata.

Gjithsej gjatë vitit 2019 janë hetuar 30 procedime penale, me 13 persona nën hetim/pandehur, prej të cilëve 12 person me masë sigurimi “arrest në burg”.

Gjatë vitit 2019, në lidhje me hetimet për këto vepra penale janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të mjeteve/teknikave të posaçme/speciale të hetimit dhe konkretisht janë kryer në total

112 veprime përgjimesh ambientale apo telefonike ,shifër kjo ku janë përfshirë dhe zgjatjet e afatit të përgjimeve.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me këto vepra penale , nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar pushimi I çështjes/akuzës penale për 3 procedime penal të regjistruara për veprën penale “Vrasje me dashje” të parashikuar nga neni 76 I K.Penal,pa persona nën hetim/pandehur,kërkesa që janë pranuar dhe nga gjykata.


Janë pezulluar hetimet për 2 çështje penale,ku 1 për veprën penale të “Vrasjes me dashje” të parashikuar nga neni 76 I K.Penal dhe 1 çështje për veprën penale “Vrasje me paramendim” të parashikuar nga neni 78 I K.Penal.

Gjatë vitit 2019,në lidhje me këto vepra penale, nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I çështjes për gjykim për 8 procedime penale,me 9 të pandehur të arrestuar,ku nga gjykata është vendosur në seancë paraprake për 1 çështje kthim aktesh për plotësim,për 1 çështje pushim çështje,për 3 çështje dërgimin për gjykim,si dhe për 3 çështje vazhdon gjykimi në seancë paraprake.


Për rastin ku është vendosur pushimi I çështjes në ngarkim të të pandehurit të arrestuar F.Ç,të akuzuar për veprën penale të “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë ,e parashikuar nga nenet 76 e 22 të K.Penal,nga prokurori është ushtruar ankim,si dhe në Gjykatën e Apelit ende nuk ka përfunduar gjykimi i ankimit.

Gjatë vitit 2019 ,në lidhje me veprat penale të rënda kundër jetës kanë përfunduar hetimet paraprake për 13 procedime penale me 9 persona nën hetim/pandehur të arrestuar,si dhe kanë mbetur në hetim për vitin 2020 gjithsej 13 procedime penale me 3 të persona nën hetim/pandehur të arrestuar.

Çështje të hetuar gjatë vitit 2019 sipas veprave penale



Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 dhe të mbetura në hetim



Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprat penale të rënda kundër jetës ka përfunduar gjykimi në themel i çështjeve të mbartura në gjykim që nga viti 2018, si dhe atyre të dërguara për gjykim për 3 çështje me 3 të pandehur të arrestuar.

Nga prokurori për të pandehurin L.T të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 280 të K.Penal dhe i gjykuar me gjykim të zakonshëm, është kërkuar dënimi me 10 vjet burgim dhe nga gjykata është dhënë dënimi me 10 vjet burgim;

Nga prokurori për të pandehurin Sh.H të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 79 gërma “ë” e 22 dhe 278/1 të K.Penal dhe i gjykuar me gjykim të zakonshëm, është kërkuar dënimi me 22 vjet burgim dhe nga gjykata është dhënë dënimi me 10 vjet burgim. Nga prokurori është ushtruar ankimi dhe çështja ende nuk është gjykuar në Gjykatën e Apelit;

Nga prokurori për të pandehurin L.H të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të K.Penal dhe i gjykuar me gjykim të shkurtuar, është kërkuar dënimi me 8 vjet burgim dhe nga gjykata është dhënë dënimi me 8 vjet burgim;

3. Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut

3/a. Prioritetet në punën e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2019 në forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut:

-Rritje e numrit të rasteve të zbatimit të urdhrimit penal, marrëveshjes dhe gjykimit të drejtëpërdrejtë, me synim përmirësimin e efikasitetit të hetimit dhe uljes së normës së kohëzgjatjes mesatare të hetimit të çështjeve;

-Rritje të kërkesave për dhënien e dënimeve alternative për autorë dhe vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore;

-Rritje të numrit të masave alternative që synojnë shmangien e të miturit autor të veprës penale nga procedimi penal;

-Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;

-Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale për rastet me të mitur dëshmitar dhe viktimë të veprës penale;

-Ashpërsim të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit të fëmijëve;

-Hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

-Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve me fokus specializimin dhe krijimin e profesionistëve që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Politika që ka ndjekur kjo prokurori për vitin 2019, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre, për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Si autoritet përgjegjës për garantimin e të drejtave të të pandehurve dhe të viktimës gjatë fazës së hetimeve paraprake, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë treguar kujdes në njohjen e tyre, me të drejtat që ata gëzojnë, mbështetur në dispozitat procedurale penale dhe angazhimin pozitiv, për të mundësuar realizimin e këtyre të drejtave.

Viktimat dhe të pandehurit janë njohur me të drejtat e tyre ,të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale,si dhe në përfundim të hetimeve gjithashtu u është vënë në dispozicion kopje e akteve vendimmarrëse duke i bërë të ditur të drejtën e ankimit. Në rastet kur viktimat ka ndërruar jetë, janë bërë përpjekje për të gjetur dhe njoftuar trashëgimtarët e tyre.

Me Udhëzimin nr. 23 datë 27.03.2019 *``Për masat ndaj dhunës në familje``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar marrjen e masave përkatëse në lidhje me dënimet,si dhe në lidhje me caktimin e masave të sigurimit poër personat autorë të veprave penale të dhunës në familje;

Me Urdhërin nr. 38 datë 17.06.2019 *``Për pasqyrimin e të dhënave statistikore për veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore dhe për veprat penale me të dëmtuar ose autorë të mitur``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për pasqyrimin e të dhënave statistikore për veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore dhe për veprat penale me të dëmtuar ose autorë të mitur;

Në rastet që qytetarët apo subjektet e tjera, kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, apo edhe kur vetë prokurorët kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e tyre, nga ushtrimi i ndjekjes penale në çështje të caktuara, nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, është proceduar me marrjen e vendimeve përkatëse, në respektim të dispozitave procedurale penale, neni 16 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

Përgjithësisht nga ana e viktimave apo edhe të pandehurve, të drejtat që janë ushtruar kanë pasur të bëjnë me kërkesat që i kanë drejtuar organit procedues për të marrë informacion në lidhje me procedimet penale ku janë të përfshirë si palë, për të kërkuar kryerje veprimesh hetimore shtesë e të tjera. Nga ana e prokurorëve është ndjekur praktika e dhënies përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të parashtruara, duke u marrë edhe vendimet përkatëse mbi kërkesat e palëve.

Në respektim edhe të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, qytetarëve apo subjekteve të ndryshme, iu është dhënë përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të tyre. Nga ana e ish Drejtuesit të kësaj prokurorie, që në vitin 2017, janë ndërmarrë masa, për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, pasqyruar në Urdhërin nr. 1 datë 17.02.2017 *``Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan``*, sipas të cilit rezultojnë të jetë miratuar rregullorja përkatëse, e cila rezultojnë aktualisht të

jetë në fuqi.Me Urdhërin nr. 02 datë 06.03.2017 ``Për shërbimin e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan`` nga ish Drejtuesi, është caktuar prokurori që drejton dhe mbikqyr shërbimin e marrëdhënieve me publikun si dhe nëpunësja e marrëdhënieve me publikun dhe koordinatore në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.

Në dhënien e informacioneve, sipas ligjit nr. 119/2014 ``Për të drejtën e informimit`` është mbajtur parasysh ruajtja e sekretit hetimor apo atij shtetëror. Për realizimin e këtyre momenteve, ka qenë e rëndësishme koordinimi i punës mes zyrës së marrëdhënieve me publikun, me prokurorin e çështjes. Gjatë këtij procesi nga ana e kësaj prokurorie, janë respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke ruajtur të dhënat personale, pasur parasysh të drejtën për jetë private. Sipas librit të korrespondencës për të drejtën e informimit, rezultojnë të jenë trajtuar për vitin 2019 gjithsej 56 kërkesa, të kryera në mbështetje të këtij ligji,në krahasim me 15 kërkesa të trajtuara gjatë vitit 2018.

Përsa i përket pretendimeve të ndryshme nga qytetarët në letra të shkruara prej tyre, përgjithësisht është ndjekur si procedurë, thirrja e qytetarëve në rastet kur prej tyre ka pasur pretendime për ekzistencën e ndonjë veprë penale, dhe marrja e kallzimit penal nga oficeri i policisë gjyqësore sipas grafikut të gatishmërisë, në ditët e ardhjes së letrës apo në rast ngarkese të këtij të fundit, kallzimi penal është marrë nga një oficer tjetër i policisë gjyqësore i kësaj prokurorie. Thirrja e qytetarëve për të parashtruar pretendimet e veta në formën e kallzimit kur kanë pasur pretendime për vepra penale, është bërë mbështetur në respektimin e dispozitave proceduriale penale, neni 283 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

3/b.Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima:

Siç u theksua edhe më sipër, politika që ka ndjekur kjo prokurori për vitin 2019, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

N lidhje me veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore, Urdhëri nr. 31 datë 30.04.2018 ``Për organizimin dhe funksionimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan``, gjatë vitit 2019 ka pësuar ndryshime, dhe në këtë Prokurori kanë vazhduar funksionimin Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër personit, krimeve kundër jetës, veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore etj,si dhe Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me të pandehur dhe viktima të mitura,si dhe për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

Prokurorët e caktuar në këto seksione, përgjatë vitit 2019,kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës apo institucione të tjera ndërkombëtare,me objekt dhunën në bazë gjinore ,si dhe njohuritë e përftuara në këtë drejtim, janë munduar t'i zbatojnë në punën e tyre të përditshme dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm me organizmat e ndryshëm shtetërore, lokale, qendrore apo shoqatat jo fitim prurëse.

Në këtë kuadër, me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut, ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme në ambjentet e kësaj prokurorie, për realizimin e pyetjes/intervistimit të të miturve si dhe personave që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore, është ardhur, një zyrë e cila gjendet në katin e parë të godinës së kësaj prokurorie, me qëllim për të distancuar viktimën e dhunës me bazë gjinore apo të miturin, nga përballja me ambjentet e tjera të prokurorisë apo personat e ndryshëm që mund të gjenden në to, duke pasur parasysh vulnerabilitetin e tyre.

Në mbështetje të VKM nr. 334 datë 17.02.2011 *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”*, në këtë Prokurori gjatë vitit 2019 kanë vazhduar të zbatohen Marrëveshjet të cilat mbajnë datat 20.06.2018 me Bashkinë Gramsh dhe 17.07.2018 me Bashkinë Belsh, ku palë nënshkruese edhe kanë qenë dhe subjekte të tjera siç është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisaritetet përkatëse të policisë, Zyrën e Përmbarrimit Elbasan, institucionet shëndetësore, arsimore, zyrën e punësimit, shoqatën „*Forumi i gruas*“ Elbasan, dhe prefektin.

Objekti i këtyre marrëveshjeve është koordinimi i punës dhe bashkëpunimi midis institucioneve, për të adresuar rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes një mekanizmi referimi.

Në zbatim të Urdhërit nr. 53 prot datë 05.07.2018 *“Për caktimin e personit të kontaktit për komunikimet me organizmat e ndryshme në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore si dhe të specialistit që do të jetë pjesë e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor”* të ish-Drejtuesit të kësaj prokurorie, mbështetur në VKM nr. 334 datë 17.02.2011 *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”*, në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura si më sipër, vazhdon punën personi i caktuar si person kontakti, të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura, si dhe përgjegjës për dhënien rrugë përgjigjeve të nevojshme, si dhe një prokuror i caktuar si pikë kontakti në Ekipin Teknik Ndërdisciplinor.

Gjatë vitit 2019, përsa i përket këtij momenti, pra të miturve dhe grupeve vulnerabël, mbajmë parasysh se në zbatim edhe të Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, është punësuar pranë kësaj Prokurorie edhe kordinatorë për subjektet me status të posaçëm, ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin, viktimat e mitur, subjektet e dhunës me bazë gjinore, si dhe personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 37/2017 *“Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”*. Për qarkun e Elbasanit, janë caktuar dy psikologe vlerësuese dhe asistuese dhe dy psikologe asistuese. Duke pasur parasysh numrin e çështjeve, ku përveç pranisë së detyrueshme në rastet me të dëmtuar apo autorë të mitur, vlerësohet prania e psikologut edhe në çështjet e dhunës me bazë gjinore, si dhe shtrirjes territoriale që ka qarku i Elbasanit, do të ishte me vend rritja e numrit të psikologëve.

Puna që kryen kjo prokurori, në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të tyre, ka si fokus kryesor shmangien e riviktimizimit apo viktimizimit të përsëritur dhe bashkërendimin me gjithë aktorët e tjerë, me qëllim sigurimin e mundësive viktimave për të venë në vend të drejtat e tyre dhe për t'u rehabilituar.

3/c.Personat autorë veprash penale dhe të pandehurit e mitur:

Në lidhje me të pandehurit e mitur rezultojnë gjatë vitit 2019 janë referuar në Prokurorinë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan 71 materiale hetimore ,për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penale për 38 materiale,si dhe janë regjistruar gjithsej 33 procedime penale të reja me 42 të persona/pandehur dhe vetëm njëri me masën e sigurimit ``arrest në burg``.

Nga të pandehurit e mitur 36 kanë qenë meshkuj dhe 6 femra,si dhe të dënuar më parë kanë qenë 4 persona.

Sipas grupmoshës 5 persona kanë qenë deri në 14 vjeç,23 të grupmoshës 14-16 vjeç,si dhe 14 të grupmoshës 16-18 vjeç.

Në lidhje me veprat penale të kryera nga të miturit rezultojnë se të miturit më së shumti kanë kryer veprën penale të ``Vjedhje`` parashikuar nga neni 134 i K.Penal,gjithsej 13 persona të mitur,ku njëri prej tyre përsëritës në kryerjen e veprës penale ka qenë me masë sigurimi ``arrest në burg``.

Paskësaj vepra penale më e përhëpur e kryer nga të miturit është ajo e ``Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt`` të parashikuar nga neni 291 i K.Penal,gjithsej 12 persona.

Përsa i përket veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe konkretisht ``Prodhimi dhe shitje e narkotikëve`` e parashikuar nga neni 283 i K.Penal rezultojnë se persona nën hetim kanë qenë gjithsej 5 të mitur.

Në lidhje me çështjet penale ku autorë janë të miturit rezultojnë se gjatë vitit 2019 është kërkuar pushimi ose janë pushuar 7 procedime penale me 4 persona nën hetim,është shpallur moskompetenca për 1 procedim penal,janë pezulluar 3 procedime penale.


Është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim për 6 procedime me 7 të pandehur,ku nga gjykata janë pranuar 5 kërkesa për dërgim çështje në gjyq,si dhe është pushuar një çështje.

Janë gjykuar gjatë vitit 2019 gjithsej 5 çështje ku janë aplikuar masa alternative shmangie nga dënimi sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Te dhëna për referime ,mosfillime e procedime për persona/pandehur të miturit viti 2019

Referime	Mosfillime	Ceshtje te regjistruara	Persona nen hetim/pandehur	Arrestuar
71	38	33	42	1

Mënyra e përfundimit të çështjeve me persona/pandehur të mitur gjatë vitit 2019 dhe ato të mbetura në hetim



Të dhëna për personat/pandehur të mitur gjatë vitit 2019

Mosha			Gjinia		Gjendja gjyqësore	
Deri 14 vjec	14-16 vjec	16-18 vjec	Meshkuj	Femra	Te denuar	Te padenuar
5	23	14	36	6	4	38

Të dhëna për personat/pandehur të mitur për vitin 2019 sipas veprave penale

Vepra penale sipas neneve	Persona/pandehur
N.85	1
N.89	3
N.100/1	3
N.109/b/1	3
N.134	13
N.150	1
N.279	1
N.283	5
N.291	12
Totali	42

3/c. Viktimat e mitur nga veprat penale:

Përsa i përket grupit të të miturve viktimat e veprave penale rezultojnë se gjatë vitit 2019 janë trajtuar 56 procedime penale me 72 të viktima të mitur, prej të cilëve:

- 20 femra dhe 52 meshkuj
- 1 i mitur ka qenë me shtetësi të huaj dhe 71 me shtetësi shqiptare.

Në lidhje me pasojat në shëndet rezulton se janë plagosur lehtë 12 viktimat e mitur, janë plagosur rëndë 4 viktimat e mitur, si dhe kanë vdekur 3 viktimat e mitur.

Në lidhje me viktimat të plagosur lehtë 6 të mitur kanë qenë viktimat e veprës penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", e parashikuar nga neni 290 i K.Penal, ndërsa 2 të mitur kanë qenë viktimat e veprës penale "Dhuna në familje" e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal.

Në lidhje me viktimat të plagosur rëndë 3 të mitur kanë qenë viktimat e veprës penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", e parashikuar nga neni 290 i K.Penal, ndërsa 1 i mitur kanë qenë viktimë e veprës penale "Plagosje e rëndë me dashje" e parashikuar nga neni 88 i K.Penal.

Në lidhje me viktimat e vdekura 1 i mitur ka qenë viktimë e veprës penale "Vrasje nga pakujdesia" e parashikuar nga neni 85 i K.Penal, 1 i mitur kanë qenë viktimë e veprës penale "Mjekim i pakujdesshëm", e parashikuar nga neni 96 i K.Penal, ndërsa 1 i mitur kanë qenë viktimë e veprës penale "Shkaktim i vetëvrasjes" e parashikuar nga neni 99 i K.Penal.

Gjatë vitit 2019 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë janë regjistruar edhe 18 çështje penale ku dëshmitarë kanë qenë 21 të mitur.

3/d. Viktimat femra nga vepra penale:

Përsa i përket grupit viktimave të veprave penale të gjinisë femërore rezulton se gjatë vitit 2019 janë trajtuar mjaft procedime penale me ku numri total i viktimave femra ka qenë 152 ,prej të cilave 14 të mitura, ku pjesa më e madhe e tyre kanë qenë viktimat e veprave penale "Dhunë në familje" të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, gjithsej 81 femra.

Të dhëna për viktimat femra nga veprat penale gjatë vitit 2019

Veprat penale sipas K.Penal	Numri i viktimave femra
N.89	28
N.96	1
N.99	26
N.100	2
N.106	1
N.108	1
N.130/a	80
N.134	1
N.290	12
Totali	152


3/dh.Veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës,të parashikuara në seksionin XI Kreu II I K.Penal (nenet 124-130/a të K.Penal) gjatë vitit 2019:

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve , se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.


Konkretish nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë janë referuar 135 materiale hetimore gjatë vitit 2019,ndërsa nga shtetasit janë bërë 4 kallëzime penale në prokurori. Është për tu theksuar fakti se në pjesën më të madhe të referimeve të ardhura nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore vepra më e përhapur ka qenë ajo e “Dhunës në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal dhe konkretisht 120 referime.

Gjatë vitit 2019,në lidhje me veprat penale veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës,nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur mosfillimi I procedimit penal për 20 materiale hetimore.

Gjatë vitit 2019 për këto vepra penale janë regjistruar procedime penale të reja 119 procedime dhe ka vazhduar hetimi për 36 procedime të mbartura nga vitit 2018.



Çështje të regjistruara gjatë vitit 2019 për nenin 130/a te K.Penal krahasuar me veprat e tjera penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës



Në lidhje me çështjet penale të regjistruara të reja për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës rezulton se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 17 procedime penale më shumë se në vitin 2018.

Në lidhje me këto vepra penale janë kryer 47 arrestime në flagrancë nga policia gjyqësore dhe që të gjitha për veprën penale të “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a I K.Penal, arrestime në flagrancë të cilat janë vleftësuar të ligjshëm nga gjykata.

Në krahasim me vitin 2018 ,gjatë vitit 2019 në lidhje me këto vepra penale janë arrestuar në flagrancë më 4 persona shumë

Nga prokurorët,gjatë vitit 2019 janë kërkuar masa sigurimi vetëm për persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a I K.Penal dhe konkretisht është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 37 persona , “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 9 persona,si dhe masë ndaluese për 1 person.

Nga gjykata janë dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” për 35 persona , “arrest në shtëpi” për 2 persona, “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 9 persona,si dhe masë ndaluese për 1 person.

Ndërkohë gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 36 persona , “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 6 persona,si dhe masë ndaluese për 1 person,ndërsa nga gjykata janë dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” për 34 persona , “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 8 persona,si dhe masë ndaluese për 1 person.

Gjithsej gjatë vitit 2019 janë hetuar 155 procedime penale, me 95 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 35 persona me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në lidhje me personat e hetuar për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës rezulton se që të 95 personat kanë qenë mbi 18 vjeç,prej të cilëve mbi 90% kanë qenë meshkuj,mbi 75% kanë qenë me arsim deri në 9 klasë,mbi 50% banues në fshat,pjesa më madhe të papunë apo të punësuar në subjekte private.

3 persona kanë qenë përsëritës për të njëjtën vepër penale,14 të dënuar për vepra të tjera penale,ndërsa pjesa tjetër kanë qenë të padënuar.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar pushimi I çështjes/akuzës penale për 28 procedime penal me 8 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 2 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Nga gjykata është pranuar kërkesa për pushim për 4 procedime penale,kthim aktesh për 1 procedim, dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 24 kërkesa për pushim çështjeje.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie janë pezulluar hetimet për një procedim penal, për shkak të letërporosisë.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar për 1 procedim me 1 të pandehur miratim urdhër penal, i cili është refuzuar nga gjykata.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar për 7 procedime me 7 të pandehur, miratim marrëveshje fajësie, si dhe nga gjykata janë miratuar marrëveshjet e fajësisë.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie është kërkuar dërgimi I cështjes për gjykim për 61 procedime penale me 69 të pandehur, prej të cilëve 26 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim 5 procedime penale më pak, 1 I pandehur më shumë, si dhe një 4 të pandehur të arrestuar më pak.


Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit për dërgimin e cështjes për gjykim për 20 procedime dhe pushim cështje/akuze për 3 procedime, si dhe për vitin 2020 kanë mbetur për gjykim 41 kërkesa për dërgim cështje në gjyq.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie është shpallur moskompetenca tokësore apo lëndore për 2 procedime penale.

Gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës kanë përfunduar hetimet paraprake për 97 procedime penale me 86 persona nën hetim/pandehur, prej të cilëve 26 të arrestuar.

Nga viti 2019 kanë mbetur në hetim për vitin 2020, në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, 58 procedime penale me 17 të persona nën hetim/pandehur, prej të cilëve 9 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Çështje të përfunduara gjatë vitit 2019 dhe të mbetura në hetim për veprat penale kundër fëmijëve, familjes e martesës



Gjatë vitit 2019, në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës ka përfunduar gjykimi për 71 procedime penale, me 77 të pandehur, prej të cilëve 22 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg”.


Në krahasim me vitin 2018 gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për 6 procedime penale më shumë dhe për 7 të pandehur më shumë.

Në lidhje me masat e dënimit nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë vitit 2019 në gjykim për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës janë kërkuar dënime me gjobë për 2 të pandehur, dënime me burgim për 36 të pandehur, si dhe dënime alternative të “Pezullim ekzekutimi denimi me burgim” dhe “Punë në interes public” të parashikuara nga nenet 59 e 63 të K.Penal për 37 të pandehur, si dhe për 3 të pandehur është kërkuar pushim çështje dhe caktim mase mjekësore.


Nga gjykata janë dhënë dënime me gjobë për 2 të pandehur, me burgim për 30 të pandehur, dënime alternative të parashikuara nga nenet 59 e 63 të K.Penal për 42 të pandehur, si dhe pushim çështje dhe caktim masë mjekësore për 3 të pandehur..

Nga prokurori është ushtruar ankim për 2 vendime të dhën nga gjykata.


Kërkesat e prokurorit gjatë vitit 2019 për të pandehurit e dënuar për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës



Dënimet e dhëna nga gjykata gjatë vitit 2019 për të pandehurit e dënuar për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës



Të pandehurit e dënuar gjatë vitit 2019 për N.130/a të K.Penal në krahasim me veprat e tjera kundër fëmijëve, familjes dhe martesës



Në lidhje me mënyrën e përfundimit të procedimeve penale për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, rezultojnë se gjykimi i drejtpërdrejtë, zbatimi I urdhërit penal dhe marrëveshjet e pranimit të fajësisë vijojnë të mbeten një nga llojet e gjykimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë.

4. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional.

4/a. Prioritetet në punën e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2019:

- Rritja e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në funksion të përmirësimit të cilësisë së veprimeve hetimore sidomos të metodave speciale të hetimit dhe identifikimit dhe sekuestrimit të aseteve kriminale lidhur me veprat penale të terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, lëndëve narkotike dhe krimeve të tjera të rënda me ndikim të lartë shoqëror;
- Forcimi i bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit;
- Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore dhe agjencitë ligjzbatuese vendase dhe të huaja në drejtim të përmirësimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Trajnime të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore me fokus rritjen e kapaciteteve profesionale të këtyre të fundit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave veçanërisht në rastet e hetimeve të krimit të organizuar, korrupsionit, hetimeve financiare, evazionit fiskal; krimit kibernetik;
- Forcimi i koordinimit ndërinstytucional në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit.

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ai ndërkombëtarë ndërmjet agjencive ligjzbatuese ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj grupeve të strukturara kriminale dhe

është premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së organit të prokurorisë lidhur me hetimin dhe goditjen e kriminalitetit.

Problematikat dhe rekomandimet e paraqitura nga institucionet që kanë në varësi struktura që kanë statusin e oficerëve të policisë gjyqësore lidhen me forcimin e bashkëpunimit dhe përfshirjen e oficerëve në hetimin e çështjeve ose në grupe hetimore të përbashkëta veçanërisht në çështjet komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinimin me prokurorinë në funksion të rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve që kryhen prej tyre.

4/b.Bashkëpunimi ndërinstitucional:

Gjatë vitit 2019 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore, janë regjistruar kryesisht, janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të institucioneve të tjera publike, si dhe janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të shtetasve apo subjekteve fizikë apo juridikë gjithsej 3297 materiale hetimore.

Në lidhje me këto material hetimore në 601 raste është vendosur mosfillimi I procedimit penal, në 2579 raste janë regjistruar procedime të reja penale, në 14 raste kanë kaluar aktet e para hetimore për kompetencë në Prokurori të tjera, si dhe 103 materiale hetimore kanë mbetur për verifikim për vitin 2020.

Nga statistikat e prokurorisë për vitin 2019 konstatohet se:

- **3068** materiale hetimore janë referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit, ose rreth **93 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **14** materiale hetimore janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, drejtori të tjera policie apo në Ministrinë e Brendshme, ose rreth **0,42 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **58** materiale hetimore janë referuar nga shërbimi I policisë gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, ose rreth **1,76 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **3** materiale janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit tatimor (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), ose rreth **0,09 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **2** materiale hetimore janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit doganor (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), ose rreth **0,06 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **1** kallëzim penal ka ardhur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose rreth **0,03 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **17** kallëzime penale kanë ardhur nga Inspektoriati I Mbrojtjes së Territorit Bashkia Elbasan, ose rreth **0,50 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **4** kallëzime penale kanë ardhur nga Inspektoriati Shtetëror I Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit Dega Elbasan ose rreth **0,12 %** e materialeve hetimore të regjistruara;

- 1 kallëzim penal ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit Tiranë ose rreth **0,03 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- 17 materiale e çështje kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e tjera apo Prokuroria e Përgjithshme ose **0,50 %** të materialeve hetimore të regjistruara;
- 65 kallëzime penale janë regjistruar në prokurori të bëra nga shtetasit ose rreth **1,97 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- 45 materiale hetimore janë referuar nga oficerët e Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ose rreth **1,4 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- 4 materiale hetimore janë regjistruar kryesisht nga prokurorët e kësaj prokurorie, ose rreth **0,12%** e materialeve hetimore të regjistruara.

Përveç referimeve nga policia e shtetit, numri i referime të tjera vijon të jetë i ulët, edhe pse konstatohet një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2018.

Në punën e Prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2019 bashkëpunimi me oficerët e policisë gjyqësore dhe përfshirja e tyre në hetim, është bërë me qëllimin e rritjes së efektivitetit të burimeve njerëzore, realizimit të hetimeve të plota dhe të gjithanshme, si dhe finalizim me sukses të çështjeve të regjistruara, duke shmangur referimet fiktive dhe hetime të dështuara me pasojë moshetimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të elementëve të rrezikshëm kriminalë.

Bashkëpunimi me policinë e shtetit, është një bashkëpunim, që ka një rol kryesor dhe domethënës në luftën ndaj kriminalitetit.

Përgjithësisht është pikërisht policia e shtetit, që gjendet e para në vendngjarje, që referon materialet në prokurori dhe gjithashtu nën drejtimin dhe udhëzimet e prokurorit, kryen hetime. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë Vendore Elbasan si dhe me Komisaritatet përkatëse të shtrira në gjithë territorin ku kjo prokurori ushtron kompetencën territoriale, ka qenë i ngushtë, për t'u vlerësuar dhe përgjithësisht frytdhënës.

Janë kryer analiza të përbashkëta, me përfaqësues të policisë së shtetit, jo vetëm të qarkut por edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për çështje të natyrës së veçantë (pra referuar procedimeve penale konkrete) apo edhe të natyrës së përgjithshme (rritjen e bashkëpunimit, në drejtim të zbardhjes së ngjarjeve, shkëmbimit të informacionit sa më shpejt dhe në mënyrë sa më frutdhënëse, mundësitë që u ofrohen oficerëve të policisë së shtetit për trajnim) etj. Në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, është analizuar mundësia dhe ka nisur puna për studimin e dosjeve të pezulluara ndër vite, me qëllim rifillimin e tyre, pa u plotësuar afatet e parashkrimit, për të shfrytëzuar të gjitha planet hetimore, që mund të bëhen të realizueshme sot për shkak të mundësive të shfrytëzimit të mjeteve të reja të kërkimit të provës.

Gjithashtu një bashkëpunim i ngushtë gjatë vitit 2019 ka qenë edhe me shërbimet e policisë gjyqësore të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si në Ministrinë e Brendshme, ashtu dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, gjë që ka sjellë si pasojë hetimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të disa rasteve të veprimeve të kundraligjshme të punonjësve të policisë së shtetit në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, ku përfshihen dhe punonjës policie të Komisariateve të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie.

Sipas të dhënave të sipër cituar vlen të theksohet dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, për evidentimin e rasteve të futjes së sendeve të palejueshme nëpër burgje, si dhe veprimeve të kundraligjshme të kryera nga funksionarë apo punonjës të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim dhe policisë së burgjeve.

Në lidhje me materialet hetimore të referuara nga këto shërbime të policisë gjyqësore, vlen të theksohet se duhet të punohet më shumë me oficerët e policisë gjyqësore për ngritjen e tyre profesionale, pasi realisht lë për të dëshiruar përgatija e materialeve të para hetimore, si dhe më pas hetimi me cilësi i procedimeve penale të regjistruara.

Siç është pasqyruar më lart, rastet e hetimeve të filluara kryesisht nga prokurorët, mbeten të ulëta. Ky fakt lidhet shpesh me punën e policisë gjyqësore, e cila referon menjëherë materialin sapo merr dijeni për kryerjen e veprës penale. Në rastet kur prokurorët kanë konstatuar vetë fakte penale nuk kanë hezituuar të fillojnë çështje kryesisht, çështje të cilat janë regjistruar kryesisht pasi është marrë informacion nga media apo kanë rezultuar fakte të reja në lidhje me vepra të tjera penale, gjatë hetimeve të çështjeve në ndjekje.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie mbi 90% e rasteve të referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore të sipër përmendura u janë deleguar për veprime oficerëve të këtyre shërbimeve.

Pamvarsisht kësaj për veprime të shpejta në lidhje më një pjesë të çështjeve penale të hetuara për vitin 2019, u janë deleguar për veprime hetimore dhe janë hetuar nga oficerë të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe konkretisht 878 procedime penale, nga totali prej 3792 procedimesh penale të hetuara në total në këtë prokurori.

Pra sa më sipër rezulton se 23% e çështjeve të hetuara në këtë prokurori gjatë vitit 2019, janë hetuar nga oficerë të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndërsa 77% e çështjeve është hetuar nga oficerë të shërbimeve të policive të tjera gjyqësore, ku pjesën më të madhe e zënë shërbimet e policisë gjyqësore në vartësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Institucione të tjera ligjzbatuese me të cilat kjo prokurori ka pasur bashkëpunim të ngushtë, është Shërbimi Informativ i Shtetit, ku për shkak të specifikës së punës së këtij shërbimi, në çdo rast informacionet e ardhura nga ky shërbim, u kanë kaluar menjëherë shërbimeve të policisë gjyqësore, për tu bërë më pas e mundur referimi i materialeve hetimore dhe kryerja e hetimeve sa

më të shpejta dhe cilësore për sqarimin e informacioneve dhe përcaktimin e ekzistencës së veprave penale dhe vënien para përgjegjësisë penale të personave përgjegjës.

Në këtë analizë vlen të përmendim, se sa i përket bashkëpunimit me agjensitë e ndryshme ligjzbatuese, nga këto agjensi duhet të bëhen përpjekje maksimale që të rriten referimet për kryerje veprash penale.

Nga puna e bërë rezulton se në shumë raste agjensitë e hetimit tatimor apo doganor janë mjaftuar vetëm me njoftimin pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan apo Komisaritet përkatëse të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie, për konstatimin e rasteve të veprave penale në fushën e tatimeve apo doganave, duke mos plotësuar vetë tërë dokumentacionin përkatës dhe më pas bërjen e kallëzimeve penale në bazë të legjislacionit përkatës që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre sic janë ligjet mbi procedurat tatimore, ligjet mbi akcizat, apo Kodi Doganor. Në këtë mënyrë ngarkohet me veprime hetimore policia e shtetit, ndërkohë që në këto raste ajo duhet të ishte vetëm mbështetëse e veprimtarisë së këtyre agjensive ligjzbatuese.

Gjithashtu në funksion të hetimeve të shpejta dhe forcimit të masave ndëshkuese nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit, gjatë vitit 2019 duhet të rritet bashkëpunimi me drejtues të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, për të bërë të mundur zbardhjen e fakteve penale në fushën e mjedisit dhe parandalimin e dëmtimeve në mjedis.

Në këtë prokurori, sic u përmend edhe në pjesët e më sipërme të kësaj analize, është treguar impenjimi maksimal për bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm përsa i përket luftës ndaj dhunës me bazë gjinore, apo sigurimin e të drejtave më të përforcuara ndaj të miturve.

Përfaqësues të kësaj prokurorie kanë marrë pjesë vazhdimisht në mbledhjet e grupeve të punës me aktorë të tjerë institucionalë ose jo institucionalë të krijuara në kuadër të planeve kombëtare në luftën kundër dhunës me bazë gjinore, apo në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Në punën e tyre, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, shfrytëzojnë në maksimum bashkëpunimin me agjensitë e tjera ligjzbatuese, me institucionet e ndryshme shtetërore, siç janë për t'u theksuar Drejtorja e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Inspektoriatet përkatëse të Mjedisit, të Ndërtimit, Ministrinë përkatëse etj.

Një bashkëpunim i ngushtë ka qenë dhe me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, institucione këto ku janë transmetuar nga ana jonë shqetësimet në punën tonë në zbatim të ligjit, si dhe njohja me/dhe zbatimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, zbatimin e vendimeve të KLP-së, si dhe raportimi në kohë dhe sa më i saktë i të dhënave statistikore apo informacioneve të kërkuara.

Bashkëpunim i ngushtë është mbajtur edhe me Prokurorinë e Apelit Durrës ku nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit janë dërguar sa më shpejt që është e mundur njoftimet në lidhje me përfundimin e gjykimeve në apel dhe sidomos në lidhje me kërkesat e prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake.

Gjithashtu nga secili prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si verbalisht, ashtu dhe në mënyrë shkresore, ju është dhënë në kohë informacioni prokurorëve të apelit në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjyqimit në Gjykatën e Apelit Durrës të ankimeve të bëra nga prokurorët e shkallës së parë.

Nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është treguar një kujdes i vecantë në lidhje me kthimin e përgjigjeve, dërgimin e informacioneve dhe dokumentacioneve të kërkuara nga organet e krijuara në kuadër të Reformës në Drejtësi për zbatimin e procesit të vlerësimit kalimtar që janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioni i Pavarur i Apelit.

Sipas parashikimit të legjislacionit përkatës procedural penal, si dhe ligjeve përkatëse për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të prokurorisë dhe gjykatës një bashkëpunim i vecantë është mbajtur dhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për sa i përket gjyqimit në kohë të kërkesave të prokurorëve gjatë fazës së hetimit paraprak, konstatimit të problematikave të ndryshme në lidhje me pjesëmarrjen e prokurorëve në seanca gjyqësore dhe respektimin e solemnitetit në këto seanca gjyqësore.

Një bashkëpunim i ngushtë gjatë vitit 2019 ka qenë dhe me Shkollën e Magjistraturës, ku nga prokurorët në vazhdimësi është ndjekur procesi i trajnimit vazhdues për rritjen profesionale dhe specializimin e prokurorëve për njohje dhe zbatim të legjislacionit penal dhe praktikave më të mira gjyqësore kombëtare apo ndërkombëtare.

Në rastin kur agjensi të tjera dërgojnë ftesa që lidhen me çështje të vecanta, janë propozuar fillimisht të shkojnë prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore të caktuar pikërisht në seksionet përkatëse dhe në rast pamundësie objektive të tyre, kanë shkuar prokurorët apo oficerët e tjerë të policisë gjyqësore.

4/c. Bashkëpunimi ndërkombëtar:

Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, specifikisht nga pala shqiptare në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë 5 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit dhe nga gjykata është vendosur ekstradimi për 2 persona.

Nuk ka patur raste që të jetë kërkuara nga prokurorët e kësaj prokurorie ekstradim nga jashtë shtetit personash të dënuar.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë në gjykatë 24 kërkesa për ekzekutim të letërporosive të ardhura nga autoritet e huaja, si dhe nga gjykata është disponuar dhe janë ekzekutuar gjithsej 14 letërporosi, ndërsa për 10 letërporosi rezulton se ka qenë e pamundur që të ekzekutuar pavarësisht veprimeve të prokurorit dhe gjykatës.

Letër porosi të dërguara nga prokurët e kësaj prokurorie, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 20 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:

- 2 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 12 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- 6 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit;

Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja rezulton të kenë qenë 11 ku nga gjykata është njohur vendimi i dënimit të dhënë nga autoritetet e huaja në 7 raste, ndërsa të tilla kanë mbetur në gjykim për vitin 2020 gjithsej 4 kërkesa.

Në 1 rast është kërkuar nga prokurorët e kësaj prokurorie njohja e vendimit penal të dhënë nga autoriteti gjyqësor shqiptar për një të dënuar dhe nga autoritetet e huaja nuk është disponuar ende në lidhje me këtë kërkesë.

Gjithashtu bashkëpunimi me autoritet e huaja është shfaqur edhe në drejtim të transferimit të procedimeve penale prej tyre dhe të rregjistruara në prokurorinë tonë si dhe shpalljeve në kërkim ndërkombëtar.

5. Garantimi i pavarësisë së prokurorëve:

Përveçse sa më sipër prioritet në punën e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë gjatë vitit 2019 ka qenë dhe garantimi i pavarësisë së prokurorit:

Në lidhje me marrjen e masave për respektimin e standarteve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve, siç theksuam edhe më sipër, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e ushtrojnë funksionin e tyre të ndarë në seksione, sipas grup veprave penale. Në krye të secilit seksion është Drejtuesi i Seksionit, i cili ndihmon Drejtuesin në detyrën e tij, në lidhje me respektimin e këtyre standarteve.

Prokurorët, gëzojnë pavarësinë në çështjet penale konkrete, por në respektim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dispozitave proceduriale penale, mbi bazë të ankesave të qytetarëve apo kompleksiteteve që paraqesin çështjet, nga Drejtuesi i Prokurorisë janë ndërmarrë hapa për nxjerrjen e udhëzimeve jo të

detyrueshme për çështjet penale si dhe krijimit të grupeve hetimore. Është respektuar vendimmarrja e prokurorit, duke u përpjekur pavarësisht volumit të madh të punës, që të jepen udhëzime cituara më lart, para kësaj vendimmarrje.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka qenë e hapur ndaj çdo kërkesë të publikut, që lidhet me etikën dhe anën profesionale të prokurorëve, duke i dhënë përgjigje dhe ndërmarrë masat e duhura.

Prokurorët janë zëvendësuar vetëm në respektim të kritereve dhe kushteve që përcakton ligji procedural penal.

Vlen për tu theksuar se pavarësia e prokurorit në ushtrimin e funksioneve proceduriale në kryerjen e hetimeve, përfaqësimin e akuzës dhe/ose çështjes në gjyq dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, duhet të lidhet ngushtë me detyrueshmërinë e ndjekjes penale dhe zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e prokurorisë.

Gjithashtu duhet të përcaktohen qartë raportet apo marrëdhëniet administrative dhe funksionale ose proceduriale penale ndërmjet prokurorit me drejtuesin e prokurorisë, zëvendës drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesit e seksioneve.

Gjithashtu duhet të normohet saktë dhe mënyra e informimit, duke u bërë e mundur garantimi i mbrojtjes së të dhënave personale, ndalimin e publikimit të akteve dhe ruajtjes së sekretit të hetimeve.

Nga prokurorët duhet të kuptohet qartë se oavarësia e prokurorit është pavarësia dhe autonomia e tij për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të çështjeve dhe/ose akuzave penale dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve penale, pamvarsisht ndikimit të paligjshëm të drejtëpërdrejtë ose të të tërthortë, të brendshëm apo të jashtëm nga cdo autoritet publik, privat, ose palë e interesuar në procesin e ndjekjes penale.

Prokurorët duhet të kuptojnë qartë se detyrueshmëria e ndjekjes penale është një detyrim kushtetues dhe ligjor i tyre.

Veprimtarinë e tyre prokurorët detyrimisht duhet ta ushtrojnë duke ju nënshtruar Kushtetutës, akteve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe legjislacionit të brendshëm në fuqi, duke respektuar parimet e një procedimi të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, si dhe duke mbrojtur liritë, të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, si dhe interesin e shtetit dhe atë publik në procesin penal.

Në lidhje me përdorimin e sistemit elektronik CAMS, është përdorur vazhdimisht për shpërndarjen e çështjeve me short elektronik, ndërkohë që vazhdon të zbatohet udhëzimi nr. 32 prot datë 30.04.2018 i Drejtuesit të Prokurorisë “*Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik*”, në mënyrë që të zgjidhen problematikat në mënyrën e shpërndarjes së çështjeve, kalimin e materialeve nga një seksion në tjetrin, refuzimin e çështjeve nga prokurorët, duke pasur parasysh zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.

6.Zbatimi i urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithsme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe roli i Drejtuesit të Prokurorisë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në respektim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dispozitave procedurale penale, i është treguar kujdes i vecantë edhe përsa i përket njohjes dhe zbatimit të së Urdhërave dhe Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.5 dt.30.07.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për marrëdhëniet me publikun në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”,nga Drejtuesi i Prokurorisë janë marrë të gjitha masat e nevojshme duke u urdhëruar caktimi i një personi prokurori për marrëdhëniet me publikun,në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Në zbatim të urdhërit nr.140 dt.03.09.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e të dhënave personale në shkëmbimin e informacionit me EUROJUST”,nga Drejtuesi i Prokurorisë janë marrë të gjitha masat për njohjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje nga prokurorët,oficerët e policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë.

Në zbatim të Udhëzimit të përgjithshëm nr.9 dt.10.12.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi masat administrative dhe procedurale në Prokuroritë Për Krime të Rënda dhe Prokuroritë e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm me fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme”,nga prokurorët e kësaj prokurorie në përgjithësi,si dhe ata të Seksionit të Posaçëm në veçanti janë marrë masat përkatëse për evidentimin dhe procedimeve penale që do të kalonin për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme dhe dërgimin e një pjese të konsiderueshme të tyre për kompetencë pranë Prokurorisë së Posaçme.Një pjesë e këtyre procedimeve kanë mbetur për tu dërguar për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2020.

Gjithashtu në zbatim të këtij udhëzimi janë marrë masat përkatëse për marrjen në dorëzim të çështjeve penale dhe çështjeve të hetimit pasuror të dërguar për kompetencë lëndore nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë,pas dt.19.12.2019.

Çështjet penale të ardhura për moskompetencë lëndore janë regjistruar menjëherë në regjistrin e procedimeve penale dhe është bërë shpërndarja e tyre me short ose me caktim prokurorëve të kësaj prokurorie,për të vazhduar hetimet paraprake.

Në lidhje me materialet e hetimit pasuror të ardhura për kompetencë,për shkak të numrit të madh të tyre,ndarja sipas prokurorëve që do të vazhdojnë procedurat e mëtejshme është mbartur për tu kryer gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2019 nëpërmjet urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme nga Drejtuesi i Prokurorisë, duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dt.20.06.2019 dhe VKM nr. 296 datë 10.05.2019 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e

Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2019” të Këshillit të Ministrave,në vazhdimësi janë bërë përpjekje që nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të bëhej e mundur njohja dhe zbatimi me rigorozitet të rekomandimeve prioritare në punën e prokurorisë në luftën kundër korrupsionit,krimit të organizuar,mbrojtjen e të drejtave të njeriut,si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Duke pasur parasysh Udhëzimet e mëparshme të Prokurorit të Përgjithshëm, për organizimin, funksionimin dhe mbarëvajtjen e punëve në prokurori, nga Drejtuesit e kësaj prokurorie, janë ndërmarrë një sërë aktesh për zbatimin e tyre, pasqyruar si vijon:

- Me Urdhërin nr. 2 datë 07.01.2019 *“Për administrimin e provave materiale”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për administrimin e provave materiale të dorëzuara në arshivën e prokurorisë nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurorër,duke caktuar dhe një punonjës të administratës që të administronte ambjentet e ruajtjes së provave;
- Me Urdhërin nr. 3 datë 07.01.2019 *“Për mbajtjen e të dhënave për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për administrimin e trajtimin e materialeve që kanë të bëjnë me letërporositë që vijnë nga jashtë shtetit,ekstradimet,njohjet e vendimeve penale dhe letërporosive për jashtë shtetit,duke ngarkuar dhe punonjësit apo prokurorët përkatës për zbatimin e këtij urdhëri;
- Me Udhëzimin nr. 4 datë 07.01.2019 *“Për pasqyrimin në kohë në regjistrat përkatës të të dhënave të kërkuara nga ligji”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar prokurorët për mënyrën e pasqyrimin të të dhënave në regjistrat përkatës në rastin e përdorimit të mjeteve të kërkimit të provave sic janë përgjimet,veprimet simuluese etj;
- Me Urdhërin nr. 5 datë 08.01.2019 *“Për procedurën e administrimit të vendimeve gjyqësore”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për administrimin e vendimeve gjyqësore;
- Me Urdhërin nr. 6 datë 22.01.2019 *“Për mbarëvajtjen e punës në prokurori në lidhje me administrimin e hyrje-daljeve në ambjentet e institucionit”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave të hyrjes dhe daljes në ambjentet e institucionit;
- Me Udhëzimin nr. 7 datë 30.01.2019 *“Për pajisjen me certifikatë siguri”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për marrjen e masave për pajisjen me certifikatë sigurie,me qëllim disiplinimi i procedurave dhe standarteve që garantojnë sigurimin e informacionit të klasifikuar „Sekret shtetëror“;
- Me Urdhërin nr. 10 datë 01.02.2019 *“Për krijimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar krijimin e komisionit disiplinor në lidhje me funksionimin e punës së oficerëve të policisë gjyqësore;
- Me Udhëzimin nr. 23 datë 27.03.2019 *“Për masat ndaj dhunës në familje”*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar marrjen e masave përkatëse në lidhje me dënimet,si dhe në lidhje me caktimin e masave të sigurimit poër personat autorë të veprave penale të dhunës në familje;
- Me Udhëzimin nr.24 datë 05.04.2019 *“Për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.6 dt.20.11.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm „Për hetimin pasuror,sekuestrumin dhe konfiskimin*

e produkteve të veprës penale`, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka udhëzuar prokurorët për fillimin e procedurave të hetimit pasuror dhe dërgimin e akteve të hetimit pasuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkalëls së Parë Për Krime të Rënda Tiranë,si dhe mbajtjen e regjistrit të hetimit pasuror;

- Me Udhëzimin nr. 25 datë 10.04.2019 *``Mbi verifikimin e ecurisë së çështjeve``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar drejtuesit e seksioneve për verifikimin e çështjeve dhe regjistrimeve të të dhënave të detyrueshme në regjistrat përkatës;

- Me Urdhërin nr. 30 datë 17.05.2019 *``Për pasqyrimin e të dhënave të regjistrave të njoftimit të veprës penale në regjistrat elektronikë``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për regjistrimet e materialeve hetimore të ardhura në prokurori dhe hedhjen e të dhënave në regjistrat përkatës elektronikë;;

- Me Urdhërin nr. 38 datë 17.06.2019 *``Për pasqyrimin e të dhënave statistikore për veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore dhe për veprat penale me të dëmtuar ose autorë të mitur``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për pasqyrimin e të dhënave statistikore për veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore dhe për veprat penale me të dëmtuar ose autorë të mitur;

- Me Urdhërin nr. 43 datë 28.06.2019 *``Për njohjen e materialit të arkivuar``* dhe nr.44 dt.28.06.2019 *`` Për sistemimin e materialit të arkivuar``*, si dhe nr.70 dt.02.12.2019 *``Për sistemimin e materialeve të arkivuara``* Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar rregullimin e procedurave për njohjen me materialet e arkivuara ,si dhe sistemimin e materialeve të arkivuara në arshivën e këtij institucioni;

- Me Urdhërin nr. 63 datë 30.10.2019 *``Për caktimin e pikës së kontaktit me Prokurorinë e Përgjithshme,mbajtjen e të dhënave statistikore dhe raportimet e tyre në lidhje me çështjet penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimin e terrorizmit``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar caktimin e pikës së kontaktit me Prokurorinë e Përgjithshme,për mbajtjen e të dhënave statistikore dhe raportimet e tyre në lidhje me çështjet penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimin e terrorizmit;

- Me Urdhërin nr. 73 datë 04.12.2019 *``Për organizimin e punës së punonjësve të administratës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ``*, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar një riorganizim të detyrave në lidhje me sekretarinë dhe punonjësit e administratës;

Gjithashtu nga Drejtuesi i Prokurorisë,në vazhdimësi gjatë vitit 2019 janë nxjerrë urdhra të ndryshëm për mirëfunksionimin e punës së administratës, riorganizimet e seksioneve në prokurori , verifikimin e ecurisë së çështjeve, përballimin e gadishmërisë së përgjithshme dhe gadishmërisë në situata të vecanta gjatë vitit 2019,si dhe në varësi të ngarkesës së prokurorëve dhe përjashtimin e tyre nga shorti elektronik .

Gjithashtu nga Drejtuesi i Prokurorisë në respektim të ligjit nr.97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”* dhe ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, me qëllim dhënies zgjidhje sa më ligjore dhe në kohë të arësyeshme të çështjeve konkrete janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për prokurorët e çështjeve.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

1.HETIMET PARAPRAKE.

1/1. Volumi i punës në hetim (mosfillime procedimi penal,procedimet e mbartura, procedimet e reja të rregjistruar (edhe të K.P.Ushtarak), procedimet e rifilluara dhe ato të ardhura me moskompetencë):

Përgjatë vitit 2019, nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkalëls së Parë Elbasan është vendosur mosfillimi i procedimit ,si dhe është ushtruar ndjekja penale në lidhje me proçedime penale penale të mbartura nga viti 2018,proçedime penale të regjistruara të reja,si dhe proçedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2019,si dhe ato të ardhura me moskompetencë si më poshtë vijon:

- Është punuar për vlerësim për **718** materiale hetimore për të cilat më pas është vendosur mosfillimi,kanë kaluar aktet prokurorive të tjera për kompetencë ose janë mbartur për verifikim për vitin 2020;

- Janë hetuar në total **3792** proçedime penale penale të mbartura nga viti 2018,proçedime penale të regjistruara të reja(ku përfshihen dhe çështjet e ndara), proçedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2019,si dhe ato të ardhura me moskompetencë prej të cilave:

- Janë hetuar **2599** procedime penale të regjistruar të reja,ku 1 procedim penal është regjistruar për vepër penale të parashikuar nga K.P.Ushtarak,si dhe gjithashtu janë përfshirë dhe çështjet e ndara gjatë vitit 2019;
- Janë hetuar **1161** procedime penale të mbartura nga viti 2018;
- Janë hetuar **20** procedime penale të rifilluara gjatë vitit 2019;
- Janë hetuar **12** procedime penale të ardhura me moskompetencë;


Ndërkohë të dhënat e vitit 2018 tregojnë se:

- Është punuar për vlerësim për **894** materiale hetimore për të cilat më pas është vendosur mosfillimi,kanë kaluar aktet prokurorive të tjera për kompetencë ose janë mbartur për verifikim për vitin 2019;


- Janë hetuar në total **3192** proçedime penale penale të mbartura nga viti 2018,proçedime penale të regjistruara të reja, proçedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2019,si dhe ato të ardhura me moskompetencë prej të cilave:

- Janë hetuar **2372** procedime penale të regjistruar të reja,ku 1 procedim penal ishte regjistruar për vepër penale të parashikuar nga K.P.Ushtarak.
- Janë hetuar **797** procedime penale të mbartura nga viti 2017;
- Janë hetuar **17** procedime penale të rifilluara gjatë vitit 2019;
- Janë hetuar **6** procedime penale të ardhura me moskompetencë;

Volumi i materiale-hetim viti 2019




Volumi i materiale-hetim viti 2018



Sa më sipër rezulton se volumi çështjeve mosfillim-hetim për vitin **2019** është **4510** çështje,ndërsa për vitin **2018** ka qenë **4086** çështje.

Gjatë vitit **2019** janë trajtuar **424** çështje (mosfillim-hetim) më shumë se në vitin **2018**,ose **4 %** më shumë.

Volumi i ceshtjeve materiale-hetim viti 2019 e 2018 i krahasuar




Përsa i përket numrit të procedimeve të hetuara rezulton se gjatë vitit **2019** janë hetuar **3792** procedime,ndërsa gjatë vitit **2018** janë hetuar **3192** procedime.

Gjatë vitit **2019** janë hetuar **600** procedime penale më shumë se në vitin **2018**,ose afërsisht **8%** më shumë.

Në këtë aspekt, vlerësohet se në zbatim të nenit 291 të K.Pr.Penale ,duke ju lënë prokurorit një afat 15 ditor që të vendosë për fillimin apo mosfillimin e procedimit penal, ka sjellë rritjen e numrit të procedimeve penale të regjistruara për vitin 2019,pasi një afat i tillë nuk mund të bëjë të mundur që prokurori të administrojë në kohë të gjitha aktet dhe informacionet në kuadër të vlerësimit të materialit hetimor.

Volumi i procedimeve viti 2019 e 2018 i krahasuar



Në lidhje më një pjesë të çështjeve penale të hetuara për vitin 2019 ,ato u janë deleguar për veprime hetimore dhe janë hetuar nga oficerë të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe konkretisht 878 procedime penale,nga totali prej 3792 procedimesh penale të hetuara në total në këtë prokurori.


Pra sa më sipër rezulton se 23% e çështjeve të hetuara në këtë prokurori gjatë vitit 2019,janë hetuar nga oficerë të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan,ndërsa 77% e çështjeve është hetuar nga oficerë të tjerë të policive të tjera gjyqësore,ku pjesën më të madhe e zënë shërbimet e policisë gjyqësore në vartësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Gjithashtu është për tu theksuar fakti se në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ,gjatë vitit 2019 janë hetuar edhe 602 procedime penale të rifilluara për arsye parashkrimi të ndjekjes penale,për të cilat është proceduar me vendime pushimi nga prokurorët ose me kërkesa për pushim në gjykatë,numër procedimesh ky i cili nuk është futur në të dhënat e më sipërme dhe ato statistikore.Kjo tregon për një ngarkesë pune të prokurorëve.

Raporti i çështjeve të reja me të mbarturat dhe prurjet e tjera gjatë vitit 2019:

Pra në përqindje rezulton se nga tërësia e materialeve, duke i ndarë në procedime penale dhe materiale kallzuese, rezulton se 84 % përbëjnë procedime dhe 16 % materiale kallzuese (përfshihen mosfillimet, kallzimet që kanë mbetur në verifikim dhe ato të transferuara apo të bashkuara).

Në përqindje raporti i çështjeve, paraqitet si vijon:




Puna e kryer në total gjatë vitit 2019 dhe materiale e procedime penale të mbetura për hetim gjatë për vitin 2020:


- Materiale të mosfilluara gjithsej 601;
- Materiale të mbartura për verifikim për vitin 2020 gjithsej 103;
- Materiale kaluar aktet për moskompetencë gjithsej 14;
- Procedime penale të përfunduara gjithsej 2172 ;
- Procedime penale të mbetura për hetim për vitin 2020 gjithsej 1620.

Kjo prokurori ka përfunduar hetimet për 2787 materiale hetimore e procedime, ndërkohë që i kanë mbetur në hetim 1620 procedime penale dhe 103 materiale kallëzuese në verifikim.

Viti 2018



Viti 2019



Pra konstatohet një rënie e punës, nga ana e kësaj prokurorie, e cila pasqyrohet në një rritje prej **8%** të çështjeve (materiale-hetim) të papërfunduara në krahasim me vitin 2018.

Duhet theksuar se në këtë faktor ka ndikuar respektimi i afatit 10 ditor, sipas nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, i cili detyrimisht bën që të zgjaten hetimet kur i pandehuri kërkon të pyetet apo të merren prova të reja. Të pandehurit, nuk ushtrojnë përgjithësisht të drejtat e tyre, në rol aktiv gjatë hetimit, në mënyrë që prej tyre të kërkohen hetime të ndryshme për marrje provash apo edhe viktima, pavarësisht të drejtave të përcaktuara në nenin 58 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Këto të drejta, konstatohen se i ushtrojnë vetëm pasi njihen me aktin e njoftimit të përfundimit të hetimeve. Kjo gjë shkakton detyrimisht zgjatjen e afatit të hetimit. Për këtë arsye kërkohet një ndërgjegjësim më i madh, qoftë i të pandehurit ashtu edhe viktimave të veprave penale.

Në lidhje me materialet hetimore të mbetura për vlerësim për në vitin 2020 rezulton se ato janë regjistruar në dyjavëshin e fundit të muajit dhjetor 2019 dhe kanë qenë brenda afatit 15 ditor për tu vlerësuar nga prokurët dhe për të vendosur nëse në lidhje me to do të vendoset mosfillimi apo regjistrimi i procedimit penal.

Një fakt tjetër që vlen të vlerësohet është se në këtë prokurori, ka patur një mungesë tashmë prej 3 prokurorësh që hetonin dhe përfaqësonin veprat penale në gjykim si dhe një mungesë oficerësh të seksionit të policisë gjyqësore, në krahasim me Prokuroritë e tjera të shkallës së parë.


Gjithashtu, vlerësohet se një faktor tjetër i uljes së efektivitetit në punë, ka të bëjë me dispozitat e reja proceduriale penale, pasi tashmë prokurorit i duhet të përballet me gjyqtarin e seancës paraprake përpara vendosjes përfundimisht të dërgimit të çështjes për gjykim apo pushim dhe në këtë pjesë, duhet të përlllogaritur edhe koha e gjykatës për vendimmarrje, e cila mund të jetë edhe kthimi i akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve.

Pikërisht këta faktorë, megjithëse janë ndër faktorët që kanë sjellë rënien e efektivitetit në hetim, duhet të shërbejnë si një nxitës i mëtejshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për të treguar se mund të përballojnë punën pavarësisht ndryshimeve.

Raporti i përfundimit të çështjeve dhe atyre të mbetura në hetim:

Rezulton të jenë përfunduar 615 materiale kallzuese (601 vendime mosfillimi dhe 14 materiale kallzuese përcjellë për kompetencë), 2172 proçedime penale (bashkë me transferimet për kompetencë dhe bashkimet e çështjeve). Kanë ngelur në hetim 1620 proçedime penale dhe 103 materiale kallzuese në verifikim.

Pra në përqindje rezulton se nga tërësia e materialeve të përfunduara, 48% janë proçedime penale, 14 % materiale kallzuese me vendim mosfillimi dhe kanë ngelur në hetim 36 % proçedime penale e për verifikim 2% materiale kallzuese.



1/2. REFERIMET DHE MOSFILLIMET:

1/2/1.REFERIMET:

Gjatë vitit 2019 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore, janë regjistruar kryesisht, janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të institucioneve të tjera publike, si dhe janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të shtetasve apo subjekteve fizike apo juridike gjithsej 3297 materiale hetimore.

Në lidhje me këto materiale hetimore në 601 raste është vendosur mosfillimi I procedimit penal, në 2579 raste janë regjistruar procedime të reja penale, në 14 raste kanë kaluar aktet e para hetimore për kompetencë në Prokurori të tjera, si dhe 103 materiale hetimore kanë mbetur për verifikim për vitin 2020.

Nga statistikat e prokurorisë për vitin 2019 konstatohet se:

- **3068** materiale hetimore janë referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit, ose rreth **93 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **14** materiale hetimore janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, drejtori të tjera policie apo në Ministrinë e Brendshme, ose rreth **0,42 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **58** materiale hetimore janë referuar nga shërbimi I policisë gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, ose rreth **1,76 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **3** materiale janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit tatimor (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), ose rreth **0,09 %** e materialeve hetimore të regjistruara;

- **2** materiale hetimore janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit doganor(Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) ,ose rreth **0,06 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **1** kallëzim penal ka ardhur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose rreth **0,03 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **17** kallëzime penale kanë ardhur nga Inspektoriati I Mbrojtjes së Territorit Bashkia Elbasan,ose rreth **0,50 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **4** kallëzime penale kanë ardhur nga Inspektoriati Shtetëror I Pyjeve,Ujrave dhe Turizmit Dega Elbasan ose rreth **0,12 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **1** kallëzim penal ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit Tiranë ose rreth **0,03 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **17** materiale e cështje kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e tjera apo Prokuroria e Përgjithshme ose **0,50 %** të materialeve hetimore të regjistruara;
- **65** kallëzime penale janë regjistruar në prokurori të bëra nga shtetasit ose rreth **1,97 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **45** materiale hetimore janë referuar nga oficerët e Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ose rreth **1,4 %** e materialeve hetimore të regjistruara;
- **4** materiale hetimore janë regjistruar kryesisht nga prokurorët e kësaj prokurorie, ose rreth **0,12%** e materialeve hetimore të regjistruara.

Në lidhje me referimet e bëra nga shërbimet e policisë gjyqësore rezulton se gjatë vitit 19 janë regjistruar 1008 ngjarje kriminale,ndërsa pjesa tjetër janë kallëzime shtetasish.

Përveç referimeve nga policia e shtetit, numri i referime të tjera vijon të jetë i ulët, edhe pse konstatohet një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me materialet hetimore të regjistruara kryesisht rezulton se :

- 1 material hetimor është regjistruar kryesisht për veprën penale të “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i K.Penal;
- 2 materiale hetimore janë regjistruar kryesisht për veprën penale të “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuar nga neni 295/a të K.Penal;
- 1 material hetimor është regjistruar kryesisht për veprën penale të “Zhdukja ose humbja e fashikullit” të parashikuar nga neni 313/a i K.Penal.

Në lidhje me materialet hetimore të referuara gjatë vitit 2019 rezulton se:

- Për krime kundër jetës (N.76-84/a KP) janë regjistruar 78 materiale hetimore (N.78-2, N.79 -3, N.79/c-1,N.84-72);
- Për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit (N.86-90) janë regjistruar 195 materiale hetimore (N.88-4,N.89-148,N.90-43);
- Për veprën penale “Shkaktim i vetëvrasjes” (N.99 K.P)) janë regjistruar 72 materiale hetimore ;
- Për krime seksuale (N.100-108/a) janë regjistruar 22 materiale hetimore;

- Për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit (N.113-123) janë regjistruar 33 materiale hetimore;
- Për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes (N.114-130/a) janë regjistruar 139 materiale hetimore, ku 116 prej tyre janë regjistruar për veprën penale të “Dhuna në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal;
- Për vepra penale në lidhje me vjedhjet e pasurisë (N.134-142) janë regjistruar 737 materiale hetimore, ku pjesa më e madhe e tyre janë regjistruar 624 për N.134, 78 për N.137, 10 për N.139 e 17 për N.141/a;
- Për vepra penale në lidhje me mashtrimet (N.143-149/b) janë regjistruar 48 materiale hetimore ku pjesa më e madhe e tyre 40 janë regjistruar për N.143;
- Për vepra penale në lidhje me shkatërrimet e pronës (N.150-162) janë regjistruar 216 materiale hetimore, ku pjesa më e madhe janë regjistruar 90 për N.150, 97 për N.151 e 21 për N.161;
- Për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet (N.180-182) janë regjistruar 37 materiale hetimore;
- Për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” (N.199/a) janë regjistruar 272 materiale hetimore;
- Për vepra penale kundër mjedisit (N.201-207) janë regjistruar 35 materiale hetimore;
- Për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit (N.235-247) janë regjistruar 75 materiale hetimore.
- Për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit ose në shërbim publik (N.248-260) janë regjistruar 126 materiale hetimore, ku pjesa më e madhe e tyre janë regjistruar 110 për N.248 e 10 për N.259.
- Për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike (N.261-293/d) janë regjistruar 806 materiale hetimore, ku pjesën më të madhe e zënë 314 për N.291, 195 për N.290, 100 për vepra penale në lidhje me narkotikët (N.283-284), 43 për N.277, 40 për N.275, 30 për N.278 e 18 për N.287.
- Për vepra penale kundër drejtësisë (N.235-247) janë regjistruar 101 materiale hetimore ku pjesën më të madhe e zënë 55 materiale të regjistruara për N.324/a të K.Penal.
- Për vepra penale të tjera penale janë regjistruar 428 materiale hetimore.

Sic shihet dhe më lart ,gjatë vitit 2019, rezulton se në lidhje me materialet të referuara për fakte të dyshuara si vepra penale më së shumti ato janë referuar për:


- “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal-624 materiale;
- “Drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal-314 materiale;
- “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K.Penal-272 materiale;
- “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290 i K.Penal-195 materiale;
- “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i K.Penal-116 materiale;
- “Shpërdorim detyrë” parashikuar nga neni 248 i K.Penal-110 materiale;
- Vepra penale në fushën e narkotikëve parashikuar nga nenet 283-284 të K.Penal-100 materiale.

1/2/2.MOSFILLIMET:

Gjatë vitit 2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal 601 materiale hetimore,ku pjesa më e madhe e mosfillimeve është bërë për arsye se faktet nuk parashikohen nga ligji si vepra penale,ose për vepra penale të cilat ndiqen mbi bazën e ankimit të viktimës së dëmtuar nga vepra penale.

- 140 mosfillime janë vendosur për vepra penale të papërcaktuara;
- 97 mosfillime janë vendosur për veprat penale “Shkatërrim i pronës”, “Shkatërrim i pronës me zjarri” dhe “Shkatërrim i pronës nga pakujdesia” të parashikuara nga nenet 150,151 e 161 të K.Penal;
- 89 mosfillime janë vendosur për veprën penale të “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” i parashikuar nga neni 290 i K.Penal;
- 83 mosfillime janë vendosur në lidhje me veprat penale të “Plagosje e lehtë me dashje” dhe “Demtime të tjera me dashje,të parashikuar nga nenet 89 e 90 të K.Penal;
- 57 mosfillime janë vendosur në lidhje me veprën penale të “Kanosja” e parashikuar nga neni 84 i K.Penal;
- 36 mosfillime janë vendosur në lidhje me veprën penale të “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal;
- 30 mosfillime janë vendosur në lidhje me veprën penale të “Shkaktim i vetëvrasjes” e parashikuar nga neni 99 i K.Penal;
- 18 mosfillime janë vendosur për veprën penale të “Përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike” i parashikuar nga neni 275 i K.Penal;
- 14 mosfillime janë vendosur për veprën penale të “Vetëgjyqësisë” i parashikuar nga neni 277 i K.Penal;
- 11 mosfillime janë vendosur në lidhje me veprën penale të “Dhunë në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal;
- 11 mosfillime janë vendosur në lidhje me veprën penale të “Mashttrim” e parashikuar nga neni 143 i K.Penal;
- 10 mosfillime janë vendosur për vepra penale në fushën e taksave dhe tatimeve (N.180,180/a/1 e 181/a të K.Penal);
- 9 mosfillime janë vendosur për veprën penale të “Ndërtim i paligjshëm” i parashikuar nga neni 199/a i K.Penal;
- 9 mosfillime janë vendosur për veprën penale të “Shpërdorim i detyrës” i parashikuar nga neni 199/a i K.Penal;
- 7 mosfillime janë vendosur për veprën penale të “Fallsifikimit të dokumentave” të parashikuar nga neni 186 i K.Penal;
- 7 mosfillime janë vendosur për veprat penale kundër mjedisit të parashikuara nga nenet 201,205,206/a e 206/b të K.Penal;
- 27 mosfillime janë vendosur për vepra të tjera penale .


Gjatë vitit 2019 nga 3 ankimime që u janë bërë vendimeve të mosfillimit të prokurorëve,nga gjykata janë lënë në fuqi 2 vendime mosfillimi dhe është shfuqizuar vetëm 1 vendim mosfillimi.



1/3. PROCEDIMET E HETUARA

1/3/1.TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR ÇËSHTJET E HETUARA


Gjatë vitit 2019 rezulton se nga 3792 procedime të hetuara ka përfunduar hetimi për 2172 procedime penale si dhe 1620 procedime kanë mbetur në hetim për vitin 2020.



Theksojmë se gjithashtu kanë përfunduar e 602 procedime penale të cilat janë rifilluar për arësye parashkrimi, ku prej tyre në gjykatë janë dërguar edhe 597 kërkesa për pushim të çështjeve të rifilluara për arësye parashkrimi të ndjekjes penale, si dhe është vendosur nga prokurori për 5 procedime të rifilluara pushimi i çështjes për arësye të parashkrimit të ndjekjes penale.



Numri i këtyre çështjeve nuk është futur në numrin total të çështjeve të përfunduara, duke qenë se në të dhënat statistike të vitit 2019 këto të dhëna nuk janë raportuar.

Për vitin 2018, kanë përfunduar hetimet për 2066 çështje dhe kishin mbetur në hetim për vitin 2019 gjithsej 1161 çështje.



Krahasuar me vitin 2018, gjatë vitit 2019 kanë përfunduar 106 procedime më shumë, ndërkohë që kanë mbetur në hetim për vitin pasardhës 459 procedime penale më shumë .

Të dhëna për çështjet e përfunduara dhe të mbetura në hetim për vitet 2019 e 2018 i krahasur



1/3/2.TË DHËNA PËR MËNYRËN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDIMEVE PENALE GJATË VITIT 2019:

a) BASHKIMET:

Gjatë vitit 2019 janë bashkuar me procedime penale të tjera në hetim gjithsej 43 procedime penale.


b) PUSHIMET:

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur pushimi i çështje ose është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes në total për 538 procedime penale me 174 persona, prej të cilëve 5 të arrestuar.

b/1) Procedimet penale të pushuara:

Gjatë vitit 2019 janë pushuar me vendime të prokurorit 90 procedime penale:

- 10 procedime janë pushuar për veprën penale “Kanosje” e parashikaur nga neni 84 i K.Penal;
- 49 procedime janë pushuar për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” e parashikaur nga neni 89 i K.Penal;
- 15 procedime janë pushuar për veprën penale “Përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike” e parashikaur nga neni 275 i K.Penal;
- 16 procedime janë pushuar për kundravajtje të tjera penale .
-



Siç shihet nga të dhënat statistikore rezulton se pjesa më e madhe e çështjeve të pushuara janë çështje të cilat janë ndjekur mbi bazën e ankimit dhe shumica e tyre është pushuar për shkak të heqjes dorë nga ankimi.


b/2) Kërkesat për pushimin e çështjes penale:

Gjatë vitit 2019 ,në lidhje me procedimet penale të përfunduara, 448 procedime janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes:

- Për 58 procedime me 22 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290 i K.Penal;
- Për 56 procedime me 57 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Ndërtim i paligjshëm” e parashikuar nga neni 199/a i K.Penal;
- Për 38 procedime me 2 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Shpërdorim detyre” e parashikuar nga neni 248 i K.Penal;
- Për 34 procedime me 13 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal;
- Për 33 procedime pa persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale të shkatërrimit të pronës,të parashikuara nga nenet 150,151 e 161 të K.Penal;
- Për 32 procedime pa persona nën hetim/pandehur është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Shkaktim i vetëvrasjes” e parashikuar nga neni 99 i K.Penal;
- Për 21 procedime me 20 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” e parashikuar nga neni 283 i K.Penal;
- Për 20 procedime me 8 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Dhuna në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal;
- Për 14 procedime me 12 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” e parashikuar nga neni 291 i K.Penal;
- Për 12 procedime me 1 person nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale kundër mjedisit,të parashikuara nga nenet 201,203,205,206 e 206/b të K.Penal;
- Për 10 procedime me 1 person nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale të fallsifikimit të dokumentave,të parashikuar nga nenet 186,189 e 191 të K.Penal;
- Për 10 procedime me 11 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale kundër drejtësisë të parashikuara nga nenet 300,302,305,309/1,320,321 e 324/a të K.Penal;
- Për 9 procedime me 10 persona nën hetim,prej të cilëve 1 i arrestuar është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale kundër autoritetit të shtetit të kryer nga shtetasit,të parashikuara nga nenet 236,237,238 i K.Penal;
- Për 7 procedime me 2 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” e parashikuar nga neni 180 i K.Penal;
- Për 7 procedime me 6 persona nën hetim,ku 1 ishte i arrestuar është kërkuar në gjykatë pushimi për vepra penale për krime seksuale nga nenet 100,102,106 e 108 të K.Penal;
- Për 6 procedime me 1 person nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Mashttrim” e parashikuar nga neni 143 i K.Penal;
- Për 6 procedime me 4 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve,armëve shpërthyesë dhe i municionit” e parashikuar nga neni 278 i K.Penal;

- Për 5 procedime me 8 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprën penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” e parashikuar nga neni 259 i K.Penal;
- Për 3 procedime,pa persona nën hetim/pandehur është kërkuar në gjykatë pushimi për veprën penale “Vrasje” e parashikuar nga neni 76 i K.Penal;
- Për 2 procedime me 1 person nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për veprën penale “Vjedhje me dhunë” e parashikuar nga neni 139 i K.Penal;
- Për 59 procedime me 5 persona nën hetim është kërkuar në gjykatë pushimi për vepra të tjera penale .


Të dhëna për kërkesat për pushim



Vendim marrja e gjykatës në lidhje me kërkesat për pushimin e çështjeve:

Në lidhje me kërkesat për pushim të bëra nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë vitit 2019,rezulton se nga gjykata janë pranuar 421 kërkesa, janë kthyer aktet për hetim për 10 procedime,si dhe kanë mbetur në gjykim në seancë paraprake për vitin 2020 ,gjithsej 107 kërkesa pushimi .

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për pushim



Siç është theksuar edhe më lart, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, gjatë vitit 2019 janë hetuar edhe 602 procedime penale të rifilluara për arësye parashkrimi të ndjekjes penale, për të cilat është proceduar me vendime pushimi nga prokurorët ose me kërkesa për pushim në gjykatë, numër procedimesh ky i cili nuk është futur në të dhënat e më sipërme dhe ato statistikore.

Nga këto procedime për 5 procedime penale nga prokurorët është vendosur pushimi për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjithashtu për 597 procedime penale të rifilluara është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes penale, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, si dhe nga gjykata është pranuar kërkesa për 306 procedime, është kthyer për hetim 1 procedim penal, si dhe vazhdon gjykimi në seancë paraprake për 290 kërkesa.

Të dhëna për personat nën hetim të arrestuar për të cilët është kërkuar pushimi i çështjes:

Gjatë vitit 2019 është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes për 174 persona, prej të cilëve 5 kanë qenë të arrestuar.

- Është kërkuar pushim në bazë të nenit 328/c e 329/a të K.Pr.Penale, për procedimin penal nr.1024 të vitit 2019 në ngarkim të të arrestuarit A.S për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, të parashikuar nga neni 106 I K.Penal, për shkak të tërheqjes së ankimit, si dhe është kërkuar shuarja e masës së sigurimit arrest në burg. Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit.

- Është kërkuar pushimi në bazë të nenit 328/ç K.Pr.Penale, për procedimin penal nr.1311 të vitit 2019 në ngarkim të shtetasit A.K për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a I K.Penal, si dhe caktim mase mjekësore. Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit.

- Është kërkuar pushimi në bazë të nenit 328/ç K.Pr.Penale, për procedimin penal nr.1396 të vitit 2019 në ngarkim të shtetasit E.D për veprën penale “Kundërshtim I punonjësit të policisë” të parashikuar nga neni 236 I K.Penal, si dhe caktim mase mjekësore. Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit.

- Është kërkuar pushimi në bazë të nenit 328/ç K.Pr.Penale, për procedimin penal nr.1592 të vitit 2019 në ngarkim të shtetasit P.B për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a I K.Penal, si dhe caktim mase mjekësore. Nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit.


- Është kërkuar pushimi në bazë të nenit 328/ç K.Pr.Penale, për procedimin penal nr.1716 të vitit 2019 në ngarkim të shtetasit G.GJ për veprën penale “Drejtim I mjetit në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 I K.Penal, si dhe caktim mase mjekësore. Nga gjykata nuk ka përfunduar gjykimi në seancë paraprake dhe çështja është mbartur për vitin 2020.

Shkaqet e pushimit të çështjeve (pushim+kërkesa për pushim):

Duke ju referuar të dhënave statistikore të vitit 2019 rezulton se pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 4 procedime penale pa persona nën hetim, më mungesë fakti;

Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 3 procedime penale me 10 persona nën hetim, për mungesë provash.

Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 531 procedime penale me 164 persona nën hetim për shkaqe të tjera.




c) **PEZULLIMET.**

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie janë pezulluar hetimet për 667 procedime penale, për arsye të moszbulimit të autorëve të veprës penale.

- Janë pezulluar hetimet për 2 procedime penale të regjistruara për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Vrasje me paramendim” të parashikuara nga nenet 76 e 78 të K.Penal.
- Janë pezulluar hetimet për 470 procedime penale të regjistruara për veprën penale “Vjedhje” të parashikuara nga neni 134 i K.Penal.
- Janë pezulluar hetimet për 61 procedime penale të regjistruara për veprat penale “Shkatërrim i pronës” dhe “Shkatërrim i pronës me zjarr” të parashikuara nga nenet 150 e 151 të K.Penal.
- Janë pezulluar hetimet për 38 procedime penale të regjistruara për veprat penale “Prodhim e shitje e narkotikeve” dhe “Kultivim i bimëve narkotike” të parashikuara nga nenet 283 e 284 të K.Penal.

Të dhëna për çështjet e pezulluara




Sic shihet nga të dhënat statistoke për veprën penale të “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal zbulueshmëria e autorëve të veprës penale lë shumë për të dëshiruar, duke patur parasysh edhe faktin se kjo është dhe vepra penale më e përhapur në Qarkun e Elbasanit. Vendim marrja e prokurorit për pezullimin e çështjes është ankimuar në 3 raste dhe gjykata janë lënë në fuqi vendimet e prokurorit.

c) MOSKOMPETENCAT:

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie është shpallur moskompetenca tokësore apo ajo lëndore për 49 procedime me 13 persona nën hetim, prej të cilëve 1 i arrestuar.

- Për 2 procedime të regjistruara për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal është shpallur moskompetenca tokësore;
- Për 9 procedime të regjistruara për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i K.Penal është shpallur moskompetenca tokësore;
- Për 1 procedim të regjistruar për veprën penale të “Shkelja e barazisë në tendera...”, të parashikuar nga neni 258 i K.Penal është shpallur moskompetenca lëndore, duke ju dërguar aktet Prokurorisë së Posaçme SPAK;
- Për 4 procedime me 5 persona nën hetim e 1 të arrestuar, të regjistruar për veprën penale të “Korrupsioni pasiv i personave..”, të parashikuar nga neni 259 i K.Penal është shpallur moskompetenca lëndore, duke ju dërguar aktet Prokurorisë së Posaçme SPAK;
- Për 2 procedime me 5 persona nën hetim të regjistruar për veprën penale të “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm...”, të parashikuar nga neni 245/1 i K.Penal është shpallur moskompetenca lëndore, duke ju dërguar aktet Prokurorisë së Posaçme SPAK;
- Për 7 procedime me 1 person nën hetim, të regjistruar për veprën penale të “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i K.Penal është shpallur moskompetenca tokësore;
- Për vepra të tjera penale janë shpallur moskompetencat lëndore dhe ato tokësore për 24 procedime me 2 persona nën hetim.

Të dhëna për moskompetencat




d) URDHËRA PENAL

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie janë dërguar gjithsej 25 kërkesa miratim urdhëri penal për 25 të pandehur,si dhe nga gjykata janë miratuar 24 urdhëra penalë,është refuzuar 1 urdhër penal dhe është pushuar çështja.

Në rastin kur është refuzuar urdhëri penal i prokurorit për të pandehurin B.F të akuzuar për veprën penale të “Plagosjes së lehtë” të parashikuar nga neni 89 i K.Penal,pushimi i gjykimit është bërë për shkak të tërheqjes së ankimit nga viktima.

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për miratim urdhërash penalë




dh) MARRËVESHJE PRANIM FAJËSIE

Nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është arritur dhe është kërkuar miratimi i marrëveshjes së fajësisë për 83 me 83 të pandehur,prej të cilëve asnjë i arrestuar,si dhe nga gjykata janë pranuar 82 marrëveshje fajësie dhe është refuzuar 1 marrëveshje fajësie.

- Nga gjykata është refuzuar marrëveshja e pranimit të fajësisë për të pandehurin R.GJ i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim i mjeteve në mënyrë të parregullt” e parashikuar nga neni 291 i K.Penal,duke ju kthyer aktet prokurorit,ndërkohë që nga prokurori ishte kërkuar dënim me burgim dhe aplikim të N.59 të K.Penal.

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për miratim marrëveshje fajësie



e) KËRKESA PËR DËRGIMIN E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM

Gjatë vitit 2019, nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkllës së Parë Elbasan janë dërguar me kërkesa për gjykim të drejtëpërdrejtë ose me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq 763 procedime penale me 867 të pandehur, prej të cilëve 166 të arrestuar.

Janë dërguar në gjykim me kërkesë për gjykim të drejtëpërdrejtë gjithsej 62 procedime me 62 të pandehur, prej të cilëve 12 të arrestuar, si dhe nga gjykata në të gjitha rastet është pranuar kërkesa e prokurorit për gjykim të drejtëpërdrejtë.

Pjesën më madhe me mbi 95% të çështjeve të dërguara me kërkesë për gjykim të drejtëpërdrejtë e zënë çështjet e regjistruara në ngarkim të të pandehurve të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

Janë dërguar në gjykim me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim gjithsej 708 procedime me 809 të pandehur, prej të cilëve 155 të arrestuar, si dhe nga gjykata është pranuar kërkesa për 562 procedime, është vendosur pushimi për 73 çështje ose akuza, është vendosur kthimi i akteve për 4 procedime, si dhe kanë mbetur për tu gjykuar në seancë paraprake 69 procedime me 73 të pandehur prej të cilëve 12 të arrestuar.

- Në lidhje me veprën penale të “Ndërtim i paligjshëm”, i parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, për 68 procedime penale të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur pushimi i çështjes, ndërkohë që për 1 procedim penal kthimin e akteve.

- Në lidhje me veprën penale të “Vrasje me paramendim” e mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 78 e 22 e K.Penal, për 1 procedim penal me 1 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg, të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur pushimi i çështjes.

- Në lidhje me veprën penale të “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, e parashikuar nga nenet 76 e 22 e K.Penal, për 1 procedim penal me 1 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg”, të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur kthimi i akteve. Pas plotësimit të detyrave nga prokurori është kërkuar sërish dërgimi i çështjes për gjykim me të njëjtën akuzë, si dhe nga gjykata është pranuar kjo kërkesë.

- Në lidhje me veprën penale të “Dhunë në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, për 3 procedime penale me 3 të pandehur, të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur pushimi i çështjes ose akuzës.


- Në lidhje me veprën penale të “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 i K.Penal, për 1 procedim penal me 1 të pandehur, të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur kthimi akteve.

- Në lidhje me veprën penale të “Prodhim e shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, për 1 procedim penal me 1 të pandehur, të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur kthimi akteve.


- Në lidhje me veprën penale të “Pengim i ekzekutimit të vendimit të gjyqes”, e parashikuar nga neni 320 i K.Penal, për 1 procedim penal me 1 të pandehur, të dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, nga gjykata është vendosur pushimi i çështjes.

Në lidhje me çështjet penale,ku prokurori ka kërkuar dërgimin e çështjes për gjykim dhe nga gjykata është vendosur pushimi i çështjes,nga prokurorët është ushtruar ankim.

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për dërgim çështje në gjyq



Mënyra e përfundimit të çështjeve në hetim gjatë vitit 2019




ë) ÇËSHTJE TË MBETURA NË HETIM PËR VITIN 2020:

Sic e theksuam më lart ,rezultojnë se nga viti 2019 kanë mbetur për hetim për vitin 2020 gjithsej 1620 procedime me 245 persona nën hetim, 104 të arrestuar.

Nga procedimet penale të mbetura në hetim rezulton se pjesën më të madhe e zënë procedimet për të cilat po hetohet për veprat penale të:

- “Vjedhje”,e parashikuar nga neni 134 i K.Penal,gjithsej 268 procedime;

- “Ndërtim i paligjshëm”,e parashikuar nga neni 199/a i K.Penal,gjithsej 146 procedime;
- “Shpërdorim detyre”,e parashikuar nga neni 248 i K.Penal,gjithsej 114 procedime;
- Veprat penale në lidhje me lëndët narkotike të parashikuara nga nenet 283,283/a e 284 të K.Penal gjithsej 85 procedime;
- Vepra penale në lidhje me shkatërrimet e pronës,të parashikuara nga nenet 150 e 151 të K.Penal,gjithsej 83 procedime;
- “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim”,e parashikaur nga neni 324/a i K.Penal,gjithsej 73 procedime;
- “Drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt”,e parashikuar nga neni 291 i K.Penal,gjithsej 63 procedime;
- “Vjedhje e energjisë elektrike...”,e parashikuar nga neni 137 i K.Penal,gjithsej 52 procedime;
- “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a I K.Penal,gjithsej 50 procedime;
- “Plagosje e lehtë me dashje”,parashikaur nga neni 89 I K.Penal ,gjithsej 50 procedime;
- “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”,e parashikuar nga neni 290 i K.Penal,gjithsej 49 procedime;
- “Shkaktim I vetëvrasjes”,parashikuar nga neni 99 I K.Penal ,gjithsej 43 procedime;
- Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit të parashikaur nga nenet n.235,236,237 e 242,gjithsej 40 procedime;
- “Pastrim i produkteve të veprës penale... ”,e parashikuar nga neni 287 i K.Penal,gjithsej 38 procedime;
- “Fallsifikim i dokumentave”,e parashikuar nga neni 186 i K.Penal,gjithsej 37 procedime;
- “Mashtrim”,e parashikuar nga neni 143 i K.Penal,gjithsej 34 procedime;
- Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet parashikuar nga nenet N.180-182/a,gjithsej 31 procedime;
- Krime kunder jetes te kryera me dashje n.76-84/a të K.Penal,gjithsej 13 procedime.




1/3/3.PERSONAT NËN HETIM DHE TË PANDEHURIT:

Të dhëna për personat nën hetim/të pandehur të hetuar gjatë vitit 2019, për personat nën hetim/të pandehur që u kanë përfunduar hetimet,si dhe personat nën hetim/të pandehur që kanë mbetur në hetim për vitin 2020:

Gjatë vitit 2019 janë hetuar gjithsej 1412 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 277 të arrestuar.

Hetimi ka përfunduar për 1166 persona nën hetim/të pandehur (83 % e të hetuarve),prej të cilëve 173 të arrestuar.

Kanë mbetur në hetim për vitin 2020 gjithsej 246 persona nën hetim 17% e të hetuarve),prej të cilëve 104 të arrestuar.



Ndërkohë në vitin 2018 janë hetuar gjithsej 1240 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 243 të arrestuar.

Krahasuar me vitin 2018,gjatë vitit 2019 janë hetuar 172 persona nën hetim/pandehur më shumë,si dhe 34 persona nën hetim/pandehur më arrestuar më shumë.

Gjatë vitit 2018 hetimi ka përfunduar për 1074 persona nën hetim/të pandehur,prej të cilëve 198 të arrestuar,si dhe mbetën në hetim për vitin 2019 gjithsej 166 persona nën hetim,prej të cilëve 45 të arrestuar.

Krahasuar me vitin 2018 ,gjatë vitit 2019 hetimi ka përfunduar për 92 persona nën hetim/të pandehur më shumë ,prej të cilëve 25 të arrestuar më pak,si dhe janë mbartur në hetim për vitin pasardhës gjithsej 80 persona nën hetim më shumë,prej të cilëve 59 të arrestuar më shumë.

1/3/4.ARRESTIMET NË FLAGRANCË,NDALIMET DHE MASAT E SIGURIMIT PERSONAL

Arrestimet në flagrancë dhe ndalimet:

Gjatë vitit 2019 nga shërbimet e policisë gjyqësore janë arrestuar në flagrancë 555 persona,si dhe janë ndaluar 9 persona,ndërsa nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është urdhëruar ndalimi i 17 personave.

Nga gjykata janë vleftësuar të ligjshëm arrsetimet ose ndalimet e 579 personave dhe janë vleftësuar të paligjshëm arrestimet e 2 personave.

Në lidhje me një arrestim në flagrancë të shpallur të pligjshëm nga gjykata,nga prokurori është ushtruar ankim dhe nga Gjykata e Apelit është ndryshaur vendimi i gjykatës duke u shpallur arrestimi në flagrancë i ligjshëm.

Të dhëna për arrestimet në flagrancë dhe ndalimet gjatë vitit 2019

Neni K.P	Arrestime në flagrancë	Ndalime nga opgj	Ndalime nga prokurori
78 e 79/dh	1	0	1
88	11	0	0
96	2	0	0
99	1	0	0
Krime seksuale	2	2	1
121/a	5	0	0
130/a	47	0	0
134	36	2	0
139	7	0	0
143	0	2	0
178	2	0	0
235,236,237	23	0	0
244	1	0	0
248	2	0	0
259	0	0	2
262	7	0	0
270	17	0	0
278	7	1	0
283,284,283/a	56	2	6
290	32	0	0
291	249	0	0
298	2	0	7
Vepra të tjera penale	45	0	0

Sic shihet dhe nga të dhënat statistikore për të arrestuarit në flagrancë,numrin më të madh e zënë personat e arrestuar për veprën penale të “Drejtim i mjeteve në mënyrë të parregullt”, gjithsej 249 persona.

Vendin e dytë për të arrestuarit në flagrancë nga shërbimet e policisë gjyqësore e zënë personat e arrestuar për veprat penale në fushën e narkotikeve N.283,283/a e 284 të K.Penal,gjithsej 56 persona.

Paskëtyre veprave rezulton se janë arrestuar në flagrancë 47 persona për veprën penale të “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, 36 persona për veprën penale të “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal, si dhe 32 persona për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” të parashikuar nga neni 290 i K.Penal.

Gjatë vitit 2018 nga shërbimet e policisë gjyqësore janë arrestuar në flagrancë 495 persona, si dhe janë ndaluar 4 persona, ndërsa nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është urdhëruar ndalimi i 3 personave.

Ndryshe nga viti 2018 vërehet se gjatë vitit 2019 nga shërbimet e policisë gjyqësore janë kryer 60 arrestime në flagrancë më shumë dhe janë ndaluar 5 persona më shumë, ndërsa nga prokurorët është urdhëruar ndalimi i 14 personave më shumë.

Gjatë vitit 2018 nga prokurori është urdhëruar 1 lirim i menjehershëm, ndërkohë nga gjykata janë vleftësuar të ligjshëm pjesa tjetër e të arrestuarve dhe të ndaluarve.

Masat e sigurimit personal

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët janë kërkuar gjithsej 595 masa sigurimi shtrënguese dhe 4 masa sigurimi ndaluese.

Është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 218 persona, ajo e “arrestit në shtëpi” për 9 persona, “arrest me afat” për 28 persona, “garanci pasurore” për 1 person dhe “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 339 persona.

Gjithashtu nga prokurorët janë kërkuar masa sigurimi ndaluese për 4 persona.

Ndërkohë gjatë vitit 2019 nga gjykata janë dhënë gjithsej 593 masa sigurimi shtrënguese dhe 4 masa sigurimi ndaluese.

Është dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” për 176 persona, ajo e “arrestit në shtëpi” për 25 persona, “arrest me afat” për 26 persona, “garanci pasurore” për 1 person dhe “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 365 persona.

Gjithashtu nga Gjykata janë dhënë masa sigurimi ndaluese për 4 persona.

Nga prokurorët e kësaj prokuroria, në lidhje me masat e sigurimit më të buta të dhëna nga gjykata, apo në lidhje me zëvendësimet e masave të sigurimit është ushtruar ankim 27 raste, ndërsa nga Gjykata e Apelit nuk është vendosur në favor të ankimeve të prokurorit.

Gjatë vitit 2018 nga prokurorët janë kërkuar gjithsej 511 masa sigurimi shtrënguese dhe 3 masa sigurimi ndaluese.

Është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 223 persona, ajo e “arrestit në shtëpi” për 3 persona, “arrest me afat” për 16 persona, “garanci pasurore” për 0 persona dhe “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 269 persona.

Gjithashtu nga prokurorët janë kërkuar masa sigurimi ndaluese për 3 persona.

Krahasuar me vitin 2018 nga prokurorët gjatë vitit 2019 janë kërkuar 5 masa sigurimi “arrest me burg” më pak,6 masa sigurimi “arrest në shtëpi” më shumë,1 masë sigurimi “garanci pasurore” më shumë, 70 masa sigurimi “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” më shumë,si dhe 1 masë sigurimi ndaluese më shumë.

Gjatë vitit 2018 nga gjykata janë dhënë gjithsej 509 masa sigurimi shtrënguese dhe 3 masa sigurimi ndaluese.

Eshtë dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” për 199 persona,ajo e “arrestit në shtëpi” për 7 persona, “arrest me afat” për 13 persona, “garanci pasurore” për 0 persona dhe “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 291 persona.

Gjithashtu nga Gjykata janë dhënë masa sigurimi ndaluese për 3 persona.

Krahasuar me vitin 2018,gjatë vitit 2019 janë dhënë nga gjykata 23 masa sigurimi “arrest me burg” më shumë,18 masa sigurimi “arrest në shtëpi” më shumë,1 masë sigurimi “garanci pasurore” më shumë, 74 masa sigurimi “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” më shumë,si dhe 1 masë sigurimi ndaluese më shumë.

Masat e sigurimit viti 2019

Masa e sigurimit	Kërkesa e prokurorit	Vendimi gjykatëa
Masa shtrënguese	595	593
Arrest në burg	218	176
Arrest në shtëpi	9	25
Arrest me afat	28	26
Garanci pasurore	1	1
Detyrim për paraqitje....	339	365
Masa ndaluese	4	4

Masat e sigurimit viti 2018

Masa e sigurimit	Kërkesa e prokurorit	Vendimi gjykatëa
Masa shtrënguese	511	510
Arrest në burg	223	199
Arrest në shtëpi	3	7
Arrest me afat	16	13
Garanci pasurore	0	0
Detyrim për paraqitje....	269	291
Masa ndaluese	3	3

Të dhëna për masat e sigurimit për vepra penale gjatë vitit 2019

V.P sipas K.Penal	Kërkesa e prokurorit					Vendimi i gjykatës				
	Shtrenguese				Ndaluese	Masa shtrenguese				Ndaluese
	238	237	236	234		238	237	236	234	
78-79	5	0	0	0	0	5	0	0	0	0
88	7	0	0	1	1	5	0	0	3	1
89	0	0	0	2	0	0	0	0	1	0
99	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
100-108	5	0	0	1	0	3	1	0	2	0
121/a	4	0	0	1	0	2	0	0	3	0
130/a	36	1	0	9	0	33	2	0	11	0
134	24	2	0	11	1	20	3	0	14	1
135	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
136	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1
139	8	1	0	0	0	2	6	0	0	1
141/a	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1
143	1	0	0	0	1	1	0	0	0	1
151	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
171-178	2	0	0	0	0	0	1	0	1	0
183	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0
186	2	0	0	0	0	1	0	0	1	0
199/a	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
235-237	12	0	0	11	0	7	1	0	15	0
245/1	6	0	0	0	0	6	0	0	0	0
248	0	0	0	2	2	0	0	0	2	2
259	4	0	0	0	0	3	1	0	0	0
262	5	0	0	2	0	4	0	0	3	0
270	17	0	0	0	0	17	0	0	0	0
278-280	11	0	0	3	0	11	0	0	3	0
283-284	47	0	0	9	0	32	3	0	11	0
289	0	0	0	2	0	0	0	0	2	0
290	19	3	1	31	0	15	5	1	31	0
291	12	1	0	236	0	10	1	0	238	0
298	6	0	0	3	0	6	0	0	3	0
300-324/a	10	0	0	8	0	6	0	0	12	0

1/3/5.MASAT E SIGURIMIT PASUROR:

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e kësaj prokurorie në bazë të nenit 270 e vijues të K.Pr.Penale, vetëm në 1 procedim penal të regjistruar për veprën penale të “Fshehje e të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i K.Penal, është kërkuar vendosja e masës së sigurimit pasuror sekuestro konservative mbi 15 mjete në pronësi të një personi juridik,kërkesë e cila është miratuar dhe nga gjykata.

Nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan,gjatë vitit 2019 është vendosur masa e sigurimit pasuror të sekuestros preventive me vendim gjykate në bazë të neneve 274 e vijues të K.Pr.Penale,pas kërkesave të prokurorëve vetëm në 3 procedime penale:

Për 2 procedime penale të regjistruara për veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale të parashikuar nga neni 287 I K.Penal konkretisht janë vendosur :

- sekuestro preventive mbi 50% të kuotave të zotëruara nga personi nën hetim në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- sekuestro preventive mbi 6 pasuri të paluajtshme të regjistruara në regjistrat hipotekorë;
- sekuestro preventive mbi një autoveturë.

Për 1 procedim penal të regjistruar për veprat penale të “Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Shpërdorim i kompetencave” dhe “Fallsifikim i dokumentave” të parashikuar nga nenet 135,164 e 186 të K.Penal , është vendosur sekuestro preventive mbi 16% të kuotave të shoqërisë të zotëruara nga një ortak i personit juridik.

1/3/6.PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE TË HETIMIT (HETIMI PROAKTIV)

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkalëls së Parë Elbasan,në kuadër të luftës kundër korrupsionit e krimin të organizuar, kundër veprave të rënda ndaj jetës apo ndaj pasurisë ,në fushën e narkotikëvedhe Siapo kundër autoritetit të shtetit,si një mjet i domosdoshëm dhe efikas për kërkimin e provës ,lidhur ngushtë dhe me hetimet proaktive që janë zhvilluar ,si mjete për kërkimin e provës janë përdorur dhe:

- Kontrolllet,parashikuar nga nenet 202-207 të K.Pr.Penale.
- Përgjimet ,ku përfshihen përgjimet telefonike dhe ambjentale,përgjimi i fshehtë fotografik,filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes,mjete këto të parashikuara dhe në Seksionin IV të K.Pr.Penale ,neni 222 e vijues të këtij kodi
- Veprime simuluese,të parashikuar nga neni 294/a i K.Pr.Penale.

KONTROLLET:

Gjatë vitit 2019 nga Prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë bërë në gjykatë 4 kërkesa për kontrolle vendesh, kërkesa këto të miratuara edhe nga gjykata.

Konkretisht kontrolli vendeve është kërkuar nga prokurori dhe vendosur nga gjykata:

- Për 1 procedim penal të regjistruar për veprat penale të “Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Shpërdorim i kompetencave” dhe “Falsifikim i dokumentave” të parashikuar nga nenet 135,164 e 186 të K.Penal ;
- Për 2 procedime penale të regjistruar për veprën penale “Prodhim e mbajtje pa leje e armëve...”, parashikuar nga neni 278 i K.Penal;
- Për 1 procedim penal të regjistruar për veprën penale të “Vjedhje me dhunë” të parashikuar nga neni 139 i K.Penal.
- Për 1 procedim penal të regjistruar për veprat penale “Plagosje e lehtë me dashje” dhe “Kanosje për të mos kallëzuar” të parashikuar nga nenet 89 e 311 të K.Penal.

PËRGJIMET:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbahet rregjistri i posaçëm ku rregjistrohen të dhënat për përgjimet, sipas treguesve të rregjistrimit, por faktikisht nuk regjister nuk është plotësuar në vazhdimësi.

Nga të dhënat e deritanishme rezultojnë se janë rregjistruar 185 vendime lejimi përgjimi referuar edhe të dhënave të marra në gjykatë, ku përfshihen si ato ambjentale, ashtu dhe ato telefonike, si dhe ndërkohë rezulton se janë miratuar 95 kërkesa për zgjatje afati përgjimi telefonik.

Gjithashtu rezulton se nga prokurorët janë nxjerrë gjithashtu 13 autorizime për regjistrimi të fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike

Megjithëse ka rezultuar që hetimet për procedimet penale në të cilat janë përdorur këto mjete të kërkimit të provës, kanë qenë duke u kryer edhe për më tepër se një vepër penale, rezulton se si përgjimet telefonike ashtu dhe ato ambjentale janë kryer më shumë për krime kundër jetës, paskësaj për veprat penale në fushën e korrupsionit, si dhe paskësaj në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve.

VEPRIMET SIMULUESE:

Veprime simuluese rezultojnë të jenë përdorur vetëm në 2 raste në lidhje me një procedim penal të regjistruar për veprën penale të “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” të parashikuar nga neni 259 i K.Penal, si dhe në një rast në lidhje me një procedim penal të regjistruar për veprën penale të “Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” të parashikuar nga neni 298 të K.Penal .

Veprimet simuluese, mbeten të pakta për qarkun e Elbasanit. Veprimet simuluese kërkojnë angazhim dhe nga struktura të tjera të policisë së shtetit, përveç atyre vendore, për shkak se në vende të vogla, policia gjyqësore e ka të pamundur realizimin e veprimeve simuluese për shkak të njohjes së tyre prej qytetarëve si dhe qytetarët jo në çdo rast tregohen bashkëpunues.

2. GJYKIMET

2/1. Të dhëna të përgjithshme.


Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kanë përfaqësuar në gjykim, për vitin 2019, 1152 çështje me 1287 të pandehur, prej të cilëve 316 të arrestuar.

Prej këtyre çështjeve 277 çështje me 308 të pandehur, prej të cilëve 58 kanë qenë të arrestuar, kanë qenë çështje të mbartura në gjykim nga viti 2018, kurse 875 çështje me 979 të pandehur, prej të cilëve 258 të arrestuar, janë dërguar për gjykim në vitin 2018 e 2019 (përfshirë të dhënat për K.Penal Ushtarak), për të cilat vendimarrja e gjykatës për dërgimin e çështjes në gjykim është marrë gjatë vitit 2019,


Sa më lart, janë tregues vetëm për çështjet ku prokurori përfaqëson akuzën, duke mos përmendur çështjet në të cilat prokurori ka marrë pjesë në gjykim, me të dëmtuar akuzes (38 gjykime të tilla), apo raste të tjera si heqje zotësie për të vepruar, kompesime për burgim të padrejtë etj.

Ndërkohë për vitin 2018 prokurorët e kësaj prokurorie kanë përfaqësuar në gjykim 1097 çështje me 1212 të pandehur, nga të cilët 244 të arrestuar, nga të cilat 247 kanë qenë çështje të mbartura në gjykim nga viti 2017 kurse 850 çështje janë dërguar për gjykim në vitin 2018 (përfshirë të dhënat për K.Penal Ushtarak).


Volumi çështjenë gjykim viti 2019




Volumi çështje në gjykim viti 2018



Volumi në gjykim për vitet 2019 e 2018 i krahasuar



Volumi në gjykim për të pandehurit për vitet 2019 e 2018 i krahasuar



Pra në përqindje konstatohet se në vitin 2019, kjo prokurori ka përfaqësuar në gjykim, 53 çështje më shumë me 73 të pandehur më shumë, ose në përqindje 2 % më shumë çështje dhe 2% më shumë të pandehur se sa në vitin e kaluar.

2/2.CËSHTJET NË GJYKIM TË PËRFUNDUARA:

Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi për 772 çështje penale me 841 të pandehur, prej të cilëve 258 të pandehur të arrestuar (248 me masë sigurimi “arrest në burg” dhe 10 të pandehur me masë sigurimi “arrest në shtëpi”).



Ndërkohë gjatë vitit 2018 kishte përfunduar gjykimi për 805 çështje penale me 874 të pandehur e 171 të arrestuar.

Sic shihet në krahasim me vitin 2018 ,rezulton se gjatë vitit 2019 në gjykim kanë përfunduar 33 çështje më pak dhe 33 të pandehur më pak.

Lloji i gjykit:

Në lidhje me çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallës të parë,përsa i përket llojit të gjykit me të cilin është proceduar në gjykim rezulton se :

- 18 çështje me 18 të pandehur e 5 të arrestuar kanë përfunduar me procedurë gjykimi të drejtëpërdrejtë.
- 555 çështje me 607 të pandehur me 236 të arrestuar(226 taë pandehur me masë sigurimi “arrest në burg” dhe 10 të pandehur me masë sigurimi “arrest në shtëpi), kanë përfunduar me procedurë gjykimi të shkurtuar. Në krahasim me vitin 2018 ,gjatë vitit 2019 kanë përfunduar me gjykim të shkurtuar 62 çështje më pak.
- 84 çështje me 101 të pandehur me 15 të arrestuar kanë përfunduar me procedurë gjykimi të zakonshëm.
- 84 çështje me 84 të pandehur e 2 të arrestuar kanë përfunduar me procedurë gjykimi marrëveshje fajësie.
- 31 çështje me 31 të pandehur kanë përfunduar me procedurë gjykimi urdhëri penal.



Kërkesat e prokurorëve në gjykim dhe vendim marrja e gjykatës:

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2019 për 841 të pandehur të gjykuar nga prokurorët janë kërkuar :

- Dënime me gjobë për 110 të pandehur;

- Dënime me burgim për 239 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 469 të pandehur;
- Pushim çështje dhe caktim mase mjekësore për 3 të pandehur;
- Pushim gjykimi për 1 të pandehur të akzuar për N.280 të K.Penal;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri në 3 raste;
- Pushim çështje,për shkak të heqjes dorë nga ankimi për 12 të pandehur të akzuar për N.89 të K.Penal.
- Pezullim gjykimi për 1 të pandehur të akzuar për N.273,e 291 të K.Penal;
- Tërheqje aktesh për 3 të pandehur,të akzuar përkatësisht 1 për N.283/1 të K.P, 1 për N.89 të K.Penal dhe 1 për N.137/1 të K.P.
- Dënime plotësuese për 11 të pandehur.

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2019 për 841 të pandehur të gjykuar nga gjykata janë dhënë :

- Dënime me gjobë për 99 të pandehur;
- Dënime me burgim për 187 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 516 të pandehur;
- Pushim gjykimi për 2 të pandehur;
- Pushim çështje dhe caktim mase mjekësore për 3 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri në 3 raste;
- Pushim çështje,për shkak të heqjes dorë nga ankimi për 13 të pandehur të akzuar për N.89 të K.Penal.
- Pezullim gjykimi për 1 të pandehur të akzuar për N.273,e 291 të K.Penal;
- Kalim(Kthim) aktesh për 4 të pandehur;
- Pafajsi për 13 të pandehur në 11 çështje penale.
- Dënime plotësuese për 9 të pandehur.

Në krahasim me vitin 2018,gjatë vitit 2019 nga gjykata janë dhënë 2 pafajsi më pak.

Në lidhje me pafajsitë e dhëna gjatë vitit 2019 nga gjykata rezulton se:

1. Është dhënë pafajsi për të pandehurin L.C të akzuar për veprën penale “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” të parashikuar nga neni 321/2 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 2099 të vitit 2017,ndërkohë që nga prokurori A.Dilko ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 50000 lekë gjobë;

2. Është dhënë pafajsi për të pandehurin T.H të akzuar për veprën penale “Organizim i llotarive të palejuara” të parashikuar nga neni 197 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 2216 të vitit 2017,ndërkohë që nga prokuroria A.Xhaferri ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 60000 lekë gjobë;

3. Është dhënë pafajsi për të pandehurën N.T të akzuar për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” të parashikuar nga neni 89 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 454 të vitit 2018,ndërkohë që nga prokurori R.Suka ishte kërkuar dënimi i kësaj të pandehure me 150000 lekë gjobë;

4. Është dhënë pafajsi për të pandehurin S.XH të akuzuar për veprën penale “Pengim për ekzekutim i vendimeve të gjykatës” të parashikuar nga neni 320 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 869 të vitit 2017,ndërkohë që nga prokurori B.Mustafaraj ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 100000 lekë gjobë;

5. Është dhënë pafajsi për të pandehurin E.H të akuzuar për veprën penale “Organizim i llotarive të palejuara” të parashikuar nga neni 197 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 2172 të vitit 2018,ndërkohë që nga prokurori B.Nina ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me burgim dhe aplikim dënimi alternativ N.63 i K.P me 40 orë punë në interes publik;

6. Është dhënë pafajsi për të pandehurit E.R dhe M.K të akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve ” e kryer në bashkëpunim,të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal,ku i pandehuri M.K ishte me masën e sigurimit “arrest në burg” në lidhje me procedimin penal 1789/1 të vitit 2016,ndërkohë që nga prokurori R.Suka ishte kërkuar dënimi i të pandehurit E.R me 8 vjet burgim dhe të pandehurit M.K me 7 vjet burgim;

7. Është dhënë pafajsi për të pandehurin K.D të akuzuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 2313 të vitit 2017,ndërkohë që nga prokuroria A.Xhaferri ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me burgim dhe aplikim i dënimit alternativ N.59 i K.Penal,duke u vënë në provë për 16 muaj;

8. Është dhënë pafajsi për të pandehurin e arrestuar U.K të akuzuar për veprat penale “Plagosje e lehtë me dashje” dhe “Kanosja për të mos kallëzuar” të parashikuar nga nenet 89 e 311 të K.Penal,në lidhje me procedimin penal 116 të vitit 2019,ndërkohë që nga prokuroria E.Kokonozi ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 2 vjet e 3 muaj burgim;

9. Është dhënë pafajsi për të pandehurën I.N të akuzuar për veprën penale të “Kallëzim i rremë” i parashikuar nga neni 305 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal nr.1391 të vitit 2018,ndërkohë që nga prokurori Xh.Seferi ishte kërkuar dënimi i të pandehurës me 6 muaj burgim;

10. Është dhënë pafajsi për të pandehurin B.S dhe të pandehurën O.S të akuzuar për veprën penale “ Fshehje e të ardhurave” të parashikuar nga neni 108/2 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 1536 të vitit 2016,ndërkohë që nga prokuroria A.Xhaferri ishte kërkuar dënimi i të pandehurit B.S me 8 vjet burgim dhe dënimi i të pandehurës O.S me 1 vit burgim;

11. Është dhënë pafajsi për të pandehurin XH.L të akuzuar për veprën penale “Vjedhje e enregjisë elektrike...” të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 15 të vitit 2019,ndërkohë që nga prokurori P.Alicka ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me burgim dhe aplikim i dënimit alternativ N.59 i K.Penal,duke u vënë në provë për 2 muaj e 20 ditë;

Gjatë vitit 2019 nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në të gjitha rastet e pafajsive është ushtruar ankim,ashtu si dhe për një pjesë të dënimeve të të pandehurve ndryshe nga sa kishte kërkuar prokurori.Gjithsej gjatë vitit 2019 janë ankimuar 34 vendime të gjykatës.

2/3.ÇËSHTJET NË GJYKIM TË MBARTURA PËR VITIN 2020:

Në fund të vitit 2019 ,janë mbartur për tu gjykuar për vitin 2020 gjithsej 380 çështje me 446 të pandehur prej të cilëve 68 të arrestuar.


Ndërkohë që në fund të vitit 2018 ishin mbartur për tu gjykuar në vitin 2019 gjithsej 277 çështje me 308 të pandehur, prej të cilëve 58 kanë qenë të arrestuar.

3.PERSONAT NËN HETIM / TË PANDEHURIT E HETUAR DHE GJYKUAR.


Gjatë vitit 2019, sipas të dhënave statistiokore , janë hetuar dhe gjykuar gjithsej 1716 persona nën hetim / të pandehur prej të cilëve:

- 38 të mitur 14-18 vjeç dhe 1678 të rritur;
- 1618 meshkuj dhe 98 femra;
- 6 shtetas të huaj dhe 1700 shtetas shqiptarë;
- 1121 me arësim deri në 9 klasë, 426 me arësim të mesëm dhe 169 me arësim të lartë;
- 29 punonjës shtetërorë dhe 1697 punonjës sektori privat apo të papunë;
- 1020 banues në qytet dhe 696 banues në fshat;
- 14 përsëritës së të njëjtës vepër penale, 204 përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 1498 të padënuar më parë;


Të mitur – të rritur




Gjinia




Arsimimi




Punesimi



Vendbanimi



Gjendja gjyqesore



Të pandehur persona juridikë:

Gjatë vitit 2019 janë hetuar, gjykuar apo janë mbartur në gjykim edhe 4 persona juridikë dhe konkretisht:

- Në gjykatë vazhdon gjykimi I një subjekti juridik dhe konkretisht “Kurum International” sha, I akuzuar për veprat penale të “Mashttrim” dhe “Pastrim I produkteve të veprës penale ,të parashikuar nga nenet 143 dhe 287 I K.Penal, I cili është dërguar në gjykim para vitit 2019. Gjikimi nuk ka përfunduar as gjatë vitit 2019 dhe kjo çështje është mbartur në gjykim për vitin 2020.

- Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik “Cani 2005” shpk, të akuzuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Mospagim i taksave dhe tatimeve” të parashikuar nga nenet 180 e 181 të K.Penal dhe në përfundim të gjykimit është vendosur sipas kërkesës së prokurorit, dënimi i kësaj shoqërie me 400000 lekë gjobë. Çështja penale në ngarkim të këtij subjekti i përket vitit 2018 dhe është dërguar për gjykim në vitin 2019.

- Gjatë vitit 2019 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik “Cani 2005” shpk, të akuzuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Mospagim i taksave dhe tatimeve” të parashikuar nga nenet 180 e 181 të K.Penal dhe në përfundim të gjykimit është vendosur sipas kërkesës së prokurorit, dënimi i kësaj shoqërie me 400000 lekë gjobë. Çështja penale në ngarkim të këtij subjekti i përket vitit 2018 dhe është dërguar për gjykim në vitin 2019.

- Gjatë vitit 2019 është dërguar për gjykim subjekti juridik “Orti” shpk i akuzuar për veprën penale të “Fshehje e të ardhurave” e parashikuar nga neni 180 i K.Penal.


4.VIKTIMAT DHE PASOJAT NGA VEPRAT PENALE.

4/1.VIKTIMAT:


Gjatë vitit 2019 kanë mbetur të dëmtuar nga veprat penale gjithsej 310 persona prej të cilëve:

- 37 të mitur deri në 18 vjeç dhe 271 të rritur;
- 158 meshkuj dhe 152 femra.
- 44 kanë mbetur viktimë në lidhje me veprën penale të “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”,parashikuar nga neni 290 i K.Penal (19 të vdekur,18 të plagosur rëndë ,7 të plagosur lehtë apo dëmtime të tjera të lehta);
- 75 kanë mbetur viktimë në lidhje me veprën penale të “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal;
- 42 kanë mbetur viktimë në lidhje me veprën penale të “Shkaktim i vetëvrasjes” të parashikuar nga neni 99 i K.Penal (30 të vdekur);
- 97 kanë mbetur viktimë të veprës penale të “Plagosje e lehtë me dashje” të parashikuar nga neni 89 i K.Penal;
- 4 kanë mbetur viktimë të krimeve kundër jetës të parashikuar nga nenet 76,78 e 79 të K.Penal (4 të vdekur);
- 46 persona kanë mbetur viktimë të vepra të tjera penale.


Viktima(të mitur-të rritur)



Viktima (femra-meshkuj)



Viktima sipas veprave penale




4/2.PASOJAT NGA VEPRAT PENALE


Nga të dhënat statistikore gjatë vitit 2019 kanë ardhur 185 pasoja nga veprat penale ,në lidhje lidhje me jetën apo dëmtimet në shëndet ku:

- Ka patur 59 të vdekur,prej të cilëve 19 për N.290 të K.Penal, 3 për N.289 të K.Penal, 30 për N.99 të K.Penal, 1 për N.96 të K.Penal, 2 për N.85 të K.Penal,si dhe 4 për krime kundër jetës (N.76,78 e 79 të K.Penal);
- Ka patur 26 të plagosur rëndë,prej të cilëve 18 për N.290 të K.Penal e 8 për N.88 të K.Penal;
- Ka patur 100 të plagosur lehtë prej të cilëve 97 për N.89 të K.Penal;
- Ka patur dhe shumë pasoja të tjera dëmtime të lehta në shëndet,të cilat nuk janë pasquruar në të dhënat statistikore.

Pasojat në jetë dhe dëmtime në shëndet



Pasojat në jetë (vdekje)



5. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE:

5/1.Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë:

Gjate vitit 2019,nga Prokurorët e Prokurorisë Elbasan janë nxjerrë gjithsej 819 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë.

Në lidhje me urdhërat e ekzekutimit të nxjerra gjatë vitit 2019 rezulton se janë nxjerrë:

- 257 urdhëra për dënime me burgim;
- 120 urdhëra për dënime gjobë;
- 11 urdhëra për dënime plotësuese;
- 730 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59 të K.Penal(pezullim ekzekutimi vendimi me burgim dhe vënie në provë);
- 89 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 63 të K.Penal (punë në interes publik);
- Si dhe mjaft urdhra ekzekutimi në lidhje me urdhërime të tjera të gjykatës përsa i përket provave e shpenzimeve proceduriale.

Gjatë vitit 2019 janë ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale të formës së prerë të nxjerra gjatë vitit 2019,si dhe të mbartura pa u ekzekutuar nga vitet e mëparshme gjithsej 966 urdhëra ekzekutimi dhe konkretisht:

- 257 urdhëra për dënime me burgim;
- 36 urdhëra për dënime gjobë;
- 747 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59 të K.Penal(pezullim ekzekutimi vendimi me burgim dhe vënie në provë);
- 130 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59/a të K.Penal(qëndrim në shtëpi);
- 89 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 63 të K.Penal (punë në interes publik);

Për vitin pas ardhës 2020 kanë mbetur pa u ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të nxjerra gjatë vitit 2019,si dhe në vitet e mëparshme gjithsej 314 urdhëra dhe konkretisht:


- 4 urdhëra për dënime me burgim të përjetshëm;
- 134 urdhëra për dënime me burgim;
- 177 urdhëra për dënime gjobë;

Ndërkohë gjate vitit 2018,nga Prokurorët e Prokurorisë Elbasan ishin nxjerrë gjithsej 829 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë.


Gjatë vitit 2018 ishin ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale të formës së prerë të nxjerra gjatë vitit 2018,si dhe të mbartura pa u ekzekutuar nga vitet e mëparshme gjithsej 829 urdhëra ekzekutimi,si dhe kishin mbetur pa u ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të nxjerra gjatë vitit 2018,si dhe në vitet e mëparshme gjithsej 331 urdhëra.

Sic shihet në krahasim me vitin 2018,gjatë vitit 2019 janë nxjerrë 10 urdhëra ekzekutimi më pak,por janë ekzekutuar 177 urdhëra ekzekutimi më shumë.


Urdhëra ekzekutimi të nxjerra 2019




Urdhëra ekzekutimi të nxjerra 2018




Urdhëra të ezkutuara 2019




Urdhëra të ekzekutuara 2018



Urdhëra të paezkutuara 2019



Urdhëra të paezkutuara 2018



5/2.Gjykimet në fazën e ekzekutimit me të dënuarit:

Në territorin e Qarkut të Elbasanit janë ngritur dhe vazhdojnë funksionimin 3 institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim :

- IEVP Elbasan,i vendosur në fshatin Bradashesh,të Njësisë Administrative Bradashesh,të Bashkisë Elbasan,i cili më së shumti shërben si institucion paraburgimi;
- IEVP Kosovë-Lushnje,i vendosur në fshatin Kosovë,të Bashkisë Belsh,i cili shërben si institucion burgimi i sigurisë së zakonshme;
- IEVP Peqin,i vendosur në qytetin e Peqinit,i cili shërben si institucion burgimi i sigurisë së zakonshme dhe i sigurisë së lartë.

Përveç këtyre institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale,në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan ndodhen dhe Dhomat e Paraburgimit ,të cilat shërbejnë për mbajtjen e të paraburgosurve të arrestuar në flagrancë apo të ndaluarve,deri në momentin e caktimit të masës së sigurimit nga gjykata,ose që shërbejnë për mbajtjen e të dënuarve të cilët kapen pas dhënies së dënimit me burgim dhe më pas transferohen në institucione të tjera të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim.

Duke qenë se në territorin e Qarkut Elbasan rezultojnë shumë institucione të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim,në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë zhvilluar shumë gjykime mbi bazën e kërkesës së të dënuarve me burgim në bazë të të drejtave që u njihen atyre në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale,si dhe me ligjet “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”

Prokurorët kanë marrë pjesë ne gjykimet administrative penale të zhvilluara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt: “*Lirim para kohe me kusht* “, sipas nenit 64 të Kodit Penal, për 152 të denuar dhe në perfundim të gjykimit:

- Është kërkuar nga prokurori dhe vendosur nga Gjykata, rrezimi i kerkesës për lirim para kohe me kusht për 19 të denuar, pasi nuk kanë paraqitur asnjë arsye te veçantë dhe asnjë dokument tjetër për lirimin me kusht, sikurse parashikohet nga neni 64 i Kodit Penal;
- Sipas kërkesave të prokurorëve,nga Gjykata nuk janë pranuar duke u vendosur mospranimi I kërkesës për lirim para kohe me kusht për 57 kerkesa të dënuarish për shkaqe të ndryshme;
- Sipas kërkesë së prokurorëve, nga Gjykata janë pranuar 41 kërkesa të dënuarish për lirimin para kohe me kusht;
- Janë pranuar nga Gjykata 7 kërkesa të dënuarish për lirim me kusht,për të cilat prokurorët nuk kanë qenë dakort dhe I I kanë ankimuar,si dhe në Gjykatën e Apelit ende nuk kanë përfunduar gjykimet e ankimeve;

Gjatë këtij viti nga prokurorët është marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të dënuarve me objekt ***ndryshimi i llojit të sigurisë*** për 45 të dënuar të cilet vazhdonin të vuajne dënimin në Seksionin e Sigurisë së Lartë të I.E.V.P.Peqin, për të cilët:

- Nga Prokuroria është kërkuar dhe nga gjykata është vendosur rrëzimi i kërkesës për 29 të dënuar;
- Nga prokurorët janë kërkuar dhe është vendosur nga Gjykata mospranimi i kërkesës për 13 të dënuar ;
- Për 3 të dënuar nga Gjykata është vendosur pranimi i kërkesës së të dënuarve për ndryshim të llojit të sigurisë,ndërkohë që nga prokurorët ishte kërkuar rrëzimi i kërkesave.Pas vendimarrjes së gjykatës është ushtruar ankim,ankime që ende nuk janë gjykuar në Gjykatën e Apelit.

Nga ana e 32 të dënuarve është kërkuar **dënimi alternativ “Qëndrim në shtëpi”** bazuar në nenin 59/a te Kodit Penal dhe:

- Sipas kërkesës së prokurorëve për 6 të dënuar,nga Gjykata është vendosur rrëzimi i kërkesës së të dënuarve;
- Sipas kërkesës së prokurorëve për 3 të dënuar,nga Gjykata është vendosur pranimi i kërkesës së të dënuarve;
- Sipas kërkesës së prokurorëve për 21 të dënuar,nga Gjykata është vendosur mospranimi i kërkesës së të dënuarve;
- Ndryshe nga kërkesa e prokurorëve për 2 të dënuar,nga gjykata është pranuar nga Gjykata kërkesa e të dënuarve,si dhe për këto vendimarrje është ushtruar ankim,ankime të cilat ende nuk janë gjykuar në Gjykatën e Apelit.

Gjatë këtij viti nga ana e 11 të dënuarëve është kërkuar **njohja e dënimit të kryer jashtë shtetit**, para kohës së ekstradimit të tyre.

- Sipas kërkesës së prokurorëve për 8 të dënuar,nga Gjykata është vendosur pranimi i pranimit i kërkesës së të dënuarve;
- Sipas kërkesës së prokurorëve për 2 të dënuar,nga Gjykata është vendosur mospranimi i kërkesës së të dënuarve;
- Ndryshe nga kërkesa e prokurorëve për 1 të dënuar,nga gjykata është pranuar nga Gjykata kërkesa e të dënuarit,si dhe për këtë vendimarrje është ushtruar ankim,ankim i cili ende nuk është gjykuar në Gjykatën e Apelit.

Gjatë këtij viti nga 38 të dënuar është bërë **kërkesë për bashkimin e dënimeve** dhe:

- Sipas kërkesës së prokurorëve,nga Gjykata janë pranuar 18 kërkesa;
- Për 6 kërkesa është vendosur moskompetenca në gjykim.
- Për 15 kërkesa të dënuarish,nga Gjykata është vendosur pushimi I cështjes për shkak të heqjes dorë nga I dënuari.

Gjatë këtij viti nuk ka patur kërkesa nga të dënuarit për **shtyrje të ekzekutimit të dënimit me burgim** ,apo **parashkrimi i ekzekutimit të dënimit penal me burgim**.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 për miratim e vendosjes në mbikqyerje të vencantë të të dënuarve me burgim ,pas kërkesave të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,në gjykatë janë dërguar gjithsej 7 kërkesa

Gjatë këtij viti nga të dënuarit që vuajne dënimin në I.E.V.P Peqin dhe Kosovë ka patur kërkesa dhe ankesa të cilat pasi janë shqyrtuar nga ana jonë dhe të dënuarve u është kthyer pergjigje ligjore.

Gjithashtu korrespondencë të vazhdueshme gjatë vitit 2019 ka pasur edhe me Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës ,me IEVP-të dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

6.MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME JASHTË.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, specifikisht nga pala shqiptare në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë 5 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit dhe nga gjykata është vendosur ekstradimi për 2 persona.

Nuk ka patur raste që të jetë kërkuara nga prokurorët e kësaj prokurorie ekstradim nga jashtë shtetit personash të dënuar.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë në gjykatë 24 kërkesa për ekzekutim të letërporosive të ardhura nga autoritetet e huaja,si dhe nga gjykata është disponuar dhe janë ekzekutuar gjithsej 14 letërporosi,ndërsa për 10 letërporosi rezulton se ka qenë e pamundur që të ekzekutuar pavarësisht veprimeve të prokurorit dhe gjykatës.

Letër porosi të dërguara nga prokurët e kësaj prokurorie, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 20 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:

- 2 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 12 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- 6 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit;

Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja rezulton të kenë qenë 11 ku nga gjykata është njohur vendimi i dënimit të dhënë nga autoritetet e huaja në 7 raste,ndërsa të tilla kanë mbetur në gjykim për vitin 2020 gjithsej 4 kërkesa.

Në 1 rast është kërkuar nga prokurorët e kësaj prokurorie njohja e vendimit penal të dhënë nga autoriteti gjyqësor shqiptar për një të dënuar dhe nga autoritetet e huaja nuk është disponuar ende në lidhje me këtë kërkesë.

Gjithashtu bashkëpunimi me autoritet e huaja është shfaqur edhe në drejtim të transferimit të procedimeve penale prej tyre dhe të rregjistruara në prokurorinë tonë si dhe shpalljeve në kërkim ndërkombëtar.

7.TË DHËNA TË TJERA STATISTIKORE

Kriminaliteti sipas shtrirjes territorial të njësive administrative

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin kompetencen e vet ne nje hapësirë gjeografike dhe demografike te madhe. Njohja me këto të dhëna, duke e ndërthurrur me faktorë të tjerë, çon në kuptimin e rezultateve të punës sonë dhe të faktit përse disa vepra penale vihen re të kenë epërsi mbi disa të tjera.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin funksionin e vet në Qarkun e Elbasanit.

Qarku i Elbasanit shtrihet në zonën qendrore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 3278 km² dhe një popullsi prej 442637 banorë.

Ky qark ka një shtrirje gjeografike të madhe dhe kufizohet nga shumë bashki si Tirana,Dibra,Pogradeci,Maliqi,Korca,Skrapari,Berati,Kuçova,Lushnja dhe Rrogozhina,si dhe me vijë kufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qarku i Elbasan përbëhet nga 4 rrethe (Elbasan,Librazhd,Peqin e Gramsh), 7 bashki (Elbasan,Cërrik,Belsh,Peqin,Gramsh,Librazhd dhe Prrenjas),si dhe nga 50 njësi administrative,në përbërje të të cilave janë 386 fshatra.



Aktualisht, bazuar ne ligjin nr. 115 të vitit 2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Qarku Elbasan, ka si qendër të tij, qytetin e Elbasanit.


Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre

Sipas veprave penale të ndodhura dhe referimeve të policisë gjyqësore, konstatohet se sipas shtrirjes territoriale në Bashkinë Elbasan, në krahasim me bashkitë e tjera të Qarkut Elbasan, rezulton se në numër janë më të përhapura veprat penale të “Dhuna në familje” (N130/a KP), “Vjedhje” (N.134 KP), “Prodhin e shitje e narkotikëve” (N.283 i K.Penal) .

Përsa i përket veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” (N.284 i K.Penal) rezulton se kjo vepër është më e përhapur në bashkitë Librazhd, Gramsh e Peqin, ku karakteritike është fakti se bimët narkotike janë mbjellur në sipërfaqe toke shtetërore pranë kufijve ndarëse të qarkut Elbasan me qarqet e tjera, vende këto ku është shumë e vështirë që të shkohet dhe kontrollohet dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore.

-Përsa i përket veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” (N.290 i KP) rezulton se një pjesë e konsiderueshme e këtyre veprave kanë ndodhur në akset rrugore nacionale “Elbasan-Peqin-Rrogozhinë” dhe “Elbasan-Librazhd-Prenjas-Pogradec”.

Procedime të rregjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2018–2019



Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, të shprehura në përqindje, **në krahasim të dy viteve është si vijon:**

Në vitin 2019, krime kundër jetës, me dashje janë regjistruar 20 materiale, ose 23 % më pak se në vitin 2018, kur ishin regjistruar 32 materiale.

Në vitin 2019 kemi të regjistruar 2 veprë penale kundër jetës të shkaktuar nga pakujdesia, ndërkohë që në vitin 2018 kishim regjistruar 1 të tillë.

Në vitin 2019, Vepra penale me dashje kundër shëndetit janë regjistruar 112 procedime penale të cilat qëndrojnë thuajse në të njëjtin nivel me vitin 2018, kur ishin regjistruar 114 çështje të tilla.

Në vitin 2019 është regjistruar 1 procedim penal për veprë penale kundër shëndetit me pakujdesi, ndërkohë që në vitin 2018 është regjistruar po 1 procedim penal.

Në vitin 2019, Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës janë regjistruar 46 procedime penale. Në vitin 2018, Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës janë regjistruar 73 procedime penale. Pra në përqindje, rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar 23 % më pak.

Në vitin 2019, procedime penale për Krime seksuale, janë regjistruar 20 procedime penale, ndërkohë që në vitin 2018 ishin regjistruar 10 të tilla. Pra në përqindje, rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar 33 % më shumë.

Në vitin 2019, Vepra penale kundër lirisë së personit, janë regjistruar 9 të tilla. Në vitin 2018, Vepra penale kundër lirisë së personit ishin regjistruar 2. Pra në përqindje, rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar 33 % më shumë.

Në vitin 2019, Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit janë regjistruar 14. Në vitin 2018, Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit janë regjistruar 22. Pra në vitin 2019 janë regjistruar 22 % më pak.

Në vitin 2019, Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes janë regjistruar 119. Në vitin 2018, Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes ishin regjistruar 102. Pra në vitin 2019 kemi një rritje me 8 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2019 dhe 2018 nuk ka pasur të regjistruara procedime penale për Vepra penale kundër lirisë së besimit;

Në vitin 2019, vepra penale në lidhje me Vjedhjen e pasurisë kanë qenë 701. Në vitin 2018 numri i çështjeve të regjistruar për Vjedhja e pasurisë ka qenë 734. Pra në vitin 2019, ka pësuar një rënie me 2 %.

Në vitin 2019, veprat penale në lidhje me Mashtrimet janë regjistruar 35. Në vitin 2018, regjistrimi i çështjeve për këto vepra penale, Mashtrimet, kanë qenë të regjistruara 30. Pra në vitin 2019 kemi një rritje me 8 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2019, vepra penale që lidhen me Shkatërrimin e pronës janë regjistruar 119. Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Shkatërrimin e pronës janë regjistruar 131. Pra në 2019, kemi një rënie me 5 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2019 janë regjistruar 5 vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare, ndërkohë që në vitin 2018, kanë qenë 13 të tilla. Pra në përqindje reflektohet me një ulje prej 44 % më pak.

Në vitin 2019 dhe 2018 nuk ka pasur të rregjistruara materiale për Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare;

Në vitin 2019, Krime në fushën e doganave kanë qenë të rregjistruara 7. Në vitin 2018, Krime në fushën e doganave, janë rregjistruar 9. Pra kemi diferencë në ulje me 13% më pak.

Në vitin 2019, Vepra penale në fushën e tatim taksave ka pasur të rregjistruara 27. Në vitin 2018, Vepra penale në fushën e tatim taksave janë rregjistruar 17. Pra në përqindje janë rregjistruar këtë vit 23 % më shumë.

Në vitin 2019, vepra penale në lidhje me Falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë kanë qenë 3. Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë kanë qenë 5. Pra rezulton se në vitin 2019 janë rregjistruar 25 % më pak.

Në vitin 2019, vepra penale në lidhje me Falsifikimi i dokumentave janë rregjistruar 39. Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Falsifikimi i dokumentave janë rregjistruar 56. Pra janë rregjistruar 18% më shumë në vitin 2018.

Si në vitin 2019 ashtu edhe në vitin 2018, nuk ka pasur të rregjistruara Vepra penale në fushën e falimentit;

Në vitin 2019, vepra penale në lidhje me Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit, janë rregjistruar 19. Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit janë rregjistruar 16. Pra në vitin 2019rezulton të jenë rregjistruar 9% më shumë.

Në vitin 2019, Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës janë rregjistruar 269. Në vitin 2018, Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës janë rregjistruar 167. Pra në vitin 2019, janë rregjistruar 23 % më shumë nga këto vepra penale se në vitin e kaluar.

Në vitin 2019 Vepra penale kundër mjedisit ishin rregjistruar 31. Në vitin 2018, janë rregjistruar 24. Pra konstatohet që në vitin 2019 ka një rritje me 13 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2019, Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga shtetasit janë rregjistruar 73. Në vitin 2018, janë rregjistruar 63. Pra kemi një rritje prej 7 % më shumë në vitin 2019.

Në vitin 2019, Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga punonjësit janë rregjistruar 118. Në vitin 2018, janë rregjistruar 64. Pra konstatohet një rritje prej 30 % më shumë të rregjistruara në vitin 2019.

Në vitin 2019, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë rregjistruar 663. Në vitin 2018, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë rregjistruar 603. Pra në vitin 2019, rezulton të jenë rregjistruar 5 % më shumë vepra penale se vitin e kaluar.


Në vitin 2019, janë rregjistruar 5 vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore ndërkohë që në vitin 2018, kjo shifër ishte 6. Pra në vitin 2019;

Në vitin 2019, Vepra penale kundër drejtësisë janë rregjistruar 95. Në vitin 2018, janë rregjistruar 77. Pra janë rregjistruar 7 % më shumë vepra penale në vitin 2019, se vitin e kaluar.


Në vitin 2019, Vepra penale që çënojnë zgjedhjet e lira janë rregjistruara 3,ndërkohë që në vitin 2018 janë rregjistruar 10 të tilla.

Si në vitin 2019 ashtu edhe në vitin 2018, nuk ka pasur të rregjistruara vepra penale në lidhje me bandat e armatosura dhe organizatat kriminale dhe as ndonjë vepër penale të parashikuar në ligje të tjera.

Viti 2019



Viti 2018



Raporti krime dhe kundravajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2018, sipas ndarjes në krime dhe kundravajtje penale që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.

Viti 2019



Viti 2018



III. TË DHËNA PËR ADMINISTRIMIN DHE RAPORTIN FINANCIAR TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN.

1. Organika e Prokurorisë:

Ne vitin 2019, stafi i kësaj prokurorie, sipas organikës së miratuar ka qenë perbëhet nga 51 punonjës të përhershëm dhe 1 punonjëse me kontratë. Numri në organikë i prokurorëve është 26 sëbashku me Drejtuesin e Prokurorisë.

Puna e prokurorëve është ushtruar nën drejtimin e drejtuesit të kësaj prokurorie i cili ndihmohet nga 1 zëvendës drejtues si dhe 4 drejtuesit e seksioneve.

Është për tu theksuar fakti se në këtë prokurori gjatë vitit 2019 numri real i prokurorëve që kanë ushtruar funksionet pranë kësaj prokurorie ka qenë më pak se ai i miratuar në organikë, për arsye se 1 prokuror i larguar nga KPK si pasojë e procesit të rivlerësimit të prokurorëve dhe që është në proces ankimi, 2 prokurorë kanë vazhduar të ishin të komanduar në prokurori të tjera, ndërsa 1 prokuror (ish-Drejtuësja e Prokurorisë) është emëruar prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (SPAK) më dt. 19.12.2019.


Gjatë vitit 2019 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan organizimi në seksioneve ka qenë në këtë mënyrë:

- Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër personit dhe krimeve kundër jetës, kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, kundër veprave penale me objekt dhunën me bazë gjinore, kundër drejtësisë etj, në përbërje të të cilit janë caktuar 4 prokurorë dhe 1 oficer i policisë gjyqësore i seksionit.
- Seksioni i Posaçëm i Përkohshëm, në përbërje të të cilit kanë qenë caktuar 3 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve;
- Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike si dhe kundër autoritetit të shtetit, në përbërje të të cilit aktualisht janë 9 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve;
- Seksioni për hetimin dhe gjykimin e veprave penale me të pandehur dhe viktimë të mitur si dhe për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, në përbërje të të cilit aktualisht janë 4 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve.


Ndërkohë, duke pasur parasysh se një pjesë e çështjeve duke qenë se kanë qenë nën hetim apo nuk rezulton të jenë referuar nga Forca e ligjit e policisë së shtetit, janë ndjekur nga prokurorët sipas seksioneve të ndara në grup vepra penale.

Tabelë organike numerike e prokurorisë për vitin 2019

Prokurorët deri më 19.12.2019				
Emërtimi	Organika	Fakti	Meshkuj fakt	Femra fakt
Drejtuës	1	1	0	1
Zv/Drejtuës	1	1	1	0
Prokurorë	24	21	13	8
Gjithsej	26	23	14	9



Prokurorët pas 19.12.2019				
Emërtimi	Organika	Fakti	Meshkuj fakt	Femra fakt
Drejtues	1	1	1	0
Zv/Drejtues	1	1	1	0
Prokurorë	24	20	12	8
Gjithsej	26	22	14	8




Gjatë vitit 2019 në këtë prokurori ka ushtruar funksionet e prokurorit një prokurore e komanduar nga një prokurori tjetër që në vitin 2018 ,të cilës i është ndërprerë komandimi në shtator të vitit 2019,si dhe në të njëjtën periudhë kohore ka ardhur një prokuror,i cili ka qenë pjesë e organikes së kësaj prokurorie por ishte komanduar më parë në një prokurori tjetër që në vitin 2018.

Policia gjyqësore pranë kësaj Prokurorie, në përbërjen e saj ka pasur gjithsej 9 oficerë policie gjyqësore, ku 2 prej tyre janë emëruar në vitin 2019.

Tabelë organike numerike e policisë gjyqësore


Numri	Organika	Efektivë	Meshkuj	Femra
OPGJ	9	9	6	3



Personeli administrativ vepron në krah të prokurorëve dhe ndihmon në prodhimin, administrimin e të gjithë dokumentave apo në shërbime të tjera të domosdoshme për punën tonë. Numri i përgjithshëm i personelit administrativ, duke përfshirë Kancelaren, kryesekretaren, kryetaren e degës së buxhetit, koordinatoren për të miturit dhe viktimat, sekretare si edhe punonjësit në shërbimet ndihmëse si shoferë, punonjës shërbimi, sanitare, administrator rrjeti, në vitin 2019 ka qene 15, nga të cilët 10 femra dhe 5 meshkuj.

Tabele organike numerike e administratës

Funksioni	Organika	Meshkuj	Femra
Kancelare	1	0	1
K/Sekretare	1	0	1
K/Deges Buxhetit	1	0	1
Koordinatore	1	0	1
Punonjës shërbimi IT	1	1	0
Sekretare	7	1	6
Shofer	3	3	0
Portier	1	1	0
Sanitare+Sanitare me kontratë	1	0	2
Gjithsej	18	6	12



2.Raporti Financiar

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2019 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-financiare janë çelur fondet:

Fondi	Plan	Fakt	Realizimi
Fondi i Pagave 600	111,606,000	111,349,317	99.78 %
Fondi i sigurimeve Shoq.Shëndt.	10,824,000	10,333,329	95.5 %
Fondi i shpenzimeve materiale	16,325,000	16,322,108	99.98 %
Fondi transferta korrente te brendshme	50,000	50,000	100 %
Fondi investimeve	0	0	0 %

Shpenzime procedurale të arkëtuara nga Prokuroria janë **163,570** lekë të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Totali i pagesës së orëve të gadishmërisë për prokurorët është në shumën prej **9,027,800** lekë.

Totali i pagesës të mbikohës të punës për prokurorët është **381,200** lekë.

IV.PROBLEMATIKAT E HASURA GJATË VITIT 2019

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, referuar ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë, në punën e përditshme gjatë vitit 2019 janë konstatuar edhe problematika të ndryshme:

- Konstatohet se jo në çdo rast zbatohen nga prokurorët e kësaj prokurorie udhëzimet dhe kryesisht ato udhëzime që në pjesën dërrmuese nuk janë zbatuar kanë të bëjnë pikërisht me raportimin e të dhënave statistikore. Kjo vjen edhe si pasojë e ngarkesës në punën e tyre në ushtrim të funksioneve sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kushtetutës.Për këtë arsye, në këtë raportim jemi munduar të pasqyrojmë në mënyrë më të plotë të gjitha të dhënat e grumbulluara pas një konsultimi me të gjithë prokurorët. Arsyet që prokurorët nuk kanë raportuar të dhënat për përgjimet në kohën e duhur, ka pasur të bëjë me faktin se janë konsideruar materiale sekrete. Gjithashtu e njëjta situatë është konstatuar edhe në disa raste të rifillimit të çështjeve të pezulluara.

- Ndërkohë përsa i përket përdorimit të sistemit CAMS, përveç përdorimit të rregullt të tij për hedhjen e shortit elektronik, prokurorët jo në çdo rast e kanë të mundur pasqyrojnë hedhjen e të dhënave në sistem.

Së pari për shkak të ngarkesës së tyre në punë, hedhja e të dhënave në sistem, përsa kohë prokurorët nuk asistohen personalisht nga sekretare apo oficerë të policisë gjyqësore, pasur parasysh ngadalësinë me të cilën punon ky sistem, është e vështirë për prokurorët të tregohen efektivë si në hetim, përfaqësim në gjykatë dhe hedhjen e të dhënave në sistem;

Së dyti: Sistemi nuk është i azhornuar me ndryshimet e reja të K.Pr.Penale;

Së treti: hedhja në short e materialeve, nëpërmjet sistemit elektronik, konstatohet se nuk bën një ndarje pothuajse të barabartë të punës ndërmjet prokurorëve dhe për këtë shkak shpesh herë Drejtuesi i Prokurorisë detyrohet të përjashtojë prokurorë të caktuar nga shorti, me urdhër.

- Gjithashtu përsa i përket të dhënave statistikore që raportohen në Prokurorinë e Përgjithshme është e nevojshme që të rishihen dhe përmirësohen tabelat statistikore,me qëllim që në to të gjejnë pasqyrim ndryshimet e K.Penal,në lidhje me veprat e reja penale,si dhe në lidhje me pasqyrimin sa më të saktë të të dhënave sipas rregullave të përcaktuara në K.Pr.Penale,pasi në ato aktualet nuk pasqyrohen bashkimet apo ndarjet e çështjeve, pushimet e kundravajtjeve penale nga prokurori,kërkesat për pushim dhe vendim marrja e gjykatës, kërkesat për miratim urdhëri penal dhe vendimarrja e gjykatës,si dhe kërkesat për miratim marrëveshje fajësie dhe vendim marrja e gjykatës.

- Në lidhje me kërkesat për informim rezulton të jetë ekzistues regjistri i kërkesave të bëra në mbështetje të ligjit të sipërcituar, në të cilin shënohen kërkesat dhe kthimi i përgjigjes, sipas rubrikave përkatëse.

Përsa i përket mbajtjes së regjistrave, rezulton se përgjithësisht është kryer një punë e mirë në drejtim të mbajtjes së pasqyrimin të të dhënave në sistemin manual dhe atë elektronik.

Ka edhe disa mospërputhje me faktin, të cituara në këtë raport, gjë e cila ka ndodhur për shkak të mosraportimit në kohën e duhur nga prokurorët. Siç edhe u citua në pjesën e mësipërme të këtij raporti, vazhdimisht nga Drejtuesi i Prokurorisë, janë nxjerrë udhëzimet përkatës, për mbledhjen e të dhënave statistikore për çështje të vlerësuara të një kategorie të veçantë.

Këto udhëzime rezultojnë të mos jenë zbatuar, pasi prokurorët paraqesin ankesa në lidhje me ngarkesën e tyre përsa i përket hetimit dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve penale.

Duke qenë se punonjësit e administratës, janë ngarkuar me punë të ndryshme, në fakt edhe prej tyre, shpesh gjendet e vështirë për t'i ngarkuar me mbledhjen e të dhënave statistikore për çështje të caktuara, sipas udhëzimeve. Rregjistrat mbahen dhe plotësohen nga punonjës të administratës dhe në disa raste nga oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve, për shkak të ngarkesës së punës së punonjësve të administratës.

- Mungesa faktike e numrit të prokurorëve të caktuar në organikë, si dhe lëvizja e prokurorëve të komanduar, ka sjellë si pasojë rritjen e ngarkesës së prokurorëve.
- Problematikë ka qenë dhe numri i pakët i oficerave të seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;
- Problematikë ngelet numri i vogël i punonjësve të administratës, duke patur parasysh se në këtë prokurori nuk ka në organikë punonjës arshivist, si dhe duke qenë se numri i sekretarëve është i vogël, në krahasim me numrin e prokurorëve dhe numrin e çështjeve të trajtuara në këtë prokurori.
- Problematike për këtë prokurori mbetet mungesa e një punonjësi të shërbimeve të përgjithshme në lidhje riparimet dhe mbajtjen në funksionin të pajisjeve elektrike dhe ashensorit, apo mirëmbajtje të tjera të përgjithshme të ambejnteve të prokurorisë;
- Në lidhje me punën e oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës konstatohet se nga prokurorët u janë dhënë për hetim procedime penale të referuara nga shërbime të tjera të policisë gjyqësore pa u justifikuar shkak, duke sjellë si pasojë ngarkesën me punë të këtyre oficerëve.
Gjithashtu vërehet se dhe në ngarkesën e çështjeve në hetim të oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore ka pabarazi të numrit të çështjeve të hetuar nga secili oficer.
- Në lidhje me punën e oficerëve të shërbimit të policive gjyqësore në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, duke përfshirë dhe ata të komisaritëve të policisë vërehet se :
 - Mungesë profesionaliteti në përgatitjen e materialeve të para hetimore, duke mos u kryer të gjitha verifikimet e mundshme në lidhje me faktet e kallëzuar apo ngjarjet në kushte flagrante, si përshembull:
 - Përshkrimin sa më korrekt të kqyerjeve të vendit të ngjarjes;
 - kryerje vendimesh ekspertimi autoteknik në lidhje me ngjarjet e aksidenteve automobilistike, pasi është konstatuar se materialet e referuara shoqërohen vetëm me vendime kryerje ekspertimesh mjeko-ligjore;

-referimesh ngjarjesh në lidhje me aksidentet automobilistike të cilat nuk kanë sjellë pasoja në shëndet për shtetasit e përfshirë në aksidente,të cilat nuk përbëjnë shkak për regjistrimin e procedimeve penale,ndërkohë që këto ngjarje duhej të ishin trajtuar si çështje administrative nga shërbimet e policisë rrugore.Shkak I bërjes së këtyre referimeve është bërë dhe hezitimi I shërbimeve të policisë rrugore për të proceduar për këto ngjarje në rrugë administrative,për shkak të ankesave të mundshme të shtetasve të përfshirë në ngjarje automobilistike.

Theksojmë se në këto raste,nëse do të kryheshin në bazë të ligjit të gjitha detyrat nga shërbimet e policisë rrugore dhe do të merreshin masat përkatëse po në bazë të ligjit,duke u dokumentuar ato korrektësisht,atëherë cdo punonjës policie nuk ka se pse të ketë frikë me përballjen me ankesat e shtetasve të ndryshëm,ndërkohë që dhe në K.Rrugor janë parashikuar dhe ankesat në lidhje me vendim marrjen e këtyre shërbimeve.

-marrjes së dëshmimeve sa më të plota të dëshmitarëve,si për veprat penale kundër jetës;

- Mosnjoftimi në kohë reale I prokurorëve për ndodhjen e ngjarjeve të rënda kriminale,apo dyshimeve për ekzistencën e veprave penale të tilla ,si dhe mungesë kërkesash në këto raste për përdorimin e metodave speciale të hetimit si kryerje përgjimesh,autorizime vëzhgimi etj,si dhe veprimesh simuluese;

- Moskryerja në kohë dhe në vazhdimësi të veprimeve hetimore të deleguara nga prokurori;

- Në lidhje me hetimet pasurore dhe pastrimet e produkteve të veprës penale problematike është edhe fakti se me këto veprime hetimore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan është caktuar vetëm një oficer e policisë gjyqësore;

- Në këtë moment, vlen të theksojmë se në prokurori, nga policia gjyqësore referohen shpesh raste fatkeqe, të cilat që në momentin e parë konstatohen se nuk përmbajnë asnjë fakt penal (si vdekjet natyrale etj.), apo vepra penale që ndiqen drejtëpërdrejtë nga viktimat akuzuese në gjykatë, duke pas sjellë një rritje volumi të punës së prokurorisë.

- Në lidhje me shërbimet e policive gjyqësore të sketorëve të hetimit doganor dhe tatimor vërehet se ka mangësi në referime,si dhe në përgatitjen e materialeve të para hetimore.

Nga puna e bërë rezulton se në shumë raste agjensitë e hetimit tatimor apo doganor janë mjaftuar vetëm me njoftimin pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan apo Komisariatet përkatëse të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie,për konstatimin e rasteve të veprave penale në fushën e tatimeve apo doganave,duke mos plotësuar vetë tërë dokumentacionin përkatës dhe më pas bërjen e kallëzimeve penale në bazë të legjislacionit përkatës që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre sic janë ligjet mbi procedurat tatimore,ligjet mbi akcizat,apo Kodi Doganor.Në këtë mënyrë ngarkohet me veprime hetimore policia e shtetit,ndërkohë që në këto raste ajo duhet të ishte vetëm mbështetëse e veprimtarisë së këtyre agjensive ligjzbatuese.

Është për t'u theksuar se ndjehet nevoja e referimit të veprave penale nga organet tatimore , pasi ndodh shpesh që veprat penale në fushën e tatim taksave referohen nga policia gjyqësore, kur ndërkohë fakti që të rezultojë penal, duhet të jenë ezauruar procedurat administrative, gjë që nuk ndodh në rastet e referuara nga policia.

- Problematikë ka qenë moskryerja në kohë prej ekspertëve të Institutit të Policisë Shkencore të ekspertimeve të ndryshme të vendosura nga prokurorët apo oficerët e policisë

gjyqësore, edhe pse prej drejtuesve të këtij institucioni në vazhdimësi janë shprehur shqetësime për mungesë stafi, ngarkesë të madhe me vendime kryerjesh ekspertimesh, mungesë vendi për mbajtjen e provave materiale të dërguara për ekspertim etj;

- Problematikë ka qenë kthimi i përgjigjeve në kohë sa më të shpejtë të shoqërive telefonike celulare në lidhje me informacionet e kërkuara nga prokurorët për numra telefoni celular apo abonentë të këtyre shoqërive, gjë që ka sjellë si pasojë vonesa në hetim;
- Në lidhje me veprat penale kundër mjedisit, është për t'u theksuar se qarku i Elbasanit, është i evidentuar si një qark me probleme të theksuara në ndotjen e ajrit, kërkojmë një angazhim më të madh të Ministrisë së Mjedisit, pasi prokuroria e ka të pamundur të gjejë mjete të cilat masin ndotjen e ajrit dhe angazhimi i ekspertëve privatë, përveç mungesës së këtyre mjeteve, për kryerjen e detyrave të cilat mund t'i realizojnë, janë një shpenzim shumë i madh për prokurorinë.
- Në lidhje me veprat penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale, apo ato në fushën e taksave dhe tatimeve, problematikë ka qenë zgjedhja e ekspertëve kontabël, për shkak të volumit shumë të madh të këtyre çështjeve, trajtimit të aktivitetit ekonomiko-financiar të shtrirë në kohë dhe në subjekte, si dhe caktimi i ekspertëve privatë do të rriste në mënyrë shumë të konsiderueshme në vlerë shpenzimet financiare të kësaj prokurorie.
- Problematikë ka qenë dhe pagimi i ekspertëve të MKZ-së në lidhje me ekspertimet e zjarreve të rëna për shkak të tarifave të larta, duke qenë se këta ekspertë janë në varësi të Bashkive. Mendojmë se do të ishte e nevojshme arritja e ndonjë marrëveshje ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me institucionet qendrore të pushtetit ekzekutiv për mënyrën e pagimit të këtyre lloj shpenzimeve.

V.PRIORITETET DHE REKOMANDIMET PËR VITIN PASARDHËS.

1.Prioritetet e punës për vitin 2020:

Pamvarsisht arritjeve në punën e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2019, prioritet në punën e prokurorëve të kësaj prokurorie për vitin 2020 mbeten:

- ***Lufta kundër korrupsionit:***

Pavarësisht se pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK) dhe në bazë të nenit 75/a të K.Pr.Penale veprat penale në fushën e korrupsionit i kanë kaluar për kompetencë hetimi dhe gjykimi kësaj Prokurorie të Posaçme, nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për vitin 2020 gjatë hetimit të procedimeve penale që lidhen me veprat penale kundër autoritetit të shtetit të kryera nga funksionarët shtetërorë dhe nëpunësit në shërbim publikë, apo hetimet që lidhen me vepra të tjera penale, do të mbahet parasysh që në rast evidentimi të elementëve të veprave penale në fushën e korrupsionit, të merren masat

proceduriale përkatëse për dërgimin në kohë për kompetencë të këtyre çështjeve pranë Prokurorisë së Posaçme.

- ***Lufta kundër krimit të organizuar***

Në vitin 2020, nga prokurorët e kësaj prokurorie duhet të merren masa të menjëhershme për hetimin e rasteve të hetimit pasuror të ardhura për kompetencë nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, çështjeve të reja që do të regjistrohen, si dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të vëna nga aktivitete kriminale, në respektim të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 dhe Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Përsa i përket veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, prioritet i punës së prokurorëve për vitin 2020 do të jetë rritja e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, si dhe rritja e numrit të pasurive të sekuestruara, në kuadër të hetimit të këtyre çështjeve penale, si dhe më pas konfiskimi i tyre në zbatim të rregullave të K.Pr.Penale.

Përsa i përket veprave penale në fushën e lëndëve narkotike, armëve dhe trafikut të armëve, prostitucionit apo trafikimit të njerëzve, gjatë vitit 2020 do të kërkohet një angazhim më i madh i policisë gjyqësore dhe i agjentëve të tjerë ligjzbatues, në identifikimin e personave që janë pjesë e tregut të paligjshëm të lëndëve narkotike, armëve, prostitucionit apo trafikimit të njerëzve.

Gjithashtu do të kërkohet një angazhim më i madh i prokurorëve për të shtrirë hetimin në disa drejtime, me qëllim, rritjen dhe forcimin e luftës ndaj veprave penale në këto fusha, si dhe rritjen e numrit të çështjeve të tilla të cilat hetohen me veprime proaktive.

Nga prokurorët do të kihet parasysh që për këto lloj veprash penale të rriten masat shtrënguese si dhe dënimet, duke pasur si orientim ashpërsimin e tyre.

-Përveç luftës kundër krimit të organizuar, prioritet në punën e prokurorëve të kësaj prokurorie, gjatë vitit 2020, si një detyrim kushtetues, do të jetë prioritet dhe përfundimi i çështjeve të mbartura duke u dhënë atyre zgjidhje sa më të shpejtë ligjore, si dhe hetimi në një kohë sa më të shpejtë, objektiv dhe të gjithanshëm dhe përfaqësimi i akuzës në gjykim, në lidhje me të gjitha procedimet penale që do të regjistrohen reja edhe për veprat penale të tjera.

- ***Të drejtat e njeriut***

Gjatë vitit 2020, në respektim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në zbatim të parimit të mosdiskriminimit, në vazhdimësi do të respektohen me rigororizet sipas rregullave të K.Pr.Penale të drejtat proceduriale të të pandehurve dhe viktimave të veprës penale në tërësi, si dhe në vecanti atyre të mitur, personave që për shkak të gjinisë janë vulnerabël dhe personave me aftësi të kufizuar.

- ***Bashkëpunimi ndër institucional***

Duke pasur parasysh që askush nuk mund të luftojë i vetëm kriminalitetin , një rëndësi e posaçme gjatë vitit 2020 do ti jepet bashkëpunimit me agjensitë e tjera ligjzbatuese.

Do të kihet parasysh trajtimi në kohë dhe me përparësi trajtimi i informacioneve që do të vinë nga SHISH, pa anashkaluar faktin e bashkëpunimit me institucione të tjera si ILDKP, KLSH, DPPP,hetimi doganore,hetimi tatimor,apo agjensi të tjera ligjzbatuese.

Ky bashkëpunim nuk do të ketë të bëjë vetëm me faktin e referimit prej këtyre agjensive të veprave penale,por edhe me faktin e shkëmbimit të informacionit në një mënyrë sa më të shpejtë. Në këtë drejtim, do të ishte me vend, mundësia e rritjes së aksesimit në te dhenat e ketyre institucioneve nëpërmjet sistemeve të perbashketa kompjuterike, pasi do te shkurtonte kohën e hetimit dhe marrjen e informacioneve në kohë reale.

Në lidhje me veprat penale kundër mjedisit, është për t'u theksuar se qarku i Elbasanit, është i evidentuar si një qark me probleme të theksuara në ndotjen e ajrit dhe prerjen e paligjshme të pyjeve,prioritet në punën tonë do të jetë rritja e numrit të çështjeve penale të referuara nga agjensitë ligjzbatuese në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe evidentimi dhe dënimi i personave përgjegjës.

- ***Çështje të organizimit të brendshëm të prokurorisë:***

Gjatë vitit 2020, në kuadër të ndryshimeve të vitit 2019 të K.Penal,ku janë shtuar një sërë veprash të reja penale,si dhe për shkaqe procedurale pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme,prioritet në punën e Drejtuesit të Prokurorisë do të jetë riorganizimi i seksioneve të ngritura në këtë prokurori,për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të punës dhe balancimin e ngarkesës së secilit prokuror dhe oficeri të policisë gjyqësore dhe mundësimin e specializimit të prokurorëve sipas seksioneve përkatëse, në fusha të caktuara. Kjo do të sillte detyrimisht rritjen e tyre profesionale dhe pasoja të drejtëpërdrejta në hetimet e çështjeve.

Prokurorët rezultojnë t'i nënshtrohen Programit të Trajnimit Vazhdues për prokurorët dhe gjyqtarët, të Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë që oficerët e policisë gjyqësore të Seksioneve, nuk janë pjesë e këtij programi. Trajnimet për ta janë shumë të pakta dhe jo të gjithë kanë pasur mundësinë e nënshtrimit ndaj trajnimeve gjatë vitit që kaloi. Për këtë shkak gjendet me vend, që të organizohen trajnime për oficerët e policisë gjyqësore duke kërkuar ndihmën e partnerëve.

Përsa i përket, respektimit të standarteve të etikës, rregullave të sjelljes dhe disiplinës në punë,gjatë vitit 2020 do të merren masa të mëtejshme për të rritur ndërgjegjësimin tek prokurorët , oficerët e policisë gjyqësore,si dhe punonjësve të administratës edhe në këtë drejtim.

Përsa i përket marrjes së masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak,prioritet do të jetë shtimi i rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

Prioritet gjithashtu në punën e prokurorëve do të jetë shtimi i rasteve të zbatimit të teknikave speciale të hetimit, në kuadër të grumbullimit të provave.

Në lidhje me veprimet simuluese, duhet një punë më këmbëngulëse e prokurorit dhe një bashkëpunim më i madh i policisë gjyqësore, meqenëse kërkon bindjen e qytetarëve për të bashkëpunuar dhe burime njerëzore të cilat do të ishte mirë të ishin të ndryshëm nga policia vendore, për shkak të riskut që mbart identifikimi i këtyre të fundit në qarkun ku ushtrojnë funksionet.

2.Rekomandime

Vlerësimi jonë është që për të mundur rritjen e efikasitetit në punë, ndjekjen e problematikave në dosje, të bëhet e mundur:

- Nxjerrja e udhëzimeve në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhen mbajtur parasysh në rastet e zëvendësimit të prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore;
- Nxjerrja e udhëzimeve për rregullimin e marrëdhënieve Drejtues – Prokurorë, në kuadrin e ushtrimit të ndjekjes penale për çështje të vecanta;
- Rritja e numrit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në varësi të statistikave të përgjithshme që ofrohen në lidhje me ngarkesën e tyre në punë;
- Rritja e numrit të punonjësve të administratës së prokurorisë, me qëllim ngarkimin me detyra të ndryshme, në kuadër të .
- Përcaktimi me udhëzim të përgjithshëm i përjashtimit periodik nga shorti të Zëvendës drejtuesit, Prokurorit të Marrëdhënieve me publikun dhe mediat; Drejtuesve të Seksioneve. Aktualisht nga Drejtuesit e Prokurorive është proceduar herë pas here me përjashtim nga shorti për shkak të ngarkesës, por do të gjendej më me vend që ky përjashtim të parashikohej në mënyrë periodike apo me një përcaktim në përqindje të ngarkesës në punë.

DREJTUESI I PROKURORISË

KRESHNIK AJAZI



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'K. Ajazi', written over a circular official stamp. The stamp is also in blue ink and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top, 'PROKURORIA PRANE GJYKATES SE PARE' around the perimeter, and 'TIRANE' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.